



Taha Khabir Ulvani

# Etika E MOSPAJTIMIT në Islam



ETIKA E MOSPAJTIMIT NË ISLAM  
(edicioni i shkurtuar)

Taha Xhabir Ulvani



© LOGOS·A  
S H K U P  
PRISHTINË  
T I R A N Ë  
2 0 2 1

**BOTON: LOGOS-A**  
BIBLIOTEKA: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjuhësor: Shkëlzen Halimi  
Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi  
Redaktor teknik: Naser Fera  
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili  
Shtypi: Focus Print  
Rr. Pellagonia 3 - Shkup

**www.logos-a.com**  
ISBN 978-9989-58-854-9 Paperback  
Copyright©Logos-A, 2021  
©Center for Advanced Studies  
©The International Institute of Islamic Thought (IIIT)

Tirazhi: 1000

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.  
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.  
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.



# ETIKA E MOSPAJTIMIT NË ISLAM

(edicioni i shkurtuar)

Taha Xhabir Ulvani

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:

Sadush Tahiri

TITULLI I ORIGINALIT:

طه جابر العلواني

من أدب الاختلاف إلى نبذ الخلاف (المختصر)

Min adab al-iḥtilāf ilā nabḍ al-ḥilāf (muḥtaṣar)

The International Institute of Islamic Thought (IIIT), 2020, Herndon, USA



LOGOS·A

Ky libër u botua me mbështjen e  
Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam



## PËRMBAJTJA:

'Etika e mospajtimit në islam', një 'ELIF-BA' i bashkëkohësisë .....	9
Pjesa e parë .....	11
Përmbledhje e librit të parë "Etika e mospajtimit" .....	11
Kur mospajtimi bëhet i papranuar dhe kur bëhet i pranuar?.....	11
Historiku i mospajtimit .....	11
Shkaqet fikhore të mospajtimit (dispozitat juridike).....	12
Tiparet e mospajtimit midis imamëve (prijësve) dhe kultura e tij ....	13
Mospajtimi pas shekujve të fundit .....	13
Pjesa e dytë .....	15
Nga etika e mospajtimit drejt braktisjes së përçarjes.....	15
E para: Uniteti njerëzor .....	15
E dyta: Diskursi hyjnor dhe përshkallëzimi i tij .....	16
E treta: Dobësimi i parë.....	16
E katërta: Ilmu 'ul-kelami dhe përforcimi i sektarizmit (grupimit) .....	19
Pjesa e tretë .....	21
Ilmu 'ul-kelami dhe përçarja e Umetit .....	21
E para: Zanafilla e ilm 'ul-kelamit .....	21
E dyta: Problemet metodologjike në Ilm 'ul-kelam.....	22
1. Ndarja e ajeteve kur'anore nga konteksti i tyre .....	22
2. Përdorimi i ajeteve kur'anore për dëshmi .....	24
3. Çrregullimi i fotografisë së raportit midis botës së padukshme (alem 'ul-gajb) dhe asaj të dukshme (alem 'ush-shehade) në botëkuptimin e muslimanëve .....	25
4. Mbështetja e tendencave të polemikës dhe kontestimit verbal .....	25

Pjesa e katërt .....	27
Drejt një formulimit (modelimit, krijimit) të një ilm 'ul-kelami të ri.....	27
E para: Hyrje metodologjike për themelim (ndërtimi) të një vetëdije shpërfillëse.....	27
1. Sovraniteti i Kur'anit dhe autoriteti i Sunetit.....	27
2. Shembuj të transmetimeve që kundërshtojnë mbrojtjen e Allahut të Madhëruar të Kur'anit .....	30
E dyta: Ndërtimi (formimi) i një diskursi kur'anor .....	31
E treta: Ilm 'ul-kelami islam dhe ndikimet e tij .....	32
E katërta: Vetëdija për referimin e Kur'anit në medhhebet e ndryshme islame.....	37
1. Ibaditët .....	38
2. Zejditët .....	39
3. Imamitët.....	39
4. Ehlu Suneti.....	42
Pjesa e pestë .....	49
Mospajttime të shumëllojshme e jo mospajttime kundërshtuese.....	49
E para: shumëllojshmëria dhe shumëtrajtshmëria nuk kundërshton unitetin.....	49
E dyta: Elementet e unitetit dhe pajtimit ndërmjet muslimanëve .....	52
E treta: Namazi thërret në bashkim .....	54
E katërta: Komunikimi shkencor midis dijetarëve të mëdhenj të medhhebeve të ndryshme .....	57
1. Imam Ebu Hanife dhe Imam Maliku:.....	57
2. Imam Ebu Hanife dhe Imamët e Ehli Bejtit:.....	58
3. Midis shkollës racionaliste dhe tradicionaliste .....	58
4. Zejditët dhe hanefitët .....	59
5. Imamitë dhe zejditë .....	60
6. Ibn Tejmije dhe fakihi imamit .....	60
Përse komunikim? .....	61

E pesta: Unifikimi rreth referencës së përbashkët dhe ndikimi i tij në trashëgiminë shkencore të medhhebit.....	65
Pjesa e gjashtë .....	71
Ide besëlidhës për lëvizjet islame .....	71
E para: Sovrani (pushteti) nënkupton sovranin e Kur'anit sipas kuptimit njerëzor e jo sovranin hyjnor .....	71
E dyta: Sovrani hyjnor në botëkuptimin hebre (izraelit) dhe të krishterë.....	76
1. Sovrani hyjnor në botëkuptimin hebre (izraelit) .....	76
2. Sovrani hyjnor në krishterizëm .....	78
3. Sovrani hyjnor dhe shpallja e fundit:.....	80
4. Sovrani në përshkrimin e tij koncept motivues (provokues)....	84
5. Boshti i Umetit përballë grupit dhe përballë pushtetit.....	90
7. Ringjallja e Umetit .....	96
8. A ndërtoi i Dërguari i Allahut shtet apo Umet? .....	98
9. Njeriu emërohet mëkëmbës në Tokë .....	101
10. Popujt emërohen zëvendës dhe ndërimi i popujve .....	101
11. Mëkëmbësia individuale .....	102
12. Logjika statike nuk është e aftë të ringjall dhe përtërijë Umetin.....	104
13. Pastërtia e fesë (el-hanefijeh) si metodologji e përtëritjes së Umetit .....	106
<b>SHTOJCË .....</b>	<b>111</b>
Fjalorthi i librit “Etika e mospajtimit në islam” .....	113
Biografi e shkurtër.....	139
Literatura .....	143





# ‘Etika e mospajtimit në Islam’, një ‘ELIF-BA’ i bashkëkohësisë

Para vetes kemi përkthimin e veprës së dr. Taha Xhabir Ulvanit me titull “Edeb’ul-ihtilafi fi’l-Islam” ose, në përkthim, “Etika e mospajtimit në Islam”. Vepra, fillimisht, është publikuar në vitin 1984, por ka përjetuar disa botime të mëvonshme, si nevojë dhe kërkesë e kohës së trazuar ndër muslimanët dhe në përgjithësi.

Vepra përbëhet prej tre tërësive kryesore dhe dhjetë kapitujve brenda tyre, duke paraqitur një “udhëzues për të ndihmuar në relativizimin, zbutjen e pse jo edhe zvogëlimin në minimum të mosmarrëveshjeve të brendshme dhe armiqësive të jashtme ndërmjet partive politike, organizatave, lëvizjeve islame në një pjese të botës muslimane”. Këta “taborë” jo vetëm që janë thyer në grupime tejet armiqësore, por gjithashtu drejtojnë ndaj palës së kundërt akuza e anatema më të rënda të mundshme, deri në apostazi (kufr, ridde), mëkat (fisk), inovacion (bid’ah) etj.. Autori flet në hollësi për problemet, duke mos i apostrofuuar edhe shkak-tuesit e problemeve, sigurisht për t’iu adresuar problemeve dhe për të mbrojtur bashkëmendimtarët. Por, për vrojtuesin e gjendjes politike, shoqërore e intelektuale është e qartë se për cilat vende dhe kohë, për cilat ide dhe lëvizje bëhet fjalë.

Autori, me të drejtë, pohon se ky libër do të mund të titullohej edhe më mirë si “Etika e mospajtimit ndërmjet juristëve klasikë muslimanë”, duke shërbyer si një hyrje e dobishme për çështjen e mospajtimit në përgjithësi, si në kohë ashtu edhe në hapësirë, dhe duke shërbyer si një doracak akademik, por pa një hartë infrastrukturore të

saktë për ta ndihmuar lexuesin që ta përthith etikën dhe mirësjelljen e rekomanduar në të. Për këtë arsye edhe libri është një hyrje, një standard kur'anor-sunetik, që mund të zberthehet në infrastrukturë shumë më të zhvilluar dhe të sigurt.

Libri është kritik ndaj botës muslimane, sidomos ndaj shtresës intelektuale, institucioneve arsimore e elitës politike, të cilët janë shkaku kryesor për mizorinë e pranishme, varfërinë, sëmundjet, varësinë, për paralizimin e mendjes dhe zhvillimit arsimor, për kopjimin pa kriter të së huajës në arsim, kulturë, qytetërim, politikë, ekonomi, agrokulturë, gastronomi etj. Si përfundim i shkakat të krizës mund të thuhet se ajo është intelektuale dhe devocionale, pra nuk bëhet fjalë për mungesë të dije dhe devocionit, por për mungesa të arsyes në dije dhe veprimin në devocion, të përçjellë me debate të kota, të tepërta, imanente vetëm për të paaftit për të marrë gjykime të urta, relative dhe të hapura. Me këtë nënkuptohet etika dhe kultura e mospajtimit, kultura e dialogut, mirëkuptimit, respektit, e polemikës së qytetëruar, të domosdoshme për çdo shoqëri plurale, multi-kulturale, kundrejt njëmendësisë.

*N. Ibrahimi  
Prill, 2021*

# Pjesa e parë

## Përmbledhje e librit të parë "Etika e mospajtimit"

Islami në radhë të parë konfirmon fjalën tevhidit (besimin në njëshmërinë e Allahut) dhe tevhidin e fjalës (njëshmërinë e fjalës, unitetin e umetit islam që nënkupton unifikim e tyre rreth fjalës). E para thërret në besim (iman), kurse e dyta është reflektim praktik i së parës. Ata që kanë një Zot, një të Dërguar, një Libër, një Kible dhe një shkak të krijimit dhe jetës së tyre, doemos që edhe fjala e tyre të jetë një: *"Vërtet, ky është besimi juaj – besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua!"* (El-Enbija', 92)

### Kur mospajtimi bëhet i papranuar dhe kur bëhet i pranuar?

Mospajtimi për nga motivet ndahet në tre grupe:

- mospajtim i nxitur nga epshi dhe vetëpëlqimi, që është mospajtim i papranuar,
- mospajtim i nxitur nga e vërteta, siç është mospajtimi me Pjesëtarët e Librit, idhujtarët dhe hipokritët dhe mospajtimi që hamendet midis lavdërimit dhe qortimit,
- mospajtim ky që shfaqet në gjëra që midis njëra-tjetrës ekziston një lloj preferimi ose pëlqyeshmërie më e madhe.

### Historiku i mospajtimit

Në kohën e të Dërguarit s.a.v.s. nuk ekzistonte diçka që do të mund të nxiste mospajtim, sepse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte pikë referimi i të gjithëve. Mirëpo, shokët e të Dërguarit s.a.v.s. ishin ata që pas kohës së të Dërguarit s.a.v.s. nxitën mospajtime në shumë gjëra. Me rëndësi është

të mësojmë se mospajtimet e shokëve të Dërguarit s.a.v.s. ishin të bazuara mbi vëllazërinë islame, kujdesin për ume-tin islam, prandaj edhe iu përkushtuan gjërave që do të ishin më të shëndosha për vetë Islamin dhe Umetin. Kujtoj se e udhës është të theksojmë se ngjarjet e mëdha që ndodhën në jetën e tyre kaluan pa bërë ndonjë zhurmë të madhe dhe pa nxitur plasaritje në trupin e umetit. Mospajtimet politike që rezultuan me trazirën e vrasjes së Osmanit dhe kalimin e hilafetit në Kufë dhe Sham, bënë që në sferën e mospajtimit të futen edhe gjëra që ishin jashtë saj, e që ndihmuan që banorët e vendeve të mbyllen në hadithet e të Dërguarit s.a.v.s. që u kishin arritur, aq sa banorët e Hixhazit të mendonin se hadithi i irakianëve ose i sirianëve është i papranuar nëse ai nuk ka bazë te banorët e Hixhazit.

### Shkaqet fikhore të mospajtimit (dispozitat juridike)

Mospajtimi fikhor do të ishte i pranuar nëse në të përfshihen dy gjëra:

- e para - që te të dy mospajtuesit të ekzistojë argumenti që vlen për të argumentuar me të, dhe

- e dyta - që mbështetja e drejtimit të kundërt të mos rezultojë me dinakëri dhe shtrembësi. Shkaqet e mospajtimit kanë të bëjnë me: natyrën e gjuhës, si p.sh. kur ndodh që shprehja të jetë me shumë kuptime (polisemike) dhe shprehja në fjalë përdoret për kuptime të shumta dhe të ndryshme, ose që shprehja në fjalë ka dy përdorime: reale dhe metaforike. Ndër shkaqet e mospajtimeve numërohet edhe transmetimi i hadithit, disa herë transmetimi arrin te një muxhtehid e jo te tjetri, e kjo sjell që njëri prej tyre të jep fetva ndryshe nga tjetri, kështu të krijohet mospajtim mes fetvave. Por, ndodh që edhe te tjetri të arrijë transmetimi në fjalë, por që ky të mendojë se në transmetim ka një shkak që pengon të vepruarit sipas kërkesës së tij, ndërkaq për tjetrin

të jetë transmetim i shëndoshë dhe të veprohet sipas tij. Janë edhe shkaqe tjera që kanë të bëjnë me rregullat e studimit dhe hulumtimit të dijetarëve. Drejtimet e muxhtehidëve nuk janë të një mendimi kur bëhet fjalë për këto rregulla, gjë që solli në mospajtimin e tyre.

### Tiparet e mospajtimit midis imamëve (prijësve) dhe kultura e tij

Është e vërtetë se imamët nuk u pajtuan në shumë gjëra ixhtihadore (të dispozitave që kërkojnë hulumtim dhe studim individual bazuar në burimet e sheriatit islam), çdonjëri prej tyre dha mund të madh për të arritur tek e vërteta. Dijetarët i pranonin fetvatë e muftive përderisa ata ishin të aftë dhe meritore për këtë. Dijetarët në fjalë arrinin që për çdo fetva të shëndoshë të shfaqnin mirënjohje dhe të njëjtën ta tregonin të saktë, kurse për atë që gabonte, këta kërkonin falje dhe kishin mendim të mirë për të gjithë. Kështu kishte ndodhur me çështjen e leximit të *besmeles* (bismi'l-'ahi'r-rrahmani'r-rrahim), me atë se a e prish abdestin prekja e gruas, marrjen e abdesit me ujë të shiut e tjera, por që e gjithë kjo nuk kishte penguar që të faleshin njëri pas tjetrit. Një kulturë e lartë ishte që dominonte në mesin e këtij brezi të dijetarëve, veçmas kultura e fiksimit të tyre pas diturisë dhe shmangies së ngatërrimit me gjëra për të cilat nuk kishin njohuri.

### Mospajtimi pas shekujve të fundit

Ixhtihadi mori fund me përfundimin e vitit të 4 hixhri, pas kësaj taklidi (imitimi) do të përhapet kudo, ixhtihadi do të jetë vetëm në medhhebe, postin e kadiut do ta merr vetëm muxhtehidi, dijetari do të quhet fakih vetëm kur të jetë muxhtehid. Kjo pa dyshim do të rezultonte me zgjerimin (fryrjen) e fikhut teorik që nuk kishte të bëjë fare me çështjet

e njerëzve, ato ishin çështje supozuese të lindura nga diskutimet, polemikat, debatet dhe çështjet mospajtuese. Umeti islam është Umet i një diskursi global (botëror), i një gjykimi të një Libri global dhe i një ligji lehtësues dhe plot mëshirë. Ky Umet është ndërtuar me duart e vetë të Dërguarit s.a.v.s. dhe rindërtimi i tij do të jetë i mundur vetëm mbi bazat dhe shtyllat e vendosura nga vetë ai s.a.v.s., përndryshe kurrë nuk do të jetë i mundur rindërtimi i tij pas gjitha atyre shtrembërimeve dhe devijimeve që kanë goditur konceptet e tij. E për sa i përket rrugëve tjera të rindërtimit, ato janë treguar të padobishme dhe joefikase, ato nuk rezultuan me rindërtimin e asaj që u rrënuar e as ripërtëritjes të asaj që ishte vjetruar.

# Pjesa e dytë

## Nga etika e mospajtimit drejt braktisjes së përçarjes

### E para: Uniteti njerëzor

Gabojnë ata që insistuan në përçarje dhe këtë e argumentuan me fjalët e Allahut të Madhëruar: *“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt.. për këtë qëllim Ai i krijoi ata.”* (Hud, 118-119)

Është e ditur se Islami na ndaloi përçarjen në fe, por megjithatë në mendjen e njerëzve ka zënë vend mendimi se përçarja (mospajtimi) është fat i pashmangur, këta ndoshta argumentuan edhe me fjalët e Allahut të Madhëruar: *“Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu u dërgoi pejgamberët me lajme të mira dhe paralajmërime. Bashkë me ata, Ai zbriti edhe Librin me të vërtetën, për t’i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin. Mirëpo, njerëzit u grindën midis tyre, pasi u erdhën shenjat e qarta, nga zilia që kishin për njëri-tjetrin.”* (El-Bekare, 213)

Ndodh që njeriu - është detyrë e tij - të bëhet mjet i unifikimit dhe bashkimit të fjalës, siç ndodh që këtë ta shndërrojë në rrugë të përçarjes (grindjes). Ithtarët e Librit (të krisherët dhe hebrenjtë), jo që nuk kishin dituri të mjaftueshme, por që diturinë që e kishin e shfrytëzuan për grindje midis tyre. Përçarja dhe grindja e tyre në fe që ishte mangësi e tyre u bë shkak i pezullimit të fesë së tyre. Allahu i Madhëruar përçarjet (mospajtimet) i konsideroi si një lloj dënimi, nëse ato nuk përkufizohen me rregulla dhe kritere të Kur’a-



nit. Hadithi i të Dërguarit s.a.v.s.: “*Mospajtimi i Umetit tim është mëshirë.*” Është hadith i pabazë dhe i sajuar. Sikur mospajtimi të ishte sunet, nuk do të ishim urdhëruar për bashkim, e Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.

### E dyta: Diskursi hyjnor dhe përshkallëzimi i tij

Diskursi hyjnor për njerëzimin filloi me bisedën e përzgjedhjes të lidhur ngushtë me bisedën e ndërtimit të popullit (fesë). Përzgjedhja nuk e anulon bazën e unitetit, ajo e përforcon bile atë. Diskursi hyjnor i drejtohet njeriut dhe ka të bëjë me të vërtetën e tij njerëzore, këtij njeriu do t’i ngarkohet misioni (*risala*) që do t’i mundëson ndërtimin e familjes së shtrirë njerëzore. Ai filloi me vendosjen e themeleve dhe shtyllave esenciale që do ta realizonin këtë qëllim bujar dhe madhështor. Tevhidi (njëshmëria e Allahut) do të jetë baza e parë dhe më e fortë mbi të cilën do të ndërtohet e tërë ndërtesa. Bazë e dytë e kësaj ndërtese të lartë do të jetë “Umeti” sipas konceptit kur’anor, që feja e Allahut të ngadhënjej mbi çdo fe tjetër, që roli i dëshmisë (detyra e dëshmisë) për njerëzit të shndërrohet e të jetë bërthamë e Umetit dëshmitar e të zgjedhur (të dobishëm). E gjithë kjo do të realizohet përmes bindjes, zbutjes së zemrave dhe prezantimit të shembullit të Umetit dhe fesë.

### E treta: Dobësimi i parë

Për sa i përket tevhidit, tek prezantimi i tij dhe argumentimi me të u shkaktua një devijim nga metodologjia kur’anore (menhexhu’l-kur’an), veçmas kur ai u shndërrua në shkencë që mëton pohimin e doktrinave, duke sjellë argumente dhe duke larguar dyshime, krahas kësaj provat e tij në çështjet bindëse për të cilat dëshmon mendja e shëndoshë dhe e qartë dhe i mbështet Kur’ani dhe Suneti i lanë anash, çështje parësore dhe të rëndësishme e konsideruan

*imametin*, prandaj edhe u shkaktuan përçarje midis Umetit (ndarjen në fraksione). S'ka dyshim se kjo solli veprimin e shpërfilljes së Umetit, që vendin e tij ta zë shteti dhe, në vend se veprimi të orientohej kah ndërtimi i Umetit dhe të jetë qëllim parësor, ishte shteti ai që u bë qëllim, në aspektin e ndërtimit, mbështetjes dhe autoritetit (sovrانيت). Përveç kësaj, do të shohim që çlirimi (fet'h) do të zë vendin e thirrjes (da'ves). Shtetet që historikisht njihen si shtete islame, ishin më shumë të interesuara për çlirim të vendeve dhe për arritje të përfitimeve materiale si dhe për realizim të fitoreve dhe zgjerimeve të tyre. Gjurmët e një veprimi të tillë nuk arritën të dukeshin në thirrjen islame (da'vetin), gjë e cila konsiderohet veçori esenciale e fesë. S'do mend se kjo solli edhe fillimin e dobësimit të lidhjes me Kur'anin, vendin e tij ta zënë ndikimet lidhur me *nes'hin*, *nasihun* dhe *mensuhin*<sup>1</sup>, që të pretendojnë se ajeti i shpatës (*ajetu sejf*) (Et-Tevbe, 29) i ka abroguar ajetet e krijimit të paqes dhe dialogut paqësor me më të mirat, para nesh ka mbetur vetëm shpata që do ta nxjerrim dhe ta drejtojmë në fytyrë të armikut, kështu t'i detyrojmë në Islam, ose të pranojnë japin xhizje ose do të kenë luftë. Është me rëndësi të përmendim se ajetet e para të sures Et-Tevbe që kanë të bëjnë me lirimin e deklaruar nga ana e Allahut dhe të Dërguarit të Tij prej çdo detyrimi ndaj idhujtarëve me të cilët kishin bërë marrëveshje (*el-beraetu*), nuk janë për shkak të idhujtarisë, por për shkak të shkeljes së marrëveshjeve dhe zotimeve të përsëritura, kjo me provën se Allahu i Madhëruar thotë: “Përysh-tim bëjnë ata idhujtarë, me të cilët keni lidhur marrëveshje e që nuk ju kanë shkelur asgjë prej saj dhe që nuk kanë ndihmuar askënd kundër jush. Respektojeni marrëveshjen me ta deri në

<sup>1</sup> Nes'hi nënkupton abrogimin, nasihu është abroguesi, kurse mensuhi nënkupton të abroguarën. Kjo ka të bëjë me shkencën e tefsirit.

*fund. Me të vërtetë, Allahu i do ata që (i) frikësohen (Atij)."* (Et-Tevbe, 4)

Probleme, kriza dhe devijime të shumta u shfaqën brenda qenies së formuar të Umetit. Çështja e "imametit" në brendinë e shkencës së ilm 'ul-kelamit (apologjetikës islame) u shndërrua në çështje akaidore, që do të diskutohej nga pikënisjet e imanit, kufrit, bid'atit dhe daljes nga feja etj. Një gjë e tillë shkaktoi një lloj ngatërrimi dhe ndërhyrje midis asaj që iu shpall të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. e të cilën ky dhe njerëzit e ndoqën si udhëzim parësor dhe gjërave që kishin të bëjnë me botën e njerëzve. Gjërat e botës së njerëzve i nënshtrohen ixhtihadit, studimit racional, dijeve integrale, objektivave të përgjithshme të sheriatit dhe sferës së dobisë dhe dëmit, siç janë gjëra që paraqesin vizion universal dhe përgjithësime që kanë të bëjnë me Umetin. Fukahatë (juristët islamë) deshën të shkruajnë për "usul 'ul-fikh" (bazat e fikhut) dhe atë ta bëjnë drejtim me të cilin do ta përkufizonin veten e tyre për hulumtimin e çështjeve fikhere dhe për njohjen e dispozitave të reja (që nuk ishin më parë). Të interesuarit për çështjen e imametit dhe çështjes politike panë se kjo shkencë nuk i përmbush nevojat e tyre për vendosjen e bazave (rrënjëzimin) të çështjes së imametit, e të njëjtën u munduan ta bëjnë me çështjet e imametit dhe politikës, atëherë bartën "ilm 'ul-kelamin" nga shkenca që më herët e shfrytëzonin për mbrojtje të doktrinave islame para dyshimeve të ithtarëve të Librit, që ajo (ilm 'ul-kelami), me të gjitha tiparet e polemikës dhe përplasjes dhe të gjitha parimeve që i ngërthente, e që ishin mjet për mbrojtje dhe polemikën brenda islamit që zhvilloheshin midis grupeve të ndryshme, e që më pas të ndodhë që secila prej tyre t'i përdorë rregullat e "ilm'ul-kelamit" për mbrojtje të pikëpamjeve dhe mendimeve sektare dhe drejtimin e tij kelimist. Kështu, shkenca e "ilm 'ul-kelamit" u

shndërrua në mjet për nderzjen e përplasjeve dhe akuzave për njëri-tjetrit me kufër, bid'at dhe dalje nga feja, e në anën tjetër edhe për vlerësim të shpëtimit të disave nga zjarri i Xhehenemit. Më vonë dolën edhe mendime tjera të devijuara që supozonin se “Kur’ani përmban shumë kuptime (interpretime), se ajetet e tij janë më shumë gjithëpërfshirëse e jo të hollësishme, kështu që shumë prej tyre vendosën ta përdorin vetëm Sunetin për mbështetje të thënieve të tyre dhe rregullave që i kishin nënrenditur në “ilmu’ul-kelamin sektar- grupor”. Më vonë vërejmë edhe lëvizjen e sajimit të hadithit, gjë që rezultoi me zgjerimin e fushës para sekteve që dëshironin sajimin e haditheve, me të cilat do t’i mbështesnin pretendimet e tyre dhe qëndrimet e tyre të posaçme sektare. Një gjë e tillë rezultoi edhe me mbështetjen e drejtimeve përçarëse në Umet në forma të ndryshme, kjo sepse kelamistët më vonë do ta shndërrojnë atë në shkencë që lidhet me ilmu’ul-kelamin dhe ndahet prej tij dhe i dhanë emrin “ilm ‘ul-milel ve’n-nihal”.

#### E katërta: Ilmu ‘ul-kelami dhe përforcimi i sektarizmit (grupimit)

Disa dijetarë, siç është Imam Shafiu, ishin refuzues të mëdhenj të “ilm ‘ul-kelamit”. Periudhat e përplasjeve midis sekteve që ishin rezultat i polarizimeve politike nuk pushuan fare. Kjo rezultoi me rrënjëzimin e përçarjes së Umetit dhe shpartallimit të tij. Krahas kësaj, “sektarizmi politik” e bënte punën e tij në dobësimin e Umetit, gjë e cila bëri që shtetet perëndimore më vonë të shfrytëzojnë rastin për përçarje më të madhe të Umetit, këta nuk pushuan së nderzuri përplasje sektare dhe racore anëmbanë botës islame.

Në këtë mjedis të ashpër të përçarjeve dhe shpartallimit ishte bërë e pamundur të gresh veshë që do të dëgjonin për bashkim dhe unifikim të Umetit. Koncepti “Umet” ishte i

humbur, vendin e tij e kishin zënë konceptet lokale, fisnore dhe sektare, vërehej një ngatërrim i madh midis koncepteve të vjetra dhe ato bashkëkohore. Rrënjëzimi i sektarizmit (grupimeve) ishte përforcuar edhe më tej, aq sa koncepti i “Umet-it” ishte bërë i huaj, i papranuar dhe i pa ndikim.

# Pjesa e tretë

## Ilm 'ul-kelami dhe përcarja e Umetit

### E para: Zanafilla e ilm 'ul-kelamit

Më parë folëm për ndikimin negativ të ilmu 'ul-kelamit dhe ndikimin e tij në përcarjen e Umetit. Do të kishte qenë më mirë sikur t'ju përmbaheshin koncepteve kur'anore dhe terminologjive të tij dhe të mos dilnin jashtë tyre. Kur'ani fisnik erdhi me akide të lehtë, atë e argumentoi me prova të ndryshme, siç ishte “prova e krijimit dhe përkujdesjes” dhe “prova e rëndësisë (vlerësimit) dhe rregullit” dhe “prova e shpikjes”. Kur'ani gjithashtu erdhi me të gjitha elementet e besimit (imant) që i bënte gjëra të pranuar për të kuptuarit e njeriut. Ai njeriut i dha këndvështrim universal (opinion, vizion) që do t'i mundësonte përmbushje të zotimit dhënë Allahut dhe realizim të rolit të zëvendësimit në Tokë. Krahas besimit (imant), njeriu do të ketë pranë vetes edhe sheriatin (ligjin) që është lehtësim dhe mëshirë, në vetë njeriun nuk do të ketë më pengesa e vështirësi që më herët e kishin penguar dhe rënduar atë. Imani dhe sheriatit do të jenë gjë e lehtë dhe e thjeshtë, larg komplikimit, e njohur më herët në diskutet e para fetare.

Megjithatë, edhe në kohën e të Dërguarit s.a.v.s. u sulmua sheriatit dhe imant, por ishte Kur'ani që merrte përsipër mbrojtjen e tyre dhe diskutimin e kundërshtimit të tyre. Pas vdekjes së të Dërguarit s.a.v.s. u hapën dyert e polemikës dhe filloi zanafilla e “ilm 'ul-kelamit”, i cili nga një shkencë që përdorej për mbrojtje të themeleve të besimit, u shndërrua në shkencë të cilën sektet (grupet) e ndryshme e

vunë në shërbim të polemikave për veten e tyre kundër sekteve të tjera.

### E dyta: Problemet metodologjike në Ilm 'ul-kelam

Karakteristikat e ilm 'ul-kelamit ishin të përkufizuara qysh në zanafillë, qysh në fillim orientimi i tij ishte për kundërshtim dhe polemikë, e jo për themelim të njohurive, qëllimi i tij ishte zmbropsja e provave të kundërshtarit. Atë e preokupuan imtësitë, me to filloi dhe me to mbaroi, pas stërmadhimit të tyre dhe vendosjes së tyre në vendin që nuk e meritonte. Kjo rezultoi me probleme metodologjike, ndër to:

#### 1. Ndarja e ajeteve kur'anore nga konteksti i tyre

Kjo nënkuptonte ndarjen e ajeteve nga konteksti kur'anor dhe leximi i tyre ndaras, gjë për të cilën Allahu i Madhëruar na e tërhoqi vëmendjen: *“Dhe e bënë Kur'anin në pjesë (duke i besuar ca pjesë dhe duke i mohuar të tjerat).”* (El-Hixhr, 91)

Që këtej u krijuan dy rrugë, njëra në metodologjinë e bashkëveprimit me tekstin dhe e dyta në trajtimin e çështjeve që preokupuan sferën kelamiste drejtpërdrejt. Problemi nuk ishte në nxitjen e pyetjeve, por në metodologjinë e trajtimit duke u mbështetur në leximin e pjesë-pjesë që solli në keqkuptim (keqinterpretim) që nënkuptonte kontradiktë dhe mospërputhje. Diskursi kelamist do të bashkëvepron me këtë lexim në veçori shpjegimi si veçori e jashtme e jo qenësore (e brendshme, vetvetiu). Sipas tyre, “Kur'ani përmban shumë kuptime dhe mënyra interpretimi si dhe paqartësi dhe përngjasime që kanë nevojë për shpjegues të jashtëm”; - gjë e cila bëri që të hapet dera që secili grup t'i projektojë tendencat dhe preokupimet e veta paraprake mbi Kur'anin pa ndonjë kriter apo përkufizim të qartë. Kur'ani tani e tutje do të bëhet dëshmitarë për secilin drejtim, e jo pikë referim (burim).

Diskursi i tillë kelamist do të rezultojë edhe me një përplasje më të madhe në bashkëveprimin e tij me Sunetin, disa kelamistë do të ndjekin metodologjinë e muhadithëve (hadithologëve) kur bëhet fjalë për përkufizimin e Sunetit, se ai është: “Çka vjen nga i Dërguari s.a.v.s., fjalë, veprim ose konfirmim qoftë.” Këta filluan të argumentojnë me Sunetin (hadithet), duke mos marrë parasysh kritikën në sened ose metn<sup>2</sup>, këta në shumë raste edhe i shpërfillën përkufizimet e fukahave (juristëve islamë) dhe dijetarët e usulit (bazave të Islamit), prandaj edhe krijuan ndarje midis Sunetit dhe Kur’anit, ndërkaq që koncepti i kundërshtimit midis tyre në drejtimit e tjera u bë gjë e mundur, duke mos analizuar fare se një gjë e tillë do të përfundonte në gënjeshtëri për Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe se i Dërguari i Allahut ndodh ta kundërshtojë atë që iu është shpall nga Zoti i tij dhe ta zhvleftësojë atë.

Kelamistët gjithashtu filluan me të madhe të argumentojnë edhe me rivajete (transmetime) dhe u treguan shumë tolerantë (të pakujdesshëm) në pranimin e tyre, kjo sepse ato i mbështesnin qëndrimet e tyre (thënie). Që këtej transmetimi (rivajeti) u bë strehim për ta dhe legjitimitet për veten e tyre. Ndërkohë, kjo do t’ju shërbente për zhvleftësim të legjitimitetit nga kundërshtarët e tyre. E gjithë kjo do të rezultonte me stërmadhimin (fryrjen) e trashëgimisë (diturive) sektare, ku çdonjëra prej tyre do të qëndronte pas transmetimeve që mbështesnin dhe përforconin praninë e tyre, gjë që ishte në kundërshtim me intencat e Kur’anit, qëllimet dhe objektivat e tij.

Zanafilla e diskursit kelamist shënoi përplasje midis sekteve, të cilat hulumtonin për gjërat që do t’ju ndihmonin në ballafaqim me kundërshtarët. Kjo bëri që çështjet universale (kompakte) të shkërmoqen, sepse filloi hulumtimi për argu-

<sup>2</sup> Senedi nënkupton zinxhirin e transmetuesve, kurse metni nënkupton tekstin e hadithit të transmetuar.



mentet e parëndësishme (parciale) dhe sqarimet e hollësishme për çështje sekondare, aq sa prej tyre merrnin vetëm copëza në formë të zgjedhur dhe dobiprurëse, që do t'ju shërbenin për fyerje dhe goditje të kundërshtarëve të tyre. Trajtimi i tyre për çfarëdo çështje të ishte, do të shënonte trajtimin për aq sa ishte nevoja e saj për ta sulmuar dhe zhvleftësuar trajtimin dhe qëndrimin e kundërshtarit të tyre, ndërsa do ta mbështeste të tyren. Këta nuk çanin kokë për një të kuptuar integrues (gjithëpërfshirës) të çështjeve në fjalë, këta mendonin vetëm se si të krijonin rrugë të përshtatshme për konceptet e tyre, se ishin të nxitur nga parandjenja e pengimit të çdo rruge që do të mund të ishte mbështetje e koncepteve dhe thënieve të kundërshtarëve të tyre. Pas kësaj që të gjithë gradualisht u përfshinë në bojkotim të njëri-tjetrit, kundërshtim, rezistim, mospajtim dhe teprime të pafund.

## 2. Përdorimi i ajeteve kur'anore për dëshmi

Leximi selektiv bëri që shkenca e kelamit të humbë fuqinë e pikënisjes nga Kur'ani për t'u frymëzuar (pajisur) me metodologji njohëse dhe sistem argumentues që do të përgatiste ndërtimin e koncepteve dhe formësimit e pasqyrimeve të lidhura me të, në përputhje me logjikën e Kur'anit dhe gjuhën e tij.

Problematika (paqartësia) e raportit midis treguesit dhe treguarës ndryshonte midis leximit sipërfaqësorë të shprehjes që përkufizohej në kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të perceptuar të shprehjes dhe formave metaforike që shkonin shumë larg, aq sa shprehjen e konsideronin vetëm simbolikë (kod) që jepte kuptim të paqartë e pa të dhëna shtesë nga konteksti dhe pa ndonjë lidhje të drejtpërdrejt me shprehjen. Nisur nga kjo, distanca midis treguesit (shprehja kur'anore) dhe treguarës ishte bërë legale dhe me mundësi

për zgjerim dhe ngushtim, varësisht nga faktorët që ishin jashtë kontekstit.

Pothuajse të gjithë ishin mbështetur në format metaforike – qoftë të ishin pohues apo mohues të çështjeve kelamiste - çështja nuk kishte të bënte më me ndonjërin nga sektet, ashtu siç mu'tezilët përdorën këtë mënyrë për interpretimin e tyre të ajeteve lidhur me atributet e Zotit, siç është dora dhe syri apo ajetet e kaderit, njashtu edhe hadithologët (ehl 'ul-hadith) u mbështetën në të kur morën të shpjegojnë se çdo veprim që i vishet njeriut, është në formë metaforike, siç thuhet: “kaloi dimri”, e që në fakt dikush e kaloi.

### 3. Çrregullimi i fotografisë së raportit midis botës së padukshme (*alem 'ul-gajb*) dhe asaj të dukshme (*alem 'ush-shehade*) në botëkuptimin e muslimanëve

Metodat e Kur'anit për trajtimin e gjërave janë të shumëllojshme, ai disa herë nisat nga bota e padukshme (gajbit) drejt botës së dukshme (shehade), që përsëri të kthehet në botën e padukshme (gajbit), duket sikur lëvizë pandërprerë midis botëve të ndryshme, e që njeriu ndodh të dijë diçka prej saj, por edhe të mos dijë shumëçka nga këto bota, sepse njeriut iu është dhënë fort pak dije për këtë. Që këtej, të gjitha njohuritë njerëzore, në radhë të parë ato që njihen si njohuri të “tevhidit apo akides ose kelamit”, nuk do të mundën kurrë të bëjnë që njeriu t'i arrijë horizontet e larta të tyre ose të frekuentojë në ato panjohuri. Trajtimi i kelamistëve i disa çështjeve metafizike (gajbit) do të jetë përpjekje e qortuar (e pahijshme), që nuk duhej të merreshin me ato.

### 4. Mbështetja e tendencave të polemikës dhe kontestimit verbal

Metodologjia e ilm 'ul-kelamit është e bazuar në polemikë, ndërsa polemika është një aspekt i logjikës së Aristotelit, e ngritur mbi konceptet dhe njohuri afirmative që burojnë

nga shprehjet. Polemizuesi vepron vetvetiu, qoftë në pozitë të argumentuesit ose kundërshtuesit me atë që polemizon, duke bërë që qëllimi i tij të jetë vetëm të ngadhënjejë ndaj kundërshtarit dhe ta zhvleftësojë atë, të tregojë saktësinë e thënies së tij, drejtimit të tij dhe atë ta mbështet dhe ta përforcojë, pa marrë parasysh të vërtetën dhe të pavërtetën që ka të bëjë me çështjen në fjalë. Kështu ndodh që argumentuesi të shndërrohet në kundërshtues dhe anasjelltas. Kjo do të rezultonte me mospajtimin e argumentimit dhe kundërshtimit, argumentimi të pohojë atë që e ka mohuar dhe të mohojë atë që e ka pohuar (qoftë në pozitë pohimi ose kundërshtimi). Për këtë, ajo që fillon të ndërtohet mbi këtë bazë, duhet të jetë e ditur se ndërtohet mbi kodrinën me rërë që fare nuk ka themel, që në çdo moment është gati të rrënohet, e kjo s'ka dyshim se paraqet të metën më të rrezikshme dhe kritikë për ilm 'ul-kelamin.

Metodologjia e tillë ndikoi në shkencat tjera, siç ishte usul 'ul-fikhu, fikhu dhe tefsiri. Megjithatë, dijetarët e usulifikhut (usulijunët) gjatë trajtimit të tyre të tematikës mbi bazat (synimeve të urta) e dispozitave u ndikuan nga drejtmet kelamiste dhe u lëshuan në polemika teorike të pafrytshme (shterpe) rreth lejimit të përdorimit të Ligjvënësit të Urtë (Allahut të Madhëruar) synimin e urtë (il-letin) dhe qëllimin. Ishte e mundur që synimi i urtë të ishte pikënisje e rëndësishme e ndërtimit të mendimit intencional (objektiv) në kohë të hershme të historisë sonë, por ishin këto shkaqe që penguan atë, në krye të së cilave dominimi i diskursit kelamist në sferën e trajtimit të çështjeve, edhe pse (synimi i urtë) do të ishte karakteristikë kryesore e Islamit që synon qëllimin final.

# Pjesa e katërt

## Drejt një formulimit (modelimit, krijimit) të një ilm 'ul-kelami të ri

E para: Hyrje metodologjike për themelim (ndërtimi)  
të një vetëdije shpërfillëse

### 1. Sovraniteti i Kur'anit dhe autoriteti i Sunetit

Kur'ani është fjala e Allahut drejtuar të gjithë njerëzve, duke filluar me popujt e paarsimuar e deri te popujt e arsimuar (ithtarë të Librit), me qëllim të besimit të asaj që Allahu u shpalli të dërguarve të tyre, kthimin e tyre në gjendje besimi dhe bindje si dhe që shpallja të mbikëqyrë jetën e tyre (mbikëqyrës edhe i librave të shpallura më herët). Është vetë Allahu i Madhëruar që mori përsipër kujdesin për Kur'anin, Ai urdhëroi të Dërguarin e Tij ta ndjek atë dhe ta lexojë pa nxituar, një gjë e tillë do të nënkuptonte atë se leximet e transmetuara të Kur'anit kanë nevojë për konsultë nën dritën e vetë ajeteve kur'anore që nënkuptojnë shpjegimin dhe mbledhjen e tyre (kujdesin), se ato janë mbrojtje e tij. Njeriu, duke marrë parasysht mangësitë e tij të natyrshme (instinktive), është ai që anon kah ajo që vetveten ta konsiderojë qendër nga e cila do të mund t'i shikojë gjërat, prandaj edhe bëhet rob i vetvetes. Ai, në vend se të përfitojë ndihmë nga Libri i Allahut për t'i mbisunduar tendencat e tij individuale, gjuha e tij filloi të shtjellojë thënie të pakuptimta (të kota), sikur që ishte se: "Kur'ani përmban shumë këndvështrime (forma) dhe se tekstet janë të përkufizuara kurse realitetet të pakufizuara." Këta për-

funduan në atë se Kur'ani ka nevojë për shpjegues të jashtëm, se në Kur'an ka ajete *mushkil* (i paqartë, i diskutueshëm), *mubhim* (dykuptimtë, të paqarta, enigmatik), ajete të abroguara, alegorike dhe të qarta.

E si bëhet që njerëzit të besojnë që Allahu i Madhëruar thotë: “*Fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë.*” (El-En'am, 115); qofshin ato lexime ose transmetime, se Allahu është që vetë u përkujdes për Kur'anin, është vetë Ai që e shpjegoi atë dhe kuptimet e Tij, që ai të jetë kujtim dhe provë për gjithë botët deri në Ditën e Fundit! Librat e shkencave të Kur'anit u mbushën përplot me thënie që flasin se ky ajet ka abroguar atë ajet, se ai ajet ka zbritur për filanin e për atë e këtë fis, kurse shkaqet e zbritjes së ajeteve i lexuan në mënyrë që të pohojnë gjenetikën e Librit, duke mos parë se transmetimi, sado i rëndësishëm dhe me peshë të jetë, ai nuk vlen për mohim të asaj që është e ditur dhe e njohur doemos. Nëse do të kishte ndodhur të kundërshtoheshin transmetimi me dijen dhe bindjen e plotë të ajeteve kur'anore të qarta, do të ishte e domosdoshme të mohohej transmetimi, kjo sepse njohuritë themelore do të mjaftonin të nënkuptonin se Kur'ani është i mbrojtur dhe i pandryshuar. Në esencë transmetimi është veprim njerëzor, ai nënkupton përcjelljen e të dhënave, që flasin për ndodhi që burojnë nga njerëz të tjerë që kanë jetuar më herët, e që kanë thënë gjëra, të cilat shpeshherë vijnë në formë të “përcjell filani nga filani” (*an-an*), por edhe në formën: “Më ka treguar filani ose më ka lajmëruar filani..”. Qëllimi i tyre është verifikimi dhe konfirmimi i lajmit të transmetuar. Kur'ani nuk pranon që procesi i verifikimit të tij dhe i dokumentimit të tij të mbështetet në transmetim, kështu nuk vlen as sfidimi i shumë transmetuesve. Çështja e përcjelljes erdhi vonë, pasi Kur'ani ishte plot argumentues dhe verifikues.

Kur disa menduan se ekziston mundësia e kundërshtimit të brendshëm midis provave juridike (të sheriatit), atëherë u paraqitën thëniet e disave në fushat e fikhut dhe usuli-fikhut bazuar në parimin e kundërshtimit. Që këtej, këta vendosën nes'hin (abrogimin) dhe folën për preferencën (favorizimin) e provës së prerë ndaj provës së supozuar (hipotetik, të jo sigurt) si dhe gjërave tjera.

Këta gjithashtu përforcuan dhe mbështetën vlerën e transmetimit (rivajetit) dhe i pranuan leximet e shumëllojshme si dhe pohuan (folën për) ekzistimin e leximeve autentike, të dobëta, të vetme dhe të çrregullta (pazakonta). Nuk ishte e udhës që këta të shkonin aq larg e të arrinin në këtë udhëkryq, se Allahu ishte që Kur'anit i dha mbrojtje në nivel të fjalës: *"Fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë."* – si dhe në nivel të ajetit dhe të sures.

Çështja e kundërshtimit dhe favorizimit (parapëlqimit) na solli shumë thënie që ne nuk kishim fare nevojë për ato, siç nuk kishim nevojë që transmetimi (rivajeti) të jetë vendim gjykimi për Kur'anin dhe të kishte lidhje me të, e lëre më të ketë lidhje sfidimi të tij. Kur'ani do të duhej të lexohej vetëm ashtu siç Allahu dëshiron, i mbledhur siç Allahu dëshiroi, siç e lexuan vetë sahabët e të Dërguarit s.a.v.s. Është gabim të mendohet se kodifikimi i Kur'anit u bë me përpjekjet e shokëve të të Dërguarit s.a.v.s., ai ndodhi vetëm me urdhër të Allahut të madhëruar, u shkrua siç e lexoi vetë i Dërguari i Allahut, me gjuhën që ishte shpallur, e kjo do të nënkuptonte se i Dërguari s.a.v.s. e kumtoi atë në mënyrë të përkryer dhe të plotë. Ai nuk do të ndahej nga kjo botë duke lënë diçka të paplotësuar, e as që do të lejonte që dikush tjetër kushdo qoftë ta bënte atë pas tij. Prandaj, thënia se leximet e çrregullta (të pazakonta) e të vetmuara kanë vlerë, janë thënie që zbresin nivelin e Kur'anit në nivel të transmetimeve, lajmeve dhe të dhënave. Do të ishte e

udhës që Umeti i Kur'anit të qëndronte në kufijtë e mbrojtjes së Kur'anit, kodifikimit dhe renditjes së tij që u bë me urdhër të Allahut të Madhëruar, e që u realizuan nga i Dërguari s.a.v.s., të qëndronte në bindjen se askush nuk mund të ndryshojë, heq ose shtojë diçka. Allahu i Madhëruar thotë: *“Sikur (Muhamedi), në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë.”* (El-Hakka, 44-45)

## 2. Shembuj të transmetimeve që kundërshtojnë mbrojtjen e Allahut të Madhëruar të Kur'anit

Disa transmetime supozojnë se në Kur'an ka lexime (mënyra leximi) që janë rezultat i gabimeve të transkriptuesve dhe shumëllojshmërisë së gjuhës arabe si dhe që në Kur'an ka që është e pazakontë (e çrregullt, lexim). Es-Sujuti, në veprën e tij *“El-Itkan”* përcjell nga El-Bakil-lani që thotë: *“Leximi ndahet në lexim autentik, i vetmuar dhe i çrregullt. Leximet autentike (mutevatir) janë shtatë leximet e njohura, të vetmuara janë tri leximet, e që gjithsej bëhen dhjetë.”*

Qendrat e studimeve islame do të duhej që Kur'anin fisnik ta pastrojnë nga të gjitha këto thënie, ta shpëtojnë atë nga gjërat që i përmbajnë shkencat e Kur'anit (ulum 'ul-Kur'an) e që paraqesin fatkeqësi dhe devijime, që sot e kësaj dite i vuajmë. Që këtej, ne kërkojmë korrigjimin (rishqyrtimin) e kësaj trashëgime dhe prezantimin e saj përballë Kur'anit dhe pastrimin e tij nga transmetimet që e kanë rënduar kurrizin e Umetit përballë Librit të Zotit të tij. Mendoj se do të duhej që Kur'anin ta vendosim gjykatës të të gjithë kësaj trashëgime transmetuese, kushdo që të jetë ai drejtim, dhe të mos lejojmë polemika e debate medhhebore që veçse na e kanë shtuar largimin nga Libri i Allahut dhe kanë futur shpirtin e fanatizmit për trashëgimitë të medhhebit.

### E dyta: Ndërtimi (formimi) i një diskursi kur'anor

Ilm 'ul-kelami, në formën (modelimin) e tij të trashëguar llogaritet proces i pjekur dhe i djegur, në asnjë mënyrë dhe situatë i aftë për studim dhe shqyrtim. Do të ishte parësore për fakultetet dhe drejtimet studimore që merren me këtë t'i mbledhin të gjitha shkrimet që datojnë deri në shekullin e fundit dhe t'i vendosin në rafte, që të jenë burim për studiuesit dhe hulumtuesit e specializuar që do të kenë nevojë. Nuk do të pengonte që prej tyre një pjesë të përzgjidhej e të mbetej e mirëseardhur për tematikat në fjalë. Krahas kësaj, këto njohuri të përzgjedhura do të barazoheshin me dituri të tjera, kështu që studiuesit do të kishin dobi nga të njëjtat, siç është "çështja e imametit", e cila duhet t'i referohet politikës juridike, por edhe me të gjitha ato që kanë të bëjnë me tematikat dytësore, polemikës dhe diskutimit për to. Këto njohuri do të duhej gjithashtu t'i referohen shkencave të gjuhës dhe studimeve gjuhësore që kanë të bëjnë me to, siç është p.sh. a është gjuha çështje e vendosur nga ana e Krijuesit apo çështje e njeriut, çështjet që dalin nga hulumtimet për metaforën dhe të vërtetën, çështjet juridike (fikhore) që kanë depërtuar në ilm 'ul-kelamin, që këto çështje të zgjerojnë fushën e ndërtimit të një ilmu 'ul-kelam të ri, diskurs të ri kelamist të përshtatshëm për kohën, që të mund të diskutohen gjërat qysh nga takimi i Lindjes me Perëndimin nën prizmin e civilizimit modern e deri më sot. Kjo do t'i jepte rast të volitshëm hulumtuesve të specializuar për mbi-keqyrje dhe studim të dyshimeve që u nxitën kundër Islamit dhe muslimanëve.

E gjithë kjo kërkon njerëz që do t'i studiojnë rrënjët dhe historinë e këtyre dyshimeve, mënyrën e trajtimit të tyre, shpjegimin e qëndrimit islam ndaj lirive, duke mos cenuar askënd për të keqe, diskutimin e trendëve bashkëkohorë, diskursin liberal dhe përgjigjen për pyetjen e rimëkëmbjes



së fortë: pse muslimanët ngecën e të tjerët përparuan? Përndryshe, cila do të ishte dobia e diskursit kelamist nëse studimet dhe hulumtimet e tij përkufizohen vetëm në tematikat trashëguese të debateve mu'tezile, esh'arite, murxhite, maturidite, sunite dhe shi'ite dhe shumë shkrimeve e thënieve shumica e të cilave llogariten vetëm shqyrtime të panjohura (padobishme).

Ne thërrasim për në ilm 'ul-kelam të ri, një ilm 'ul-kelam të përgatitur mirë, që doemos t'i përgjigjet pyetjeve vendimtare, të ofron përgjigje që muslimanëve do t'ua ruajnë Imanin dhe do t'i mbrojnë nga shirkun, dyshimi, mendimi i paqëlluar apo ngatërrimi i së vërtetës me të pavërtetën, do t'i mbrojnë nga shndërrimi i së vërtetës në të pavërtetë etj. Që të arrijmë te vendosja e parimeve të kësaj shkence, rregullave dhe shtyllave të tij, doemos për ne të gjithë është të bëjmë bashkimin e dy leximeve: leximin e Shpalljes dhe leximin e realitetit (kohës). Pikënisja jonë nga ky bashkim do të na ndihmojë për përcaktimin e një metodologjie të shëndoshë për ndërtimin e ilm 'ul-kelamit të ri, që do të na largojë nga pështjellimi (ngatërrimin). Detyrë e kësaj shkence do të ishte shfaqja e vizionit universal për studiuesit e saj, siç do të ndihmonte në lulëzimin e një diskursi të ri kelamist, i cili do t'i ngërthen të gjitha tiparet e shpalljes së fundit dhe karakteristikat e tij, autoritetin universal të Librit dhe diskursin e tij universal (mbarë njerëzorë).

### E treta: Ilm 'ul-kelami islam dhe ndikimet e tij

Themeluesit dhe ata që vendosën parimet e ilm 'ul-kelamit pohojnë se kjo shkencë mbron bindjet (besimet) islame nga dyshimet. Mirëpo, ne vërejmë se kjo shkencë, pas devijimit që e goditi, vetë kishte bërë që ato dyshime të forcohen (fiksohen), kështu që për Librin e Allahut u drejtuan shumë goditje shpifëse, që dolën nga ata që ishin të paaftë t'ju për-

gjigjen dhe t'ju bëjnë ballë sfidave, prandaj filluan t'i kundërshtojnë sfidat në fjalë me nxitje dyshimesh dhe sajime të dyshimeve, të akuzojnë me mungesa dhe zmadhime, se ato përmbajnë gjëra të paqarta, të pa verifikuara, alegorike, të pazakonta, kundërshtuese të analogjisë etj.

Burimet e shumta janë që ruajtën një numër të madh të këtyre shpifjeve (goditjeve) që autoriteti i transmetimit solli në përforcimin dhe shqyrtimin e tyre, aq sa këto burime u bënë ndër burimet më të rëndësishme studiuese për kundërshtarët e Islamit, orientalistët dhe nxënësit e tyre.

Shpifjet e tilla mund të ndahen në grupe:

- Shpifje për akuzim se në Kur'an ka shtesë, siç janë suret Felek dhe Nas, te disa surja Fatiha, si dhe shtimi i sures Jusuf për Mejmunitët havarixh.
- Shpifjet se në Kur'an ka mangësi, kjo në bazë të hadithit të transmetuar dhe shpifur nga Aisha r.a. se surja el-Ahzab ka qenë aq sa është surja el-Bekare, por që pastaj është shpallur në 73 ajete vetëm. Disa Gulatë supozuan se është shlyer surja që quhej me emrin "surja e miqësisë" (dashamirësisë) dhe pretendimi se ajo gjendet në mus'hafin e Fatimes.
- Shpifjet lidhur me abrogimin (nes'hin), e që të tillat ndahen në disa grupe.
- Shpifjet për pretendim se ekzistojnë ajete jo krejt të qarta (me kuptime alegorike), të pakuptimta etj. Si dhe shumë shpifje të tjera të ngjashme me ato të hebrenjve dhe të krishterëve, disa prej të cilave ishin shpifje që as nuk u kishte shkuar ndërmend atyre, por nën peshën e transmetimit arritën tek ne, kurse i absorbuan dhe i zhvilluan shumë mufesirë (komentues të Kur'anit), dijetarë të usulit e tjerë, siç përmend Raziu: "Njeriu, para se të ishte i rrethuar me thënie dhe shkrime të çu-

ditshme dhe drejtime të rralla (panjohura), ishte me besim dhe bindje të plotë se të gjithë muslimanët pohojnë se ajo që është midis dy kapakëve të Librit është fjalë e Allahut të Madhëruar, por kur filloi të hulumtojë për thëniet dhe shkrimet e çuditshme në fjalë, ai gjeti se aty ka një kundërshtim dhe mospajtim të madh, siç transmetohet nga Ibn Mes'udi se: "Kishte mohuar që El-Fatihaja dhe surja El-Felek dhe En-Nas të jenë nga Kur'ani." Ishin disa hadithe që u morën për bazë për këto dyshime. Dijetarët ishin të ndarë në grupe rreth qëndrimit të tyre për sa i përket këtyre haditheve, ata u ndanë në katër grupe: i pari që pretendonte pavërtetësinë e tyre, i dyti që i pranonte dhe pohonte vërtetësinë e tyre, por duke ndjekur metodat e interpretimit dhe parapëlqimit, i treti ishte grup devijues dhe që devijonte, ishte grupi që nxitonte në pranimin e transmetimeve dhe saktësimin e tyre me qëllim të shfaqjes së tyre në vijat më të largëta, dhe i katërti që i pranoi këto transmetime dhe i kundërshtoi me transmetime tjera favorizuese, shumica e të cilave ishin autentike (mutevatire) dhe që largonin çdo dyshim të shpifur për Kur'anin (kur'anizimin në fjalë). Grupin e fundit e përbënin shumica e dijetarëve dhe shumica e mufesirëve (komentuesve).

Kur'ani është Libër i Allahut, mjafton sfidimi i tij, renditja e përkryer e tij, metodat e tij, rrjedhshmëria e gjuhës së tij, stilistika e tij, konteksti i tij, që njerëzit të mos munden të sjellin të ngjashëm me të, një gjë të tillë e pohon çdo ajet, çdo fjalë dhe çdo sure e Kur'anit fisnik.

Për sa i përket nes'hit (abrogimit), ai ndahet në tre lloje:

- Abrogimi i leximit me ngeljen e dispozitës.
- Abrogimi i dispozitës me ngeljen e leximit.
- Abrogimi i leximit dhe dispozitës së bashku.

Kujtoj se këtë çështje e kemi diskutuar shumë dhe kemi arritur në përfundim se në Kur'an nuk ka nes'h (abrogim), se ajo që i bëri të tjerët të mendojnë se në Kur'an ka nes'h ishte mendimi se aty ka barasvlerë midis provave që kërkon favorizim ose abrogim, parimi i kohës të tekstit të mëparshëm dhe atij të mëvonshëm dhe prezenca e provës së prerë dhe atij të paprerë si dhe që nes'hi do të mund të ngërthente në vete lehtësim dhe mëshirë.

*Muhkem* dhe *muteshabih* (ajetet krejt të qarta dhe ato jo krejt të qarta).

Autorët e veprave mbi shkencat e Kur'anit shtruan një bisedë të gjatë për ndarjet e ajeteve kur'anore, të cilat i ndanë në: *muhkem*, *muteshabih* (të qarta dhe të paqarta), me *muteshabih* nënkuptonin ajetet e paqarta që kanë nevojë për shpjegim dhe komentim. Por, ne e lexuam Kur'anin nga fillimi e deri në mbarim, aty gjetëm që ai gjithmonë është plot urtësi, dritë, udhëzim, shërim për zemrat dhe shpirtin, i qartë dhe i kuptuar, dritëdhënës, shkëlqyes, pa asnjë paqartësi e as shtrembërim, bile ai vetë është shpjegues (bejan), që njerëzve ua shpjegoi gjërat për të cilat ata vetë kishin mospajtim, ai është i lehtë për t'u lexuar dhe mbajtur mend.

Vepra e Bakil-laniut "El-Intisar li 'l-Kur'an" (Triumfi i Kur'anit) numërohet ndër veprat më të rëndësishme që kanë paraqitur dyshime tjera që ishin deri në kohën e tij, ai për të gjitha këto dyshime dha përgjigje, të njëjtat i shkuli nga rrënja dhe i demantoi. Do të ishte e dobishme për brezat tonë sikur ta studionin këtë vepër, së paku versionin përmbledhës të tij, sepse janë disa që mendojnë se shumë nga dyshimet e nxitura nga shumë njerëz e që janë prezent në kohën tonë, janë të reja.

Diskursi kelimist pra është ndërtuar dhe themeluar larg Kur'anit, por më pas kthehet tek ai për të përdorë ajetet e tij si dëshmi për bindjet dhe mendimet e tij, për të mbështetur

pohimet e tij! Nuk duhet harruar se fitneja më e madhe që ndodhi ishte nga leximi i Kur'anit pjesë-pjesë, lexim i ndarë pra, ishte lexim prezent në atë kohë, ai bëri që ky lexim të përdorej si dëshmi për mbështetje të pretendimeve të caktuara.

Allahu i Madhëruar thotë: *“Për çfarëdo gjëje që ju të diskutoni, fjala e fundit i përket Allahut.”* (Esh-Shura, 10)

*“Thuaj: “O ju njerëz, ju erdhi e Vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar për dobinë e vet dhe kush e humb rrugën e drejtë, ka humbur në dëmin e vet, ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj.”* (Junus, 108)

Këto ajete përmbajnë shpjegim të qartë (janë fakte të qarta) që arrijnë të mbrojnë diskursin kelamist nga gjërat që i ndodhën dhe gjërat për të cilat ata u dhanë. Prandaj, leximi ndaras (pjesë-pjesë) do të mbetet e metë kryesore e diskursit kelamist. Integrimi (uniteti) struktural i Kur'anit fisnik është rruga e vetme për prezantimin e të gjitha elementeve vetë-shpjeguese gjatë leximit të tij. Kur'ani është shpjegim për çdo çështje, ai është burim themelor i ndërtimit, ndërsa Suneti është burim shpjegues, që nënkupton se është shpjegues praktik. Suneti bashkëvepron me Kur'anin në integrimin e tij struktural, veçmas në cilësinë e tij se është metodologji e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. e aktivizimit të tij në praktikë (në jetë). S'ka dyshim se nga ne kërkohet që ta ndjekim këtë metodologji, atë të aktivizimit të Kur'anit në jetën tonë. Ne nuk jemi të detyruar (nga ne nuk kërkohet) që të evokojmë realitetin historik të brezit që dëshmoi dhe pranoi shpalljen. Vetëm kështu ne do të mund ta nxjerrim Umetin nga leximet ndarëse (pjesë-pjesë), nga fushat e polemikës rreth hadithit të paqartë dhe të dhënat e paqarta, nga kundërshtimi, favorizimi dhe vlerësimi i barbartë. Do të ishte e udhës që të sjellim një shembull, që me siguri do të na ndihmonte për ta kuptuar më mirë çështjen,

atë të mospajtimit të dijetarëve bashkëkohorë rreth dispozitive të fotografimit, pikturimit dhe punimin e statujave etj.

### E katërta: Vetëdija për referimin e Kur'anit në medhhebet e ndryshme islame

Kur'ani është burim i fillimit të modelimit dhe ndërtimit të dispozitës, ai e krijon atë, e shpalos dhe e mbikëqyrë, ai nxjerr në dritë çdo gjë që ishte e zhdukur, ai vërteton çdo gjë që ishte ekzistuese, që pastaj ta mbrojë nga ndryshimi dhe shtrembërimi. Ne do t'i nxjerrim në dritë këto veçori kur'anore, duke treguar qartë se një gjë e tillë do të duhej të ishte detyrim i procesit mësimor në fakultetet e fikhut dhe degëve të tij. Nëse kjo ndodh, atëherë me siguri se fikhu do të shpëtonte nga tendencat ndarëse (pjesëze), gjetshmëritë (fiksionet) juridike, hipotezat e shumë të tjera gjëra që ishin fatkeqësi për fikhun e që ishte rezultat i ndarjes së tij nga Kur'ani fisnik.

Do të prezantojmë disa shembuj që na kujtojnë faktin se Kur'ani ishte referenca e parë prezent në mendjen e dijetarëve të drejtimeve të ndryshme, por që fusha e veprimit të tyre (lëvizjes) u ngushtua gjatë paraqitjes së raportit midis Kur'anit dhe Sunetit me pretendimin se raporti i tillë është rendore; Suneti merr iniciativë në vend të Kur'anit kur mu-xhtehidi nuk arrin të gjejë provë të paplotë (papërfunduar) në të, në rastin kur ekziston një kundërshtim midis provave të paplota në burimet tjera. Ndërkohë që autoriteti i Kur'anit konstaton se çdo provë e papërfunduar ka bazë përfundimtare në Kur'an, ndaj e domosdoshme është t'i referohen atij për njohje të tij dhe marrje për bazë për çështjet dhe ndërtimin e degëzimeve (nënndarjeve) që dalin më vonë. Allahu i Madhëruar thotë: *“Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë.”* (El-En'am, 38)

*“Shpjegim i të gjitha çështjeve.”* (En-Nahl, 89)

Që t'i referohemi tjetrit para se t'i referohemi bazës, s'do mend se do të ishte akuzë për Kur'anin se ka harruar diçka rreth atyre çështjeve dhe nuk i ka shpjeguar, se nuk mjafton. Allahu i Madhëruar thotë: *“Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre?”* (El-Ankebut, 51)

### 1. Ibaditët<sup>3</sup>

Në veprën e Ebu Ubejde Muslim ibn Ebi Kerime<sup>4</sup> “El-Mesail” thuhet: “Prijësi i muslimanit është Kur'ani, udhërrëfyes i tij është Suneti i të Dërguarit të Allahut, muslimani e do vetëm atë që e do Allahu dhe i Dërguari i Tij.”

Ibn Bereke në veprën “El-Xhami” thotë: “Të gjitha dispozitat e sheriatit kanë një bazë dhe merren nga një rrugë e vetme, nga Libri i Zotit të botëve. Allahu i Madhëruar thotë: *“Ndiqni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj e mos ndiqni mbrojtës të tjerë, përveç Tij. Sa pak që i pranoni këshilla!”* (El-A'raf, 3). Suneti është dy llojesh: Suneti për të cilin ka konsensus (pajtim), është ky Suneti për të cilin nuk ka nevojë për konsensus tjetër për të vërtetuar saktësinë e tij dhe Suneti për të cilin ka mospajtim, është Suneti për të cilin njerëzit kanë përplasje, sepse nuk e kanë plotësuar tërë njohurinë për të. Suneti i llojit të dytë doemos kërkon hulumtim për saktësinë e tij e pastaj mospajtim për interpretimin e tij, nëse vërtetohet saktësia e transmetimit të tij, por nëse kanë mospajtim për dispozitën e tij, atëherë i referohen Librit të Allahut.”

<sup>3</sup> I vetmi sekt i mbetur nga harixhitët. Aktualisht, ata nuk janë ekstrem. Ka në Oman, në Afrikën Lindore, në Libi, Tunizi dhe në Algjeri. Për shkak të afërsisë gjeografike, kanë ngjashmëri të caktuara me malikitët. (shën. i përkth.)

<sup>4</sup> Imami i dytë i ibaditëve në Basra.

## 2. Zejditët<sup>5</sup>

Imami Murteda Muhamed in Jahja Hadi (vdiq më 310 hixhri) mendon se Suneti: “Është ai që përputhet me Kur’anin, se ajo që e përgënjeshton (kundërshton) Kur’anin, është gënjeshtër për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Suneti është shpjegues dhe komentues i hollësishëm i fjalive të Kur’anit të madhëruar.”

Në disa përgjigje për çështjet të cilat iu prezantuan Imamit në fjalë qëndron: “Gjithë atë që e kemi thënë dhe jemi përgjigjur për gjërat e ndryshme, dëshmia është në Librin e Allahut të Madhëruar dhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. për të cilin ka konsensus të plotë. Dëshmi gjithashtu ka edhe në provën logjike të cilën e vërteton Kur’anin. E gjithë ajo pra që vërtetohet përmes kësaj rruge është e saktë dhe e kërkuar, është provë më e ndritshme në zemrat...”. Për Imamin në fjalë prova nënkupton Librin e Allahut të Madhëruar, ixhmain (pajtimin e dijetarëve) e mbështetur në Kur’an dhe Sunet, ashtu siç deklarohet ai në shumë vende të ndryshme të veprave dhe porosive të tij.

## 3. Imamitët

Kujtoj se pasqyrën e imamitëve rreth referencës së Kur’anit fisnik e kishte kapluar një paqartësi, si shkak i përhapjes së lajmeve të rrymave që ekzistonin midis shekullit 11 dhe 12 hixhri, që kishin hedhur poshtë referencën e Kur’anit tek ata, dhe që këtu kujtoj se është i nevojshëm një sqarim për këtë. Lajmet në fjalë pohonin pamundësinë e kthimit në referencën e Kur’anit, po edhe të Sunetit gjithashtu, një gjë e tillë do të arrihej vetëm përmes gjërave të theksuara nga imamët e mbrojtur (të pagabueshëm) të ehli-bejtit. Istrabadi (vdiq më 1036 hixhri), në veprën e tij “El-Fevaid ‘ul-Mede-

<sup>5</sup> Njëri prej tre gupeve kryesore të shi’itëve.



nijje” thotë: “Është i pamundur (absurd) veprimi që dispozitat të dalin nga paraqitjet e jashtme të Kur’anit po as nga paraqitjet e jashtme të Sunetit profetik, kjo arrihet vetëm duke iu referuar dijetarëve të denjë (ehlu-dhikri), ngase Kur’ani ka zbritur i panjohur për mendjet e banorëve të vendit, ai ka zbritur në bazë të nivelit të mendjes së dijetarëve të denjë (ehlu-dhikri).”

S’ka dyshim se kjo do ta përkufizonte referencën vetëm në mësimet dhe të dhënat e ehli-bejtit. Ai më tej thotë: “Është e ditur se gjendja e Kur’anit dhe e Hadithit pejgamberik (nasihu, mensuhi etj.) mësohet vetëm nga dijetarët e ehli-bejtit, një gjë e tillë përkufizohet vetëm në thëniet e tyre.”

Kashif Gita<sup>6</sup> (vdiq më 1228 hixhri) bëri një lidhshmëri mes mundësisë së kthimit (referimit) në tekstin kur’anor dhe të kuptuarit të tij drejtpërdrejt dhe pamundësisë (i’xhazit të tij), duke thënë: “Çfarë do të nënkuptonte sfidimi që arabët të sjellin një Kur’an të ngjashëm si ai, kur ata nuk e kuptojnë atë?! Ai për ata ishte vetëm simbol (shenjë), haj-mali dhe shenja të paqarta.”

Ndërkaq Sherif Murteda (vdiq më 436 hixhri) mohoi argumentimin me të dhënat e vetmuara (hadith ahad), sepse mjaftonin për vetëm për mendim (jo bindje prerëse). Ky mendonte se së pari duhej të veprohej sipas kuptimit të jashtëm të Kur’anit dhe të dhënave prerëse të Sunetit, e në rast të mungesës së tyre mbështetja kalon në ixhma’, që ky ka për qëllim ixhmain e imamitëve, por edhe nëse këtu nuk ka pajtim dhe midis imamitëve ka mospajtim të konsideruara, atëherë i referohemi tekstit të Kur’anit, e nëse jo, atëherë mbështetemi në vendimin e logjikës, e në fund të mbështetemi në zgjedhje.”

<sup>6</sup> Që ka kuptimin e Zbuluesi i Paqartësive.

Tusi në parathënien e veprës së tij, “Tefsir ‘ul-Ahbar”, thotë se të interpretuarit e Kur’anit me logjikë është i ndaluar, qoftë ai të burojë nga imamët apo kundërshtarët e Sunetit të Dërguarit s.a.v.s. Tabrisi (vdiq më 548 hixhri) në tefsirin e tij “Mexhme’ ‘ul-Bejan” mbështet Tusiun dhe thotë: “Allahu i Madhëruar i sqaroi rrugët e nxjerrjes të dispozitave dhe e pëlqeu atë, Ai thotë: “...*Hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo).*” (En-Nisa’, 83) Ai i qortoi të tjerët që shpërfillën përsiatjen e Kur’anit dhe hodhën poshtë kontemplimin për të. Allahu sqaroi se Kur’ani është i shpallur në gjuhën arabe, dhe thotë: “Në të vërtetë, ne e kemi shpallur Kur’anin në gjuhën arabe...”. (Ez-Zuhruf, 3). I Dërguari s.a.v.s. thotë: “Nëse ju vjen ndonjë hadith, atë paraqitjani Librit të Allahut, ajo që është në pajtim me të pranojeni, e ajo që e kundërshton atë, hidheni poshtë.” Ai sqaroi se Kur’ani është argument dhe burim referues, e si mundet që diçka t’i paraqitet atij nëse është i pakuptimtë?! Kjo do të nënkuptonte atë se: “Nëse është e saktë se ai që e interpreton Kur’anin me logjikë, duke mos vepruar sipas dëshmimeve të shprehjeve, edhe nëse e qëllon të vërtetën, le ta dijë se ka gabuar provën.”

Dijetari Hilja është i mendimit se është e papranuar që Allahu të dëshirojë të kundërtën e kuptimit të qartë, përveç se kur për të ekziston e dhënë shtesë.

Nga transmetimet e tjera me të cilat shërbehen për argumentim është edhe ai që transmetohet nga Ebu Abdullah alejhi selam, që thotë: “I Dërguari s.a.v.s. tha: “Çdo e vërtetë ka të vërtetën e tij, çdo e saktë ka dritë, ajo që përputhet me Kur’anin merreni, e ajo që nuk përputhet lëreni.” Ky dhe hadithet e tjera që autori i shtron në thëniet e tij provojnë se Libri i Allahut është baza e çdo të vërtete dhe të sakte, se çdo gjë që Kur’ani e vërteton, doemos duhet të merret në konsideratë, kurse çdo gjë që Kur’ani e kundërshton, ajo

duhet të mënjanohet, ndërsa për çdo gjë që nuk kemi njohuri për përputhjen e tij apo mospërputhjen, jemi të detyruar të përmbahemi.

#### 4. Ehlu Suneti

Shafi'iu thotë: “Ka disa që thonë: ‘Nuk ndodh që diçka të konsiderohet Sunet, e të mos ketë bazë në Kur’an, siç ishte Suneti i të Dërguarit s.a.v.s. të sqaronte numrin e rekateve të namazit dhe mënyrën e tyre në bazë të fjalisë që detyron namazin. Gjithashtu janë sunetet që shpjegojnë rregullat e shitblerjes dhe dispozitave të tjera ligjore. Allahu i Madhëruar thotë: *“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht!”* (El-Bekare, 188)

*“Porse Allahu e ka lejuar tregtinë kurse kamatën (ribanë) e ka ndaluar.”* (El-Bekare, 275)

*“Pejgamberi s.a.v.s. të ndaluarën dhe të lejuarën e shpjegoi nga Allahu, siç e shpjegoi namazin.”*

Shatibiu është i mendimit se Suneti në kuptimin e tij i referohet Kur’anit, se ai është shpjegim i tij: “Nuk arrin të gjesh në Sunet një çështje e që Kur’ani të mos e tregon kuptimin e tij, qoftë të jetë përmbledhës ose i hollësishëm. Kjo ngase Allahu e bëri Kur’anin shpjegim për të gjitha çështjet, prandaj nga kjo del se Suneti doemos të jetë rrjedhojë e tij (e ngërthyer në fjalinë që Kur’ani është shpjegim për çdo gjë). Allahu i Madhëruar thotë: *“Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë.”* (El-En’am, 38). Suneti, si përfundim i kësaj është shpjegim i asaj që është në Kur’an, kjo nënkupton se ai i referohet atij, këtë e pohon studimi i plotë i bërë për këtë.

S’do mend se kjo na bënë të arrijmë në përfundimin se vetëdija elementare (esenciale) e të qenit të Kur’anit vendim dhe burim themelor (ndërtues) ishte prezent te studiuesit e shkencave juridike islame, por që kjo vetëdije nuk arriti të ngrihet në nivelin e një metodologjie të plotë.

Allahu i Madhëruar na tregon se Ai është që i pajtoi zemrat e besimtarëve. Ai nuk tha që zemrat e tyre i bëri një (të unifikuara), sepse unifikimi kërkon shkrirje (bashkim) të plotë midis tyre. E gjatë procesit të shkrirjes ndodh që disa veçori personale të humben (nëse do të ishte unifikimi i tyre i plotë, e jo pajtimi), ndërkaq që pajtimi është proces që realizon kufijtë më të lartë të mundshëm të pajtimit, ashtu që ndryshimi i gjuhës dhe i ngjyrës bëhen ndryshime të llojit që ndihmon njohjen reciproke të njëri-tjetrit dhe solidaritetin midis tyre, gjë që do të mundësonte realizimin e detyrave për arritje civilizuese dhe jetësore, por edhe plotësim të besëlidhjes mes Allahut dhe njeriut, realizim të mëkëmbësisë dhe plotësim të amanetit. Kjo do të ndihmonte edhe në realizimin e qëllimeve të përbashkëta njerëzore dhe angazhimin e karakteristikave personale në shërbim të kësaj dhe mos pezullimin e të njëjtës. Një gjë e tillë do të realizohej siç vijon:

- Lidhja e çështjeve mospajtuese me objektivat e larta dhe vendimtare të Kur'anit fisnik, që janë: tevhidi, edukata (tezkije), qytetërimi, mirëqenia, umeti, da'veti etj. Këto ndihmojnë dhe njëherit janë themel i zhvillimit të Umetit të Kur'anit që do të merr përsipër zbatimin e rolit të hilafetit në Tokë.
- Trajtimi i çështjeve mospajtuese brenda sferës së bashkimit midis dy leximeve, leximit të Shpalljes dhe leximit të gjithësisë (jetës). Është e domosdoshme që çdo çështje me dimension metafizik të trajtohet përmes lidhjes së gajbit me njeriun, të materiales me jomaterialen.
- Trajtimi i çështjeve mospajtuese, të cilat edhe sot e kësaj dite ushtrojnë rolin e tyre në copëtimin e Umetit në formë vertikale e jo horizontale. Ato janë çështje të sajuara (ndërlikuara), ato nuk janë çështje të heshtura

e të errëta. Kujtoj se për këto çështje do të duhet të jenë të mirinformuar të gjithë ndjekësit e medhhebeve, që të mos lejojnë përsëri të futen në vazhdimësi në fyerje medhhebore (grindje e përplasje). Çështja e Imametit llogaritet të jetë çështja më e madhe mospajtuese, është kjo që i krijoi mospajtimet e para, që shkaktoi ndarjet, ajo edhe më tej vazhdon ta bëjë të njëjtën sot e kësaj dite, bile është çështje që ka pezulluar (shutupur) vullnetin e Umetit.

Mospajtimi për çështjen e Imametit mund të dallohet në disa nivele, këtu kemi të bëjmë me nivelin e meritës individuale që lidhet me një person të caktuar i cili plotëson kushtet që nuk i ka tjetri dhe meritave të dëshmitarëve dhe mëkëmbësisë (hilafetit) së Umetit të Kur'anit (si bashkësi): *“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë kundër njerëzve dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar kundër jush.”* (El-Bekare, 143)

Kjo do të mund të realizohet vetëm me anë të një strukture që do t'i rregullonte të gjitha gjërat. Niveli i parë përfaqëson sferën individuale (personale) të çdo medhhebi, varësisht sipas bindjeve të ndjekësve të tyre, ndërkaq që niveli i dytë përbëhet prej dy krahëve; njëra që ka të bëjë me referimin, dhe e dyta që ka të bëjë me realitetin ndryshues që ka braktis kontekstin historik ku lindi mospajtimi rreth Imametit.

Rruga e vetme e zgjidhjes së mospajtimit për Imametin është çlirimi nga prangat robëruese personale dhe të së kaluarës, që debati të orientohet drejt referencës. Është e palogjikshme që të përpiqemi të zgjidhim çfarëdo problemi duke u mbështetur në elemente që janë prezent brenda tij (elemente personale, historike etj.), zgjidhja kërkon që të mbështetemi në atë që është jashtë sferës medhhebore, përndryshe, duke dëshiruar që t'i zgjidhim ato, ne do të jemi

që vetëm kemi riprodhuar mospajtime. Kur'ani do të mund të na bashkojë vetëm atëherë kur ne do të bëhemi Umet, dhe ne do të arrijmë t'i flakim përçarjet tona vetëm atëherë kur do t'i kthehemi autoritetit të Kur'anit në cilësi të burimit ndërtues e zhvillues, vetëm atëherë kur Kur'ani për ne të jetë burim i shenjtë, qoftë kur jemi në gjendje mospajtimi ose pajtimi.

Prania e autoritetit të Kur'anit do ta ndryshojë strukturën e procesit të ixhtihadit, sepse verifikimi i çdo prove me saktësi ose paqartësi do të përqendrohet në vërtetimin e ekzistimit të bazës në Kur'an, kuptohet në bazë të unifikimit struktural të Kur'anit. Këtu kemi të bëjmë edhe me një të vërtetë objektive që kujtoj se çdo medhheb duhet të mos e shpërfillë, ajo se ndodhitë dhe kontekstet historike dhe shoqërore ndryshojnë nga vendi në vend, se brezat e kaluar jetuan në rrethana krejt ndryshe nga ajo që ne jetojmë. Prandaj them që kjo do të na detyronte të gjithëve t'i kthehemi fillim e fund Kur'anit, që pyetjet tona t'ia parashtrijmë atij, që ai të flet për përmbajtjet e tij, që Suneti i të Dërguarit s.a.v.s. të jetë metodë orientimi për aktivizimin e Kur'anit në kontekstin historik për brezin që e pranoi atë, e që më pas ne ta zhvillojmë këtë aktivizim kur'anor në kontekstin tonë bashkëkohorë si në aspektin shoqëror ashtu edhe në atë kulturor.

Zgjidhja e realiteti politik dhe i menaxhimit të çështjeve të Umetit do të jetë i mundur vetëm kur konceptit të Umetit t'ia rikthejmë boshtin e tij kryesor, siç kuptohet nga Kur'ani fisnik. Diskursi kur'anor i flet Umetit, e jo individit të tij, e kur ai flet për disa në mënyrë të veçantë, ajo nuk nënkupton se janë individë jashtë Umetit, por thotë: *“O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja nga mesi juaj. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit.”* (En-Nisa', 59)

*“..dhe atyre që drejtojnë punët tuaja.”* – Kjo nuk nënkupton konfirmimin e përzgjedhjes, të cilën Kur’ani e refuzon, me sqarimin e rolit devijues që kanë paritë dhe eprorët: *“Dhe do të thonë: “O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, e ata na devijuan prej rrugës së drejtë.”* (El-Ahzab, 67)

Ata që i drejtojnë punët tuaja janë nga mesi juaj, ata nuk janë kundër jush, siç bënte pushteti i Faraonit: *“Unë ju tregoj vetëm atë që e shoh dhe ju udhëzoj vetëm në rrugën e drejtë.”* (El-Gafir, 29)

Rezultat i kësaj ishte: *“Kështu, ai e mashtroi popullin e vet. Ata iu nënshtruan atij, sepse ishin një popull i pabindur.”* (Ez-Zuhruf, 54)

Ata nga mesi juaj na e bënë të qartë fjalën e Allahut të Madhëruar: *“Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por, në qoftë se këtë lajm do t’ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre. sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri i vogël.”* (En-Nisa’, 83)

Atë që duhet kuptuar nga përcaktimi: *“Paria...”* (që drejtojnë punët tuaja) është vlerësim i dallueshmërisë (shumëllojshmërisë) midis njerëzve, vlerësim i aftësive të ndryshme të tyre dhe orientim i ambicieve të tyre për rregullim të punëve të Umetit, e kurrsesi të kuptojmë se bëhet fjalë për pushtet të tyre mbi të tjerët.

S’ka dyshim se kjo tendencë autoritare ishte shtrirë dhe kishte depërtuar edhe në tefsir (koment të Kur’anit). Që këtë vërejmë se Kurtubiu shprehjen *“temkin - pushtet”* në Kur’an: *“Ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zeqatën, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.”* (El-Haxh, 41) – e konsideroi të veçantë për udhëheqësit të cilët kanë pushtet dhe dominim. Tefsiri i tij

jep për të kuptuar se urdhërimi për kryerjen e veprave të mira dhe pengimin nga të mbrapshtat është çështje e kufizuar për udhëheqësit.

Kujtoj se është e domosdoshme një platformë ideologjike dhe metodologjike e ndryshme që do të ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre çështjeve, të çliruar nga prangat e zgjidhjeve medhhebore, fikhore dhe kelamiste. Doemos që zgjidhjet në fjalë të burojnë dhe frymëzohen nga Kur'ani, se vetëm kështu arrijmë t'i qasemi realitetit të dhembshëm e të hidhur të Umetit. Ne nuk duhet të tërheqim pas vetes tendencat e së kaluarës apo të nxitojmë pas asaj që e prodhoi përvoja perëndimore. Vetëm kështu do të mund të shohim lulëzimin e një vizioni të një strukture të shëndoshë politike që do të merret me çështjet e Umetit në kohën tonë, duke pasur kujdes për ndryshimet historike dhe mospajtimet shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Umeti nuk është bashkësi e shurdhër, që nuk i di gjërat, ai e di se nëse një gjë është e mirë dhe e dobishme për disa, ndodh të mos jetë e tillë për disa të tjerë, e nëse një gjë është e dobishme në një kontekst historik, ndodh të mos jetë e tillë dhe e mundur në një kontekst tjetër historik.

Thëniet e dijetarëve të përmendura më lartë dhe interpretimet e tyre të ndryshme ndihmojnë në disa aspekte, veçmas për krijimin e një platforme (trualli) dhe rikthimin e strukturës pajtuese, por edhe të realizimit të një lloji solidariteti dhe bashkëpunimi midis grupeve të ndryshme. Kjo gjithashtu do të ndihmonte në shndërrimin e mospajtimit në mospajtime shumëllojshmërie e jo kundërshtuese. Popujt e kaluar jetuan të përçarë dhe të armiqësuar mes vete, mes tyre kishte përçarje të madhe dhe mospajtime të mëdha, kjo për shkak se shpërfillën shpalljen e Allahut të Madhëruar. Rrugëdalja e Umetit tonë do të jetë vetëm duke mos hequr dorë nga Shpallja e Allahut, kthimit në udhëzimin e Tij dhe zbatimit të mësimave të Kur'anit.





# Pjesa e pestë

## Mospajtime të shumëllojshme e jo mospajtime kundërshtuese

E para: shumëllojshmëria dhe shumëtrajtshmëria nuk kundërshton unitetin

Ebu Hasen Esh'ariu në veprën e tij *“Mekalat ‘ul-Islamijjin”* thotë: “Pas Muhammedit s.a.v.s, muslimanët arritën të krijojnë mospajtime për gjëra të ndryshme, aq sa njëri-tjetrin e akuzuan për devijim, po edhe arritën të braktisin njëri-tjetrin, kështu ata u bënë fraksione të kundërta njëra me tjetrën, por ishte Islami ai që i bashkonte dhe i përmbledhte.”

Përcillet që Imam Shafiu të kishte thënë: “Nuk e mohoj dëshminë e “ehl ‘ul-ehva” (ata që nuk mendojnë si ehl’ us-suneh ve ‘l-xhema’a: ata janë: xheberitët, kaderitët, rafiditët, havarixhët, muattalët dhe mushebbihitët’), përveç të hitabijëve, sepse këta lejojnë gënjeshtren për të ngadhënjyer ndaj kundërshtarëve të tyre.”

Ndërkaq Ebu Hanife është që asnjërin nga “ehl ‘ul-mille” (muslimanët) nuk e llogarit për jobesimtarë (kafir).

Ibn Tejmije i komentoj thëniet e lartshënuara dhe thotë: “Ne zgjedhim atë që të mos llogarisim për jobesimtarë asnjërin nga muslimanët.”

Mospajtimet midis muslimanëve në akide dhe fikh nuk duhen të jenë hyrje (pikënisje ose derë) e dhënies së vendimeve (vlerësimeve) për shkëmbim të akuzave reciproke me jobesim (kufr), përderisa mospajtimet në fjalë nuk i nxjerrin

nga adhurimi i Allahut Një e të Vetëm. Varxhilani, një dijetar ibadit (vdiq më 570 hixhri) në veprën e tij “Ed-Delil ve ‘l-Burhan” thotë: “Feja Islame i bashkon grupet (fraksionet e Umetit; Nuk thuhet feja kaderite, e as feja murxhite, as feja e Ebu Hanifes, as e Malikut, e as e Shafiut... dhe është e lejuar ndarja e Umetit (mendohet në mendime dhe ide)”.

Doemos të ndalemi e të mendojmë mirë për dome-thënien e shprehjes “kufr” që ibaditët e kanë për qëllim kur me të i karakterizojnë kundërshtarët e tyre, veçmas kur kemi parasysh se janë disa që fjalën dhe thënien e tyre e përcjellin pa sqarim duke menduar se me shprehjen “kufr” për qëllim kanë daljen nga feja. Nuk është e saktë kjo që thuhet për ibaditët, ata me “kufr” nënkuptojnë “*kufri en’ni’me*” (mohim të së mirës, begatisë).

Që këtej mund të themi se ibaditët nuk i përjashtojnë kundërshtarët e tyre nga Islami dhe kjo është baza mbi të cilën duhet ndërtuar dhe mendojmë. Mbi këtë kuptim, dijetari Amili, i njohur si dëshmori i parë (*shehid ‘ul-evvel*) thotë: “Gjatë studimit të mirëfilltë vërejmë që këto gjëra kryesore të kufizuara kanë të bëjnë me pesë gjërat e patjetërsueshme, që janë: dobia e fesë, shpirtit, mendjes, familjes dhe pasurisë. Interesi i fesë ka të bëjë me bindjen, e ai ose është kufr që nënkupton shirkun, ose nuk është kufr. Në këtë bëjnë pjesë thëniet dhe fjalët e risimtarëve të Umetit, siç janë murxhitët, havarixhët dhe muxhessimitët.”

Ndërkaq Xhubaiu, i njohur si dëshmori i dytë (*Shehid ‘uth-thani*) është i mendimit se mjafton vendimi për ndonjërin që është musliman, nëse vetëm pohon dëshminë (shehadetin), ndryshe nga imani, i cili kërkon njohjen dhe pranimin se ai beson në pesë shtyllat dhe të njëjtat i miraton.

Çështja e Imametit konsiderohet bosht i medhhebit zejdi, kjo ngase anëtarësimi në këtë medhheb është i lidhur ngushtë me këtë bindje, por megjithatë këta nuk konside-

rojnë kundërshtarët e tyre për kafirë ose fasikë. Imam Mensur bi'l-lah Abdullah ibn Hamza në veprën e tij, "Esh-Shafi fi 'l-Imame" thotë: "Nëse nuk mund të themi prerë se përvetësuesit e imametit janë kafirë; si mund të themi që ata që i besojnë atij të jenë fasik, qoftë ai që ka bindje për atë të jetë fakih, mu'tezil ose kushdo qoftë ai. Ne themi që të konsideruarit e njeriut kafir ose fasik dëshmohet vetëm me provë të prerë, të logjikës, Kur'anit ose Sunetit të saktë e të njohur, e asgjë nga këto nuk është vërtetuar."

Thënë shkurt, mospajtimi midis fraksioneve të ndryshme të cilët janë ehl 'ul-kible (njerëz të një kibleje, pra muslimanë) nuk përjashton njerëzit nga Islami, sepse e përbashkëta dhe hapësira mëshiruese (tolerante) midis këtyre fraksioneve islame është shumë më e madhe se që janë mospajtimet. Ndodh që edhe midis fanatikëve fraksionist të ketë tolerancë dhe mëshirë. Kujtoj se kjo është një bazë që ne të gjithë duhet ta ndjekim, të kujdesemi të mos e shpërfillim e as të mos e rrënojmë. Ne gjithashtu nuk pajtohemi me kundërshtarët të cilët marrin vendim për t'i gjykuar ata që nuk janë të pajtimit me ata se janë të humbur, shkatërruar dhe banorë të Xhehenemit, kurse ata që i mbështesin janë banorë të Xhenetit. Se a do të jenë njerëzit në Xhenet ose Xhehenem, kjo nuk është në dorën e askujt; kjo i takon vetëm Allahut të Gjithë-informuar. Është Allahu i Madhëruar Ai që gjykon midis robërve të Vet se ku do të jenë dhe për çfarë nuk u pajtuan. Është detyrë e jona që në botën e punës ku jemi të jemi të bashkuar dhe të kapur fort për litarin e Allahut dhe të jemi me zemra të bashkuara për Allahun, të bashkohemi rreth Tij, të njihemi mes vete dhe të solidarizohemi, kështu do t'i realizojmë objektivat e Allahut të Madhëruar të caktuara për njerëzit. S'ka dyshim se kështu do të përparojmë si Umet dhe do të bartim me sukses rolin e amanetit në Tokë. Ne nuk duhet të përleshemi për njerëzit

se ku do të jenë, në Xhenet ose në Xhehenem dhe çfarë grade do të kenë. Ne doemos të punojmë për studimin dhe nxjerrjen në dritë të bazave të bashkëjetesës dhe bashkëpunimit midis mospajtuesve, duke qenë nën ombrellën e një Umeti.

### E dyta: Elementet e unitetit dhe pajtimit ndërmjet muslimanëve

Rimëkëmbja dhe përparimi i Umetit si dhe realizimi i detyrës së hilafetit dhe kryerja e amanetit hyjnor në Tokë, do të jetë e mundur vetëm atëherë kur besimtarët të hyjnë plotësisht në paqe (Islam), Allahu i Madhëruar thotë: *“O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij...”* (El-Bekare, 209) – përndryshe (nëse nuk e bëjnë këtë) ata do të ndjekin hapat e djallit që do t’i çojnë drejt përplasjes, mospajtimit dhe luftës, drejt humbjes së paqes dhe qetësisë e sigurisë, ndërsa kjo bën që të mos realizohen objektivat e Kur’anit dhe do të jenë të pamundura, ato janë: tevhidi, edukimi i lartë, jeta e bukur (zhvillimi), Umeti dhe thirrja (da’veja). Rrethanat dhe faktorët që kontribuuan të lind shteti i hilafetit të drejtë nuk mund të përsëriten, sepse Umeti në atë kohë ende nuk dinte për ndarjet dhe mospajtimet e ashpra, ai ishte Umet që çdo gjë të re e trajtonte me referencë të Kur’anit: *“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit.”* (El-Maide, 92)

Pyetjet dhe çështjet që nuk ishin më parë filluan të shtrohen në kohën kur çrregullimet filluan të ndodhin njëra pas tjetrës, ndër to: gjykimi për atë që bën gjynahe të mëdha, për atë që del nga bashkësia muslimane, kush do të duhej ta përfaqësonte Umetin kur midis tyre ndodhin mospajtime ose luftë, si fjalët te Allahut të Madhëruar: *“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit..”* (El-Hu-

xhurat, 9); vendimi për ata që flasin për kadanë dhe kade-rin, xheberitë, murxhitë etj. Ishin këto pyetje për të cilat kër-kohej përgjigje dhe që këtej përgjigjet në fjalë do të krijonin ndarje dhe fraksione. Çështja e Imametit mbeti të debatohet në rrafshin e shumë gjërave, a do të jetë Imameti me tekst i rregulluar apo me zgjedhje të popullit (referendum), kështu kjo çështje mori rrugën për t'u futur në ilm 'ul-kelam. Më vonë filloi procesi i akuzimit me fisk, bid'at dhe shenjtërim të fraksionit. Shumë herë kishte ndodhur që fraksionet të përvetësonin arsyetime (karakteristika) sikur të ishin bazë e tyre. Njerëzit u ndanë në grupe, secili prej tyre i kënaqur me atë që e mbështeste dhe e kishte me vete.

Është me rëndësi të konfirmohet ajo se uniteti (bashkimi) është domosdoshmëri e paraqitjes së Umetit në cilësinë e bashkimit të të gjithëve, kjo arrihet vetëm me realizimin e pajtimit dhe paqes midis të gjithëve. Paqja dhe pajtimi në fjalë realizohen vetëm me bashkëjetesë dhe pranim të mospajtuesve apo kundërshtarëve. Ne duhet të mësojmë se mospajtimi është ligj i shoqërisë njerëzore, nuk është diçka e ardhur, ndërkaq që paqja, pajtimi dhe bashkëjetesa midis muslimanëve është e domosdoshme dhe ka karakteristikat e saj: gjaku i muslimanit për vëllain e tij musliman është i shenjtë, gjaku, nderi dhe pasuria gjithashtu janë të shenjta, drejtësia dhe korrektësia midis tyre, barazia midis tyre në të drejta dhe detyra etj. Vendimi (gjkimi) për besim ose mosbesim (iman dhe kufër), se kush do të përfundojë ne Xhenet e kush në Xhehenem, janë çështje që nuk konsiderohen e as llogariten. Imam Shafiu thotë: “Nuk është e lejuar t'i luftojmë disa që shfaqin mendimin e havarixhëve dhe largohen nga bashkësia e njerëzve dhe i konsiderojnë për jobesimtarë (kafira), kjo sepse janë në nën hijen e Imanit, ata nuk kanë

arritur në gjendjen që Allahu i Madhëruar ka urdhëruar të luftohen për atë.”

Tek ibaditët vërejmë Salim ibn Dheqvan Hilalin, që llogaritet model (shembull) i hershëm i rihapjes (zemërgjerësisë) dhe mirëkuptimit ndaj kundërshtarëve medhbebor, ky ishte një ndër ata që ishin delegacion e që shkuan për ta takuar halifin Omer ibn Abdu-l-Aziz, e që thotë: “Ne mendojmë se është e lejuar që me ata (kundërshtarët tanë në medhheb) të martohemi dhe të trashëgohe mi, nuk mendoj se është e ndaluar për ne, përderisa ata orientohen kah kibra jonë.”

Verxhelani thotë: “Udhëheqësi i muslimanëve duhet t’i thërrasë mospajtuesit që t’i lënë anash gjërat që i çuan në lajthitje (devijim), nëse ata i përgjigjen, atëherë gjejnë udhën e drejtë dhe bëhen vëllezër tanë, për ta vlen ajo që vlen për ne, dhe ajo që është e dëmshme për ne, është edhe për ata.”

Imam Jahja ibn Hamza flet për çështjen e llogaritjes për jobesimtarë (kafir) të te’vilit (interpretimit), dhe thotë: “Jobesimtar të te’vilit janë: “xheberitët, mushebbehitët, rafiditët dhe havarixhët. Ehl ‘ul-kible (pra besimtarët, të kibles) ishin në mospajtim për llogaritjen e tyre jobesimtarë, disa i llogaritën për jobesimtarë, e disa të tjerë thanë se janë në Islam. Ata që xheberitët dhe mushebbehitët i llogaritën për jobesimtarë janë: imamët trashëgimtarë dhe një grup i madh i mu’tezilëve dhe zejdivë. “Me jobesimtarë të te’vilit” i nënkuptojmë ata që pohojnë Allahun e Madhëruar, atributet e Tij, urtësinë e Tij, pohojnë pejgamberllëkun dhe pranojnë sheriatin, që falen në drejtim të kibles dhe martohen sipas Sunetit.”

### E treta: Namazi thërret në bashkim

Urtësia kryesore e faljes së namazit me xhemat (në bashkësi) është realizimi i domethënies “ndërtesë solide dhe e

fortë". Adhurimi në këtë kontekst nuk nënkupton aspektin gjeografik, por bashkimin me të gjitha domethëniet e tij, unitetin dhe solidaritetin. Namazi bashkon. Po, është e vërtetë kjo. Por, namazi na bashkon apo falja e namazit në xhemat duhet të na mësojë që ka namaz, që shuan zjarrin e përçarjes dhe mospajtimit, është namaz që krijon ngrohtësi dhe dëlirësi, është namaz që inspiron për të gjitha kuptimet e mëshirës dhe mirëkuptimit dhe bashkimit të plotë. Ky nuk është namaz për koncepte politike që rezultojnë me nënshtrim ndaj udhëheqësit të padrejtë, namaz që bënë ndarje në grupe ku disa janë kundër disave. Jo! Ky lloj i namazit nuk mund ta ngërthejë kuptimin e bashkimit dhe xhematit. Namazi që ne e duam është ai që krijon ndjenjën e lartë të afërsisë dhe qëndrimit të lartë para Allahut të Madhëruar, Një e të Vetëm, i orientimit drejt një kibleje, i një leximi të Kur'anit, përndryshe çfarë kuptimi do të kishte mëshira reciproke! Namazi me xhemat bën që punët tona të marrin drejtimin e duhur dhe të saktë, na jep udhëzime të mirëfilltë, nëse ka namaz me xhemat nuk është rast për vetëkorrigjim dhe zbutje të zemrave, bile së paku të jetë përkujtim për çdo musliman se vëllai i tij që e ka afër ka të drejta të plota, së paku të qëndrojë larg përçarjes dhe ndarjes, se kështu i harrojnë kufijtë e Allahut.

Ky është kuptimi i namazit për të cilin duhet të kujdesemi, pra namazi me xhemat bashkon. Vetëm kur këtë do ta kemi para syve tanë, do të mund t'i shpëtojmë zërave dhe cytjeve që sot kanë kapluar ndjekësit e medhhebeve, se ndoshta ndihmojnë bid'atçiuin (risimtarin) në bid'atin e tij kur falen pas tij ose me të. Nuk duhet harruar se namazi me xhemat (xhemati) është caktuar të jetë brenda bërthamës së Umetit e jo të medhhebit apo sekti. Kujtoj se është e duhur që namazin ta përjashtojmë nga nënshtrimi ndaj pushtetmbajtësit apo partisë, ose grupit në kuptimin politik. Prani-



mi apo mospranimi i namazit është i lidhur me fshehtësitë e zemrave, secili rob i Allahut është peng i sinqeritetit të tij dhe përkushtimit të tij para Allahut të Madhëruar. Mbi këtë kuptim, Nisaburi thotë: “Dijetarët janë në mospajtim rreth faljes së namazit pas atij, gjendja e të cilit nuk e gëzon (kënaq) njeriun, pas atij që është ehl ‘ul-ehva’, dhe janë një grup i dijetarëve që e lejuan faljen e namazit pas këtij.” Hasen Basriu për bid’atçiuin thoshte: “Falu pas tij, se bid’ati vetëm atë e dëmton (e jo atë që falet pas tij).” Imam Shafiun thoshte: “Çdo musliman i rritur, që pas tij falen të tjerët, por që ky ndodh të jetë me gjendje të palakueshme në fenë e tij, namazin e ka të saktë (të plotë). Shokët e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. faleshin pas atij, gjendja e të cilit ishte e panjohur (fshehur), qoftë ai udhëheqës ose kushdo tjetër.”

Amili ishte i mendimit se falja e namazit me xhemat me njerëz që kanë mospajtime është i preferuar (mustehab), i konfirmuar, e jo vetëm i lejuar. Ai në veprën e tij, “El-Bej-san”, thotë: “Preferohet falja e namazit me xhemat të njerëzve që kanë mospajtim me njëri-tjetrin, është referim i konfirmuar (*muekked*). Sadiku r.a. thotë: “Kush falet në xhaminë e tij e pastaj vjen në xhaminë e tyre dhe falet me ata, le ta dijë se nga xhamia del me të mirat (sevapet) e tyre.”

Imam Jahja ibn Hamza thotë: “Ajo që e dëmton sinqeritetin e fesë janë gjynahet e mëdha të trupit (pra gjynahet e gjymtyrëve e jo gjynahu i te’vilit) dhe shfaqja e çrregullimeve dhe të metave në çiltërsinë dhe ndershmërinë e tij; ai që është kështu (pra me sinqeritet të fesë dhe i pastër nga gjynahet e gjymtyrëve), lejohet falja e namazit pas tij...”. Ky gjithashtu iu qas edhe çështjes së përngjasimit (ecjes pas) të atij me të cilin nuk pajtohet për çështje fikhore dhe të ixhtihadit lidhur me abdestin dhe namazin. Historikisht, mospajtimet fikhore ishin ato që i shkaktuan përçarjet midis namazfalësve (xhematit në xhami), vetëm për mospajtime

fikhore e asgjë më tepër. Imam Jahja ibn Hamza thotë: “Mendimi i fuqishëm juridik (shariatit) dhe sjellja elementare nënkuptojnë lejimin e faljes së namazit pas atij me të cilin ka mospajttime në medhheb, qoftë mospajtuesi të jetë imami ose falësi pas imamit, apo që nuk dihet se kush çfarë është.” Ai më tej sjell prova që mbështesin mendimin e tij.

### E katërta: Komunikimi shkencor midis dijetarëve të mëdhenj të medhhebeve të ndryshme

Sipas radhitjes kohore, personaliteti i Xhabir ibn Zejdit, tabi’in i respektuar, do të ishte ai për të cilin Ibn Abasi thotë: “Sikur të gjithë banorët e Basrës të përqaфонin mendimin dhe fjalën e Xhabir ibn Zejdit, kjo do t’ju mjaftonte atyre për dituri për atë që është në Librin e Allahut.” Ky arriti të jetë urë lidhëse midis përçarësve, ky ishte imam i të gjithë muslimanëve në fikh, e jo vetëm i ibadive. Ebu Ubejde Muslim ibn Kerime, imami i dytë i abdit pas Xhabirit, thoshte (për Xhabirin): “Çdo njeri që është i zoti i hadithit e që nuk ka imam në fikh, ai është i devijuar, sikur Allahu i Madhëruar të mos na e dhuronte neve Xhabir ibn Zejdin, ne do të devijonim.”

#### 1. Imam Ebu Hanife dhe Imam Maliku:

Samiri në librin “Ahbar Ebi Hanife ve as’habuhu” rrëfen: “Një njeri e kishte pyetur Imam Malikun për një çështje dhe ky ishte përgjigjur, por kur mësoi për mendimin e Ebu Hanifes, ai e tërhoqi fetvanë e tij, pra miratoi fetvanë e Ebu Hanifes.” Duraverdi thotë: “I kam parë Imam Malikun dhe Imam Ebu Hanifen në xhaminë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. pas namazit të jaciesë, duke mësuar dhe studiuar bashkë. I kam parë kur ndonjëri prej tyre përqendrohej të thënia ose mendimi i tjetrit, këtë e bënë pa përplasje (dhunë, sjellje të pahijshme ose fjalë të pamatura) dhe duke

mos e trajtuar njëri-tjetrin për gabim të bërë, kështu i shihnim deri në mëngjes duke bërë në ndjen e tyre.”

## 2. Imam Ebu Hanife dhe Imamët e Ehl'i Bejtit<sup>7</sup>:

Imam Ebu Hanifen dhe dijetarët e Ehi Bejtit i bashkonte një relacion shumë i ngrohtë dhe përzemërt. Ai, për Imam Zejd ibn Aliun thoshte: “Nuk kam parë dikë që përgjigjet më shpejtë se Zejd ibn Aliu...”. Relacionet në fjalë midis tyre nuk përkufizoheshin vetëm në aspektin shkencor, por ato do të shfaqen edhe në mbështetjen e Imam Ebu Hanifes të kryengritjes të Imam Zejdit kundër Hisham ibn Abdul-Melikut me fetva dhe pasuri. Ndërkaq, relacionet e Imam Ebu Hanifes me dy imamët, Bakir Muhamed Aliun dhe djalin e tij Xha'fer Sadikun, flet fakti se Ebu Hanife kishte transmetuar nga Imam Xha'fer Sadiku, kurse dy nxënësit e Ebu Hanifes, Muhamed ibn Haseni dhe Ebu Jusufi, i kishin shënuar transmetimet në fjalë në librat e tyre, edhe përkundër mospajtimeve të tyre lidhur me kijasin (analogjinë) me të cilin ishte i njohur Ebu Hanife.

## 3. Midis shkollës racionaliste dhe tradicionaliste<sup>8</sup>

Edhe përkundër zvarritjeve të ashpra midis shkollës racionaliste dhe të asaj tradicionaliste (e hadithit), prapëseprapë në grumbullin e transmetimeve gjejmë gjëra që zëshëm dëshmojnë vlerësimin e mospajtuesve të tyre. Kështu, Abdullah ibn Ahmed në librin e tij “Es-Sunne” thotë: “E kam dëgjuar babin tim – Ahmed ibn Hanbelin – që Abdurrahman ibn Mehdi e përcjell të thotë: “Njeriu do të jetë me dije të mirëfilltë atëherë kur do t'i shikon mendimet e Ebu Hanifes (do t'i mësojë e studiojë).” Imam Ahmedi konsideronte se Imam Shafiu ishte ai që shembi hendekun midis

<sup>7</sup> Familja më e afërt e Muhamedit s.a.v.s.

<sup>8</sup> Ehl'ur-re'j dhe ehl'ur-rivajeh.

shkollës racionaliste dhe asaj tradicionaliste (të hadithit). Imam Shafiu – që ishte fakih – i referohej Ahmed ibn Hanbelit në hadith, që nga ky ta merrte hadithin dhe atë e pyeste për gjendjen e haditheve, se është i fuqishëm apo i dobët, që ta merrte ose të mos e merrte.

#### 4. Zejditët dhe hanefitët

Këtë e vërejmë në relacionet e krijuara midis Imam Muhamed ibn Husejn ibn Kasim, njëri nga imamët zejditë (vdiq më 360 hixhri) dhe dijetarit Ebu Hasen Kerhi Hanefi. Imam Ibn Dai' kishte lexuar (studiuar) fikhun hanefi të mësuesi Ebu Hasen në Bagdad, derisa ai - Ibn Dai' – kërkonte nga ndjekësit e tij që e dëgjonin te jepte mësimë që ta provonin mbamendjen e tij në fikhun e Ebu Hanifes, e ata i zgjidhnin çështje të paqarta (të ndërlikuara) nga librat e fikhut hanefi, kurse ky i shikonte dhe i shkruante përgjigjet dhe fare nuk gabonte në medhheb. Respekti dhe vlerësimi i lartë midis tyre kishte arritur nivelin shumë të lartë. Kadi ibn Ekfani do të rrëfente: “Një ditë ishim në ndejën (mexhlin) e Ebu Hasen Kerhiut, kurse Ebu Abdullah ibn Dai' si zakonisht ishte aty, e kur Ebu Haseni mbaroi me mësimin dhe u ngrit dhe doli nga xhamia, atë e ndoqi Ibn Dai', por në dalje të xhamisë e pa dhe i tha: “O i nderuar, sikur dalja nga xhamia të mos kishte vlerë, do të jepja përparësi në dalje.” Damiri në veprën e tij “Ahbar Ebu Hanife ve as'habuhu” sjell kujdesin e Ibn Dai' për praninë e tij në xhenazen e Ebu Hasenit dhe faljen e namazit të xhenazes së tij.

Ibn Asakir (vdiq më 571 hixhri) sjell një skenë të shoqërimit të të gjithë dijetarëve të medhhebeve në shekullin e katër hixhri në Irak, dhe thotë që ata ishin: “Ebheri, mësuesi i malikive, Ebu Kasim Dariki, mësuesi i shafi'ive, Ebu Hasen Tahir ibn Hasen, mësuesi i muhadithëve, Ebu Hasen ibn Sem'un, mësuesi i këshilluesve dhe asketëve, Ebu Ab-

dullah ibn Muxhahid, mësuesi i mutekeliminëve (apologjeteve) dhe Ebu Hasen et-Temimi mësuesi i hanbelive. Ebu Ali thotë: “Sikur çatia të binte mbi kokat e tyre, në Irak nuk do të mbetej kush të jepte fetva për ndonjë ndodhi, se të tillë nuk do të kishte më.”

### 5. Imamitë dhe zejditë

Edhe përkundër mospajtimit për çështjen e imametit midis imamive dhe zejdivë, ne nuk vërejmë shpirtin e kulturës së mospajtimit midis tyre. Kur Bakir r.a. ishte pyetur: “Cilin e ke mik më të dashur dhe më të vlefshëm? Ai kishte thënë: “Zejdi është gjuha ime që flas me të.” Edhe në veprat e dy imamëve vërejmë shpirtin e mirëkuptimit dhe miqësisë midis tyre, njëri imamije e tjetri zejdiye... edhe pse midis tyre ka mospajtime të mëdha fikhere në nivel të medhhebit, e jo në nivel të imamive dhe zejdivë vetëm. Çështjet pajtuese me zejditët arrijnë në 81 çështje, ndërsa ato të mospajtimit në 98. Në çështjen e fundit, pra të 98-ën lexojmë: “Nuk lejohet imameti i fasikut (nuk lejohet që fasiku -gjynahqari - të bëhet imam). Kjo është e vërtetë, për këtë pajtohen të gjithë dijetarët e ehli bejtit – edhe përkundër mospajtimeve midis tyre.” Ai këtu konfirmon mospajtimet e dijetarëve të ehli bejtit mes vete, në aspektin gjithëpërfshirës dhe të veçantë, siç është çështja e imametit, por duke mos e parë këtë çështje si nënvlerësim të respektit dhe vlerësimit midis tyre. Mendoni pra se si ishte zemërgjerë (i butë, i qetë) në trajtimin e çështjeve mospajtuese dhe studimin e mirëfilltë në prezantimin të tyre me shumë seriozitet.

### 6. Ibn Tejmije dhe fakihu imamit

Edhe përkundër hendekut të madh të mospajtimit që kishte fakihu shi’it, Xhemaluddin ibn Husam, me një grup të dijetarëve, që e kundërshtonin në aspektin medhhebor,

në radhë të parë Ibn Tejmijen, duke marrë parasysh se Ibn Husam është nxënës i Ibn Mutahir Hulji, autor i librit “Minhaxh ‘ul-Kerameh”, të cilën libër Ibn Tejmij e kishte kundërshtuar me librin e tij “Minhaxh ‘us-Sunneh”, prapëseprapë midis tyre vërejmë shpirtin dhe kulturën e mospajtimit. Midis tyre ishte zhvilluar studim për çështje të ndryshme dhe njerëzit kishin vërejtur debate të gjata, si të aspektit të përplasjes së provave, por edhe të përafrimit të tyre. Safediu përmend disa vargje të shkruara nga Kadi Shihabuddin dërguar Ibn Husamit dhe vargjet me të cilat Ibn Husami iu ishte përgjigjur atij, e që dëshmojnë për kulturën dhe mirëkuptimin e asaj që e shpjegoam më lartë. Kjo na mëson se dialogu i bazuar mbi provën dhe korrektesinë që shërben për largimin e mospajtimit, është rruga e vetme për ta ndërprerë rrugën e ekstremizmit dhe tejkalimit. Vetëmbyllja llogaritet kotec për çdo ekstremizëm dhe fanatizëm. Këtë pjesë do ta përfundojmë me fjalët e Dhehebiut, i cili fton për pranim të mospajtuesve dhe korrektesisë të vlerësimit dhe respektit të tyre, duke thënë: “Gulatët (fanatikët) mu’tezilitë, gulatët shi’itë, gulatët hanbelitë, gulatët esh’aritë, gulatët murxhitë, gulatët xhehmitë, gulatët keramitë, bota është përplot e mbushur me këta dhe janë shumë, mes tyre ka të mençur, adhures dhe dijetarë, e lusim Allahun për falje dhe mëshirë për ata që dëshmojnë se Ai është Një, jemi të pastër para Allahut nga epshi dhe bid’ati, e duam Sunetin dhe ata që e ndjekin atë, e duam dijetarin, atë që ai e ndjek dhe veçoritë e lavdëruara, nuk e duam atë që shpik dhe sajon te’vil të përshtatshëm; dijeni se mësimi i mirë është kur të shohim shumë të mira.”

### Përse komunikim?

Doemos të triumfojë prova e jo imitimi (taklidi), doemos të ekzistojë komunikimi (afërsia dhe lidhja) midis pasuseve

të medhhebeve, jo vetëm për hir të unitetit islam, por për hir të realizimit të së vërtetës që vetëm me studim dhe kërkim të provës së qartë arrihet e plotësohet. E vërteta është një, por rrugët që çojnë tek ajo janë të ndryshme, çdo rrugë ka pikat e afërsisë me rrugët e tjera, siç ka edhe pikat e largimit midis tyre. Nuk ka vetëm një rrugë që çon tek e vërteta, siç nuk ka që dikush i vetëm arrin tek ajo, por ne jemi ata që krijojmë afërsi dhe komunikim; askush nuk mund të pretendojë se vetëm ai e ka qëlluar (të saktë), gjykimi i ndonjërit se ai e ka qëlluar të vërtetën është gjykim që ndëshkon rëndë ixhtihadin për përaftrim dhe mirëkuptim. Vetëm Allahu është që do të gjykojë midis nesh në Ditën e Kiameetit për atë që nuk jemi pajtuar në këtë botë. Ky është rrëfimi për medhhebet; secili medhheb i ka të mirat e të mangësitë (lëvdatat dhe kritikata); imamët e medhhebeve treguan kujdes të madh për komunikim dhe afërsi me njëri-tjetrin; këtë e bënë për të treguar bindjen e tyre se asnjëri nuk mundet pa tjetrin, se doemos të krijojnë komunikim dhe afërsi të studimit dhe shqyrtimit të provave, se ndoshta prova e tjetrit është më e fuqishme dhe më e preferuar. Kërkimi i së vërtetës arrihet vetëm me provë të qartë, e jo me imitim.

Kjo njohje e të vërtetës së mospajtimit shihet qartë edhe në thënien e Ebu Hanifes: “Ne nuk detyrojmë askënd për atë ku ne jemi, ne nuk themi se doemos të na ndjekin dhe pranojnë, nëse dikush ka më të mirë se ajo që ne e kemi, le ta sjellë.” Është Ebu Hanife që bëri Imam Malikun të heq dorë nga fetvaja e tij për çështjen që kishte të bëjë me pastërtinë, e të jepte fetvanë e Ebu Hanifes, pasi njëri nga nxënësit e tij i kishte treguar për të.

Kujdesin në fjalë për provën dhe qartësinë e gjejmë edhe tek Ibn Abdul-Azizi, dijetarë ibadit, që ndiqte mendimin e Ibrahim ibn Nah’iut e hiqte dorë nga mendimet e fukahave të medhhebit të tij, siç ishte Xhabir ibn Zejd dhe Ebu Ubejde

Muslim ibn Kerime. E kur e pyetën për këtë, ai tha: “Pse të mos i marr thëniet e atij që mendoj se është korrekt, që ma heq dyshimin nga shpirti e më largon nga të gabuarit, marr nga i besueshmi Ibrahim, tek ai mbështetem.” Sherif Murteda në veprën e tij “Er-Resail” duket studiues i thënieve të mospajtuesve dhe i gatshëm t’i merr fjalët e tyre. Ai nuk ngushtohet fare të merr thëniet e Imam Shafiut për ndonjë nga çështjet dytësore të fikhut, nëse për ato nuk gjente thënie të miqve të tij, të qarta dhe të prera. Ai vërejtí autoritet dhe afërsi (qetësi) në mendimin e Imam Shafiut. Në veprën e tij në fjalë, ai thotë: “Nuk ka dallim midis asaj se a papastërtia rrjedh në ujë apo uji në papastërti. Për këtë çështje unë nuk di se ndonjëri nga miqtë e tanë ka ndonjë thënie të qartë apo tekst.”

Ngadhënjimi i provës ishte që e bëri Ibn Tejmijen të merrte mendimin që përputhej me thënien e imamive lidhur me çështjen e shkurorëzimit. Mbi shqyrtimin e çështjes së shkurorëzimit të gruas që është e pastër dhe kur ai ndodh me një fjalë (një të thënë ose më shumë të thëna), por që llogaritet të jetë e shkurorëzuar përgjithmonë (sikur të jetë e shkurorëzuar tre herë), dhe pasi shtroi thëniet e dijetarëve të mëhershëm dhe mëvonshëm, ai arriti në përfundim se: “shkurorëzimi (edhe nëse është me shumë të thëna, pra më shumë se njëherë), llogaritet një shkurorëzim.” Ibn Tejmije kundërshtoi qëndrimin e shumicës së atyre që ndiqnin Ahmed ibn Hanbelin se shkurorëzimi ndodh tri herë (qoftë me një fjalë, të thënë). Ai në këtë pikë u pajtua me shí’itët dhe grupin imamit, për asgjë tjetër, vetëm për provën e qartë.”

Nuk duhet harruar se Ibn Tejmije u vu në sprovë për çështjen e shkurorëzimit në fjalë dhe u burgos për thënien e tij për të. Disa kundërshtarë të tij e qortuan për këtë qëndrim të tij, duke thënë se me këtë ai pajtohet me rafiditët.



Por, Ibn Tejmije iu përgjigj me një rregull të mirëfilltë dhe tejet të bukur: “Ka njerëz që thonë se shqiptimi i besmeles me zë është bid’at (risi), ka të tillë që thonë se mes’hi mbi meste nuk është i lejuar, qoftë kur është në shtëpi apo në udhëtim, ka të tillë që nuk pajtohen me lutjen e kunutit në namazin e sabahut, të tillë që nuk e shohin të arsyeshme haxhin mut’a, rrafshimin e varreve dhe lëshimin e duarve në namaz si dhe shumë çështje të tjera për të cilat ka një mospajtim midis dijetarëve të ehli-sunetit, por ndodh që të gjithë që flasin për këto çështje ta kenë qëlluar, pajtuesit dhe mospajtuesit, sepse janë çështje ixhtihadi; nuk duhet të mohohen, përveç nëse ato shndërrohen në rite për ndonjë çështje të paarsyeshme, atëherë duhet të ketë provë se doemos duhet mohuar, edhe pse vetvetiu lejohet ixhtihadi për ato, siç është çështja e vendosjes së gjetheve mbi varr, që është çështje e transmetuar nga disa sahabë dhe shumë çështje të tjera.” Në thënien e Ibn Tejmijes vërejmë një lloj përmbajtje që t’i përshkruan thëniet e tyre të sakta ose gabim, por nuk është i përmbajtur kur flet për thëniet e atyre me të cilët pajtohet, dhe kjo është provë e qartë për ata që njohin qëndrimin e Ibn Tejmijes për shi’itët imamitë. Ne sollëm këtë shembull duke dashur të tregojmë dhe provojmë se kur ne ndjekim rrugën e provës dhe argumentit, atëherë mirëkuptohemi dhe krijojmë pikëbashkim, mësojmë nga thënia e jo nga thëniesi, e vërteta nuk njihet me njerëz, por njerëzit njihen me të vërtetën.

Që këtej themi: “Shkaqet e komunikimit (mirëkuptimit, afërsisë) dhe bashkëveprimit – bile edhe faktorët e ndikimit dhe ndjekjes – midis grupeve ishte vetëm për hir të unifikimit të përbashkët rreth referencës që e kishte bërë punën e tij, përkundër faktorëve të mospajtit, përçarjes dhe përplasjes. Është e qartë se fryti i vërtetë i këtij mirëkuptimi dhe komunikimi është se i lejoj secili grup t’i korrigjojë

njohuritë dhe të dhënat që i kanë dhe kritikën e të njëjtave, veçmas studimin dhe shqyrtimin e njohurive që i kanë të tjerët, e saktë ose e vërtetë. Kjo solli që çdokush të mendonte se secili medhheb ka gjëra të vlefshme dhe të pavlefshme (që meritojnë lavdërim dhe kritikë), se asnjë medhheb nuk ka të drejtë të pretendojë monopolizimin e të vërtetës së fesë dhe përfshirjen e saj.

### E pesta: Unifikimi rreth referencës së përbashkët dhe ndikimi i tij në trashëgiminë shkencore të medhhebit

Unifikimi i referencës, edhe përkundër metodologjive të ndryshme për tek ai, pati ndikim të pamohueshëm në trashëgiminë tonë, mospajtimi ynë ishte në te'vil (interpretim) e jo në tenzil (për Kur'anin): *"Vërtet, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe Ne do ta ruajmë atë me siguri."* (El-Hixhr, 9)

Është njëlloj, e mohuam apo pohuam dhe pranuam unifikimin rreth referencës së përbashkët, ai pati ndikim të thellë në trashëgiminë e Umetit tonë, me vetëdije ose pavetëdije.

Mund të themi që zhvillimi i drejtimit racionalist, që u kristalizua në drejtimin usulist<sup>9</sup>, ishte i shoqëruar me tendencë rihapjeje brenda shi'itëve imamitë më shumë se që ishte në medhhebet tjera, varësisht nga niveli i dijetarëve midis tyre, nga brezi në brez etj. Dijetarë më të shquar të këtij drejtimi do të jenë mutekelimunët (apologjetët), ndërkaq është e ditur se ai që merret me ilm 'ul-kelamin doemos t'i studiojë provat e kundërshtarëve dhe t'i shqyrtojë arritjet e tyre. Një gjë e tillë kërkon tendencë racionaliste dhe kritike njëkohësisht. Të zotët e kësaj tendence, të cilit do medhheb të jenë, janë më të aftë për komunikim dhe afërsi me mospajtuesit. Këta janë më të aftë edhe për përtëritje të

<sup>9</sup> Usul nënkupton parimet e fesë, një nga emrat e shkencës së besimit, parimet themelore të së drejtës islame, formulimi i parimeve dhe metodologjia e rregullave juridike.

medhhebit të tyre në brendësi. Kujtoj se ky është aspekti pozitiv i ilm 'ul-kelamit. Këta u rihapën edhe ndaj mendimeve të mu'tezilëve dhe ideve të tyre. Në anën tjetër, shkolla tradicionale (e hadithit), siç janë në çdo medhheb, janë më shumë të prirë për vetmi dhe shkëputje (të qenët i ndarë dhe i vetëm) nga mospajtuesit, nga kujdesi ruajtjen e kompetencës (intimitetit).

“Ardhja e Ibn Xhunejd Eskafit dhe e Hasen ibn Ebi Ukajl Omanit në shekullin e katërt hixhri do të jetë si pikënisje e fikhut të bazuar më shumë në logjikë (mendje). Duket se këta dy njerëz ishin në lidhje dhe afërsi më të madhe me fraksionet e tjera islame. Që këtej te këta të dy do të shfaqen mendime (ide e opinione) dhe metodologji që dallonte nga ajo që ishin prezent dhe e njohur për mjedisin ideologjik shi'it, aq sa thuhej se metodologjia e punës së Ibn Xhunejdit me kijas (analogji) ishte me vend dhe për ndikimin e tij me metodat e të menduarit sunit.”

Tusi (vdiq më 460 hixhri) është ai që mund të llogaritet njëra nga urat e komunikimit midis këtyre medhhebeve. Ai kishte bërë punë të mëdha për këtë. Formimi i tij kulturor (arsimor) dhe i hapur në aspektin medhhebor, kishte kontribuar në themelimin e fikhut argumentues në medhhebin shi'it imamit. Subki në “Tabekat 'ush-Shafiije” për të thotë: “Është fakih shi'it dhe hartues i tyre, i përkiste medhhebit shafi'it, mësimet e fikhut i mori në meshhebin shafi'i, shkencat e usulit dhe ilm 'ul-kelamin e mori nga Ebu Abdullah Muhamed Nu'mani, i njohur si fakihu i imamive.”

Hajder Hibbullah thotë: “Me paraqitjen e librit “El-Mebsut ve 'l-Hilaf” të mësuesit Tusi filloi që gjendja të ndryshonte. Tusi në librin e tij të parë deshi të pohojë se shi'itët posedojnë një trashëgimi të veçantë të tyre të përfshirjes (studimit) të termeve të fikhut islam, të formave të tij, prezantimit të tij, të supozimeve dhe ndodhive të reja.

Ky dëshironte mohimin e akuzës drejtuar imamive se këta nuk kanë fikh, prandaj shkroi librin *El-Mebsut* mbi këtë bazë dhe trajtoi mënyrën e depërtimit të mendimeve, thëniet, supozimeve dhe mospajttimeve sunitë brenda shi'itëve. Tusi librin e tij *El-Hilaf* e shkroi mbi bazat e fikhut mukaren (krahasues), gjë që i mundësoi të prezantonte një punë për mrekulli, punën me të dhënat (njohuritë) sipas metodologjisë së mospajtuesve, sepse, sipas tij, shi'itët nuk kishin njohuri për këtë (thënie të tyre)."

Pas dijetarit Tusi do të vjen muhakkiku (verifikuesi) Huli Ebu Kasim (vdiq më 676 hixhri) dhe dijetari i mirënjohur Huli ibn Mutahhir (vdiq më 726 hixhri), të cilët do të përsosin përvojën e tij të rihapjes, mendimet e këtyre dy dijetarëve do të ringjallin mendimet e Ibn Xhunejdit, pasi ishin të larguara.

Libri "Mearixh 'ul-Usul" i verifikuesit Huli deri diku është libër i Usulit Mukaren (krahasues), ai aty përmend mendimet e fukahave pajtues dhe të atyre mospajtues, siç janë Ebu Hanife, Shafiu, Xhubaiu, Ebu Bekr Dekkaku, Ebu Hasen Basri dhe të njëjtat i diskutoi.

Bazuar në formimin e tij shkencor e të rihapur të dijetarit të mirënjohur Huli, ai do të jetë prezent një kohë të gjatë në rihapje ndaj mendimit suni, aq sa dijetarët e shkollës ihbarite (shkollë shi'ite xha'ferite) e kishin kritikuar për këtë. Dijetari në fjalë ka vepra të shkruara të tij mbi fikhun mukaren (krahasues), siç është libri "Tehdhib 'un-nefs fi ma'rifet 'il-medhahib 'il-hams", siç ka enciklopedi fikhore krahasuese ku përmbledh thëniet e fukahave sunitë dhe shi'itë, siç është libri "Tedhkiret 'ul-fukaha'" dhe "Munteha 'ut-taleb min esh'ar'il-areb".

Dijetari zulmëmadh Huli kontribuoi edhe në lëmin e Hadithit, duke marrë nga mendimi sunit. Ai ndau hadithin në katër grupe: hadith *sahih*, *hasen*, *muveethik* dhe *daif*. Këtë e

shtroi në librin e tij “Ed-Durer ve ‘l-merxhan fi ‘l-ehadith ‘is-Sahah ve ‘l-Husan” dhe gjithashtu në librin “En-Nehxh ‘ul-Vedah fi ‘l-Ehadith ‘is-Sahah”. Është e qartë se në këto vepra shihet korrektësia dhe maturia e dijetarit famëmadh Huli; ai vlerëson mendimin në fjalë dhe kur bindet ai punon sipas tij, edhe nëse mendimi i tillë është nga pasuesit e medhhebeve të tjera.

Përvoja e dijetarit në fjalë rezultoi me përvoja të ngjashme në rihapjen për sunetin, e përfaqësuar në shkollën Xhebel Amil (emër i rajonit), veçmas te përfaqësia në mendimin e dy shehidëve, të parit dhe të dytit. Shehidi i dytë (Zejnuddin ibn Ali ibn Ahmed Xheb’i Amili, vdiq më 966 hixhri) ishte që shkencën e hadithit e mori nga ehli-suneti, dhe nuk ishte i njohur për këtë gjendje të tij midis shi’itëve më herët. Siç thuhet gjithashtu: “Shehidi i parë ishte ai që për herë të parë në historinë e kulturës (arsimit) shi’it i themeloi rregullat fikhere, këtë e bëri nën ndikim të drejtimit sunit të themelimit të rregullave fikhere, që ndodhi në shekullin e shtatë dhe tetë hixhri. Kjo tregon zhvillimin dhe lulëzimin e bashkëveprimit pozitiv midis sunive dhe shi’ive në këtë periudhë.”

Shkolla e shehidit të dytë kishte vazhduar që përmes nxënësve të saj të rezultojë dobi të jashtëzakonshme të kësaj fushe, ndër nxënësit më të njohur të kësaj shkolle ishte biri i tij, Shejh Hasen, i cili shkroi librin “Munteka ‘ul-Xheman” ku dalloi hadithin sahih dhe hasen nga hadithet e tjera në katër librat e hadithit.

Edhe në fushën e tefsirit nuk mungoi hapësira e për-bashkët e dijetarëve eminentë. Tefsiri i Kur’anit do të ndjekë metodologjinë që mbështetet në dukshmërinë e kuptimit të ajeteve kur’anore, e kjo hapi derën e përfitimit nga çdo tefsir të cilin e favorizojnë dëshmitë shprehimore. Në këtë

bën pjesë tefsiri “Hakaik ‘ut-te’vil fi muteshabih ‘it-tenzil” i Sherif Ridait, “Et-Tibjan” i shejh Tusit dhe “Mexhma’ ‘ul-Bejan” i Tabrisit.

Në parathënien e tefsirit “Mexhma’ ‘ul-Bejan” Tabrisi thotë: “Dije që e dhëna (lajmi) vjen vetëm nga e thëna e saktë (autentike) e të Dërguarit s.a.v.s. dhe nga imamët që zënë vendin e tij, se tefsiri i Kur’anit lejohet vetëm me të dhënë (lajm) të saktë e të qartë. Janë shumë që kanë transmetuar se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: “Kush e komenton Kur’anin me mendimin e tij dhe e qëllon (e thotë të saktën), le ta dijë se ka gabuar...!”

Kjo nënkupton se: “Allahu i Madhëruar ka preferuar studimin dhe nxjerrjen e përfundimeve dhe e ka bërë të qartë rrugën se si duhet realizuar kjo. Ai bile lavdëron njerëzit që e bëjnë këtë dhe thotë: “...*hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre...*” (En-Nisa’, 83) Allahu i Madhëruar i qortoi ata që shpërfillën përsiatjen dhe kontemplimin e Kur’anit. Ai përmendi se Kur’ani është i shpallur në gjuhën arabe: “*Me të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur’anin në gjuhën arabe...*”. (Ez-Zuhuf, 3)

I Dërguari s.a.v.s. thotë: “Nëse ju vjen ndonjë hadith, atë përballeni me Librin e Allahut, ajo që është në pajtim me të pranojeni, e ajo që e kundërshton atë, hidhjeni poshtë.” Ai sqaroi se Kur’ani është argument dhe burim referues, e si mundet që diçka t’i paraqitet atij nëse është i pakuptimtë?! Kjo do të nënkuptonte atë se: “Nëse është e saktë se ai që e interpreton Kur’anin me logjikë, duke mos vepruar sipas dëshmive të shprehjeve, edhe nëse e qëllon të vërtetën, le ta dijë se ka gabuar provën.”

Unifikimi i referencës është ai që e bëri Xhabir ibn Zejd Ibadiun imam nga imamët tabi’inë në fikh tek ehli-suneti. Unifikimi i përbashkët rreth referencës bëri që medhhebi

Ibadij, qysh në zanafillë të tij të zhvillohet e bazuar në truall të përbashkët.

Unifikimi i përbashkët rreth referencës bëri që zejditët të mos ndiejnë përlulesi në pajtimin e ndërsjellë me shafi'itë dhe hanefitë, në marrjen e gjërave që trajtonin çështje të ndryshme. Disa transmetues të një grumbulli të madh të fikhut dhe haditheve të Imam Zejd ibn Ali ishin dijetarë hanefi, ndër ta Ebu Kasim Nah'iu, mësuesi hanefit (vdiq më 324 hixhri) dhe Ibn Hidha'i, autori i librit "Shevahid 'ut-tenzil". Shikuar më lart, dijetarët e mëvonshëm zejdit morën nga librat e hadithit të ehli-sunetit.

Në fund themi: "Në trashëgiminë tonë të fikhut, kelamit, usuli-fikhut dhe usuli-dinit ka shumë vrima, që vërehen te grupet e ndryshme të prezantuara më herët, por është e qartë gjithashtu se të gjithë pohojnë se hartimi i dispozitave dhe ekzaminimi i tyre është i kufizuar me Librin e Allahut të Madhëruar. Këta përmendin Sunetin duke e konsideruar sqarues i Kur'anit fisnik, por në praktikë bëjnë ndarje midis tyre, ndërkaq që me të dy bashkëveprojnë sikur çdonjëra është burim i pavarur i legjisllacionit.....".

# Pjesa e gjashtë

## Ide besëlidhës për lëvizjet islame

Rruga e ndryshimit:

Nëse ata që mendojnë se Islami shtron vizion gjithëpërfshirës për njeriun, gjithësinë dhe jetën mëtojnë ndryshimin e realitetit të metit të tyre, atëherë le të ngulmojnë t'i përvehtësojnë karakteristikat metodologjike të ndryshimit që burojnë nga Kur'ani e jo nga trashëgimia (*turath*) e as nga të ngjashmet që janë prezent në realitetin tonë bashkëkohor që njihen si kallëpe të importuara.

Ndër karakteristikat më të rëndësishme dhe shtyllat e ndryshimit numërohen:

E para: Sovrani (pushteti) nënkupton sovranin e Kur'anit  
sipas kuptimit njerëzor e jo sovranin hyjnor

“Sovrani hyjnor” është koncept që paraqet trungun (rrënjën) filozofik, ideologjik dhe kulturor, e ndarë në shumë degë dhe në tendenca të shumëllojshme. Degët e tij formojnë një sferë filozofike dhe kulturore që zgjerohet ose ngushtohet, e që lidhet ngushtë me simetrinë (vargëzimin) njohëse islame, së cilës i përket konceptit në fjalë. Është i domosdoshëm studimi i gjurmëve të këtij koncepti dhe rezultateve të tij, i burimeve të ndërtimit të tij dhe origjinave të tij që gjenden në aspektet e ndryshme të jetës.

Është e vështirë apo ndoshta edhe e pamundur që dikush të njoh konceptin e sovranit hyjnor pa mos e kuptuar rrjetin e koncepteve islame ku bëjnë pjesë: koncepti i fesë (*din*), i ibadetit (adhurimit), i gjykimit, që përmban kuptime



të ndryshme, qoftë atë ligjor, juridik ose njohës, koncepti i hyjnitetit, krijimit, robërimit, dynjasë dhe ahiretit, retorikës, hallallit dhe haramit, konceptin e gjithanshmërisë dhe relatives, të përgjithshmen dhe të veçantën, dispozitat, njëshmërinë e fesë, të tokës dhe shumë të tjera që është e pamundur zotërimi i tyre nga të gjitha aspektet e ndryshme nëse nuk i njohim plotësisht.

Shkollat e ndryshme ideologjike konceptin e sovranit (*hakimijah*) gjatë dekadave të kaluara e trajtuan në forma të ndryshme, disa prej tyre mjaftuan me zbërthimin e tij që pastaj të bëjnë mbërthimin e tij për ta shpalosur kuptimin e tij islam, ndërsa disa të tjerë e trajtuan si një ndër objektivat më të rëndësishme të shariatit. Nuk do mend se krahas kësaj vërejmë edhe trajtime të tjera të ndryshme të këtij koncepti, e që vetëm paqartësi sjellin e jo tjetër.

Ne mëtuam që këtë koncept ta nxjerrim nga sferat e tilla (paqartësi) dhe nga rrugët e ngushta duke shfaqur mendim të përshtatshëm për të dhe duke shtruar njohuri të rëndësishme për të, sepse ngatërrimet në trajtimin e këtij koncepti nga shkollat e ndryshme mbeti prezent një kohë të gjatë, sidomos pas depërtimit të fushës së përlëshjeve dhe fyerjeve midis grupeve të ndryshme të përplatura të Umetit.

Të mos mendojë dikush se ne e themi fjalën e fundit për këtë koncept të rëndësishëm, sepse ne vetëm theksojmë rëndësinë e njohjes dhe studimit të disa veçorive (të dhëna-ve) që llogariten të jenë të domosdoshme për kuptimin e tij, apo që ndihmojnë për arritjen e një lloji saktësie dhe përcaktimi të përafërt për të.

1- E vëmë në dije thirrjen e Ibrahimit alejhi selam, ku Zoti i Madhëruar iu drejtua me fjalët e Tij dhe i tha: *“Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!”* – *“Po pasardhësit e mi?”* – pyeti ai. Allahu tha: *“Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.”* (El-Bekare, 124)

Këtu pra vërejmë imametin (prijësin), që Allahu është Bërësi i tij dhe Premtimi Hyjnor (marrëveshjen), drejtësinë dhe padrejtësinë. Imameti në këtë ajet merr formën e Premtimit (marrëveshjes) midis Allahut dhe njeriut, Premtim që nuk i përfshin të padrejtët. Këtu shfaqet vlera e drejtësisë kundrejt padrejtësisë, duke pasur parasysh se drejtësia është qëllimi i parë i të dërguarve pas tevhidit, dhe për ata që do të vijjnë pas tyre dhe do të zbatojnë përmirësimin në jetë.

2- Procesi i imametit dhe lidhshmëria e tij me bërjen hyjnore shpalos idenë e zgjedhjes hyjnore (*istifa'*), që kujtoj se duhet të merret në konsideratë bashkë me procesin e bërjes, zgjedhjes dhe përzgjedhjes individuale: *"Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe njerëzit, me të vërtetë, Allahu dëgjon dhe sheh gjithçka."* (El-Haxh, 75)

Zgjedhja e tillë lë të kuptohet se në bazë të veçorive të caktuara Allahu i Madhëruar zgjedh popuj e fise, të cilët do të kryejnë detyra të caktuara mëkëmbësie.

3- Ekzistojnë sisteme që në forma të ndryshme janë ngritur dhe zhvilluar mbi bazën e "grykimit ose sovranit Hyjnor", siç janë sumeritët, akadiunët, babilonët dhe faronët gjithashtu. Por, ka edhe sisteme që gjykojnë në emër të popullit ose fisit, sisteme të lashta që i përkasin religjionit, disa sisteme që burojnë nga klerikë, disa që mbështeten në mbretër, ajo që buron nga kleriku llogaritet shpallje hyjnore, që jep pushtet hyjnor ose fuqi në këtë sferë. Ka edhe popuj të lashtë, veçmas popujt romak, që idenë e ligjeve juridike e konsideruan proces njerëzor, të vetë njeriut pra, e jo të zotave. Ishin këta popuj që dëshironin ndarjen e fesë nga ligji, që shumë njohës të ligjit e konsideruan karakteristike më të rëndësishme që dallon ligjin romak nga shumë sisteme tjera ligjore.

Qytetet sumeriane gjykonin me gjykim fetarë, krahas udhëheqësit civil i cili konsiderohej zëvendës i zotit në

Tokë. Kjo nënkuptonte ekzistimin e një unifikimi të ngjashëm midis dy pushteteve: kohore dhe fetare. Në këtë civilizim të lashtë, vendimet zbatoheshin në emër të zotit, zgjedhja e mbretit disi llogaritej se i përket zotit.

Periudha e akadiane do të shënojë paraqitjen e idesë së pushtetit të lartë dhe cilësimin e mbretit të madh se është mbret i të katër anëve të botës, ndërkaq që mbreti llogariste veten njëri nga zotat, përgjegjës për zbatimin e vullnetit të zotave në Tokë, se ai punonte vetëm me frymëzimin e tyre, ai për gabimet e popullit të tij përgjigjet para zotave, që popullit t'ia impononte respektin absolut të zotave në shumë raste.

Shteti i hititëve që gjendej midis dy lumenjve, pushteti i tij do të funksiononte mbi shtyllat e fuqisë vetëm, mbreti nuk konsiderohej zot e as që zë vendin e zotit, mirëpo përderisa ishte i aftë të triumfojë, ai konsiderohej i pajisur me mbështetje hyjnore. Mbreti do të konsiderohej ndërmjetësues midis zotit dhe njerëzve, siç vërejmë te babilonasët.

Hebraikët do të jenë popull që kaluan lumin Euftrat, duke u nisur drejt Palestinës, disa prej tyre do të ndalen në Palestinë dhe do të jetojnë bashkë me semitët dhe do t'i përqafojnë bindjet e tyre fetare, ndërkaq që disa të tjerë do të vendosen në Egjipt dhe prej tyre do të bëhen egjiptianë; semitët kishin ardhur nga Iraku, shumica e tyre kishte kohë të gjatë që kalonin nga vendi në vend për të kërkuar vendstrehim, i përngjanin gjendjes bedevie.

Urtësia e Allahut të Madhëruar ishte ajo që zgjodhi *Bijtë e Izraelit* dhe i nxori nga gjendja e shpërndarë dhe fisnore e hutese që të bëhen popull, të bartin Tevratin, për të dërguar të tyre zgjodhi Musain, ky do të jetë ai që do të merr përsipër rolin në fjalë, zbatimin e misionit, do t'i bashkojë fiset e Bijve të Izraelit, prej tyre do të bëj një popull, mes tyre do të dominojë lidhja e besimit dhe fesë. Ndër metodat më të

spikatura që sollën në bashkimin e këtyre fiseve dhe shndërrimin e tyre në popull ishte mbledhja e të gjithëve rreth Musait, të cilin e dinin për të Dërguar të Bijve të Izraelit, kjo bëri që të gjithë të jenë përreth tij. Këta do ta pranonin misionin e tij, sepse do të jetë pjesë e të qenit popull i Allahut, toka e shenjtë dhe e bekuar ku ata do të banonin do të jetë mbretëria e Allahut; ai që dëshiron të jetë nga populli i Allahut dhe t'i bashkëngjitet mbretërisë së Allahut, ai do të jetë nga bijtë e izraelit, ky doemos do të duhet ta pranojë drejtpërdrejt “sovrantin e Allahut”, të pranojë idenë e besimit në Musain dhe vëllain e tij Harunin, dy të dërguar, të pranojë nisjen drejt tokës së shenjtë dhe qëndrimin në të, lidhshmërisë me të, të pranojë mësimet e tevratit dhe pllakave që i solli Musai nga Zoti i tij.

Kjo kishte të bëjë me faktin se Allahu i Madhëruar iu përgjigj të gjitha gjërave që ata i kërkonin nga të mirat e Tij: “Kur Musai kërkoi ujë për popullin e tij, Ne i thamë: *“Bjeri gurit me shkopin tënd!”* Atëherë, nga ai shpërthyen dymbëdhjetë burime.” (El-Bekare, 60) – Allahu ua tregoi mrekullitë e shenjave të Tij, e kjo bëri që para tyre të mos mbetej gjë tjetër, pos nënshtrimit dhe bindjes. Megjithatë, shumë prej tyre u treguan të padëgjueshëm, shumë prej tyre drejtpërdrejt dolën nga sovranin hyjnor, prandaj edhe u ballafaquan me një numër ndodhish të njëpasnjëshme, sidomos pas vdekjes së Musait dhe vëllait të tij, Harunit. Pas kësaj fjala e tyre u përçua sërish, elementet e solidaritetit dhe bashkëpunimit midis tyre u humbën, disa prej tyre iu bashkuan popujve që jetonin afër tyre (krijuan lidhje familjare), aq sa disa filluan t'i adhurojnë idhujt, çrregullime të mëdha do të përhapen midis tyre, sa herë që ndonjë i Dërguar do t'i thërret për bashkim, atë do ta gjente fatkeqësia, shumë të dërguar gjetën vdekjen nga duart e tyre, shumë prej tyre u rebeluan dhe u bënë të padëgjueshëm ndaj udhëheqësit, ishin të kënaqur

me gjendjen e keqe nga e cila gjendje Allahu i shpëtoi më parë. Këta do t'i përjetojnë edhe disa besëlidhje, ndër to besëlidhjen e njohur me gjykim të gjykatësve e pastaj me besëlidhjen e mbretërve.

Allahu i Madhëruar në disa periudha kohore do t'ju dërgojë Davudin dhe Sulejmanin, në cilësi të mëkëmbësit, e kjo do të bëjë që çështja e sovranit hyjnor të kalojë drejtpërdrejt në sovranin e mëkëmbësisë së të dërguarve dhe pejgambereve. Çështja e tyre do të merr udhën e drejtë për pak kohë kur do të jenë nën udhëheqje të Davudit dhe të Sulejmanit më vonë. Me vdekjen e Sulejmanit mbi kokën e tyre ranë të këqijat për të cilat Allahu i Madhëruar ua kishte tërhequr vërejtjen se do të jenë shkatërrimi i tyre. Asirianët do ta pushtojnë kryeqytetin Izrael në vitin 721 para lindjes së Isait. Nebuhadh Nasr do të pushtojë mbretërinë Jehova dhe do ta shkatërrojë tempullin (në vitin 587 para lindjes së Isait), popullin e tij do ta robërojë dhe do ta çojë në Babiloni, për të filluar periudhë e re që do t'ia kujtojë Bijve të Izraelit shtrirjen e tyre në të gjitha fiset e botës dhe hyrjen e tyre në të gjitha fetë politeiste dhe monoteiste, për qafimin e feve të ndryshme, që sot të kthehen e të flasin për tokën e premtuar, për themelimin e mbretërisë izraelite, për tempullin, për kthim në atë që ishin të parët e tyre, e gjithë kjo duke pretenduar se është premtim hyjnor, që këta ta trashëgojnë këtë tokë të shenjtë.

E dyta: Sovrani hyjnor në botëkuptimin hebre (izraelit) dhe të krishterë

### 1. Sovrani hyjnor në botëkuptimin hebre (izraelit)

Parimet kryesore të sovranit hyjnor në botëkuptimin izraelit:

*Parimi i parë:* Allahu e zgjodhi popullin e Tij nga mesi i tyre, Ai zgjodhi që Vetë të jetë Sovran i drejtpërdrejtë i këtij

populli, që nga bijtë e këtij populli të jenë të dërguarit e Tij, që do të kenë lidhje me Të, që do t'i marrin mësimet dhe porositë që do t'ia kumtojnë popullit të tyre, janë mësimet dhe porositë që i ngërthejnë librat e parë të ungjillit të vjetër, veçmas librin “Eksodi dhe Ligji i përtërirë”, si fjalë e Allahut e drejtpërdrejtë për popullin, se asnjë njeri nuk mundet, qoftë edhe i dërguar ose peygamber të ndërhyjë në ndryshimin e fjalës së Allahut, të shtojë, të pakësojë ose të interpretojë, të abrogojë diçka nga fjala e Tevratit, ta ndryshojë atë apo të shtojë diçka.

*Parimi i dytë:* Sovraniteti ose përzgjedhja i bënë të jenë popull më të afërt me Allahun, bile i bënë të jenë bijtë dhe të dashurit e Tij, se askush në botë nuk e gëzon pozitën që ata e gëzojnë, toka e tyre ka pozitën e shenjtë për shkak të vendimit të Allahut për shenjtërim të tyre. Sovrani në këtë kuptim ishte i qartë për ata para se të kalonin në periudhën e gjykatësve dhe mbretërve, prandaj mund të themi që koncepti i sovranitetit hyjnor në rregulloren fetare hebraike është i ndërtuar mbi bazën e bashkëveprimit hyjnor me një popull të veçantë, e ata janë Bijtë e Izraelit, këtyre do t'u jepet gjithçka që e dëshirojnë, por njëkohësisht këtë dhënie mrekullie e pason edhe një dënim mrekullie, nëse ata devijojnë. Raporti mes Allahut dhe popullit të Tij të zgjedhur është raport i besëlidhjes (marrëveshjes) së drejtpërdrejtë, prandaj Tevratit quhet “Dhiatë” e vjetër apo e re qoftë.

Bijtë e Izraelit do të lakmojnë që Allahu t'ua lehtësojë dispozitat juridike, sikur këta, pas përshkallëzimit nga “sovraniteti i drejtpërdrejtë hyjnor” te “sovraniteti peygamberik” e pastaj “sovraniteti i peygamberëve mbretër” te “sovraniteti i mbretërve të rëndomtë”, do të fillojnë ta shijojnë këtë lehtësim, pasi panë se devijimet e shumta të tyre kanë të bëjnë me vështirësinë që Allahu ua solli në dispozitat juridike të ngërthyera në Tevrat, prandaj kërkuan që

Allahu t'ua lehtësonte obligimet dhe t'ua hiqte dënimet (masat ndëshkuese). Mirëpo, urtësia e Allahut deshi që lehtësimi të mbetet veçori e shpalljes së fundit dhe shariatit të fundit, e jo veçori e popullit që vazhdimisht devijonte dhe ishte i padëgjueshëm, që mohonte përkushtimin e ligjit të shpallur për ata, e që ishte shkak i unitetit të tij dhe shpëtimit nga nënçmimi i robërisë.

## 2. Sovrani hyjnor në krishterizëm

Ishte nevojë e jashtëzakonshme dhe e pashmangshme për shpallje tjetër, që do të merrte përsipër përmirësimin dhe drejtimin e gjurmëve që dolën nga ndikimi i logjikës hebrije, e cila bëri që i gjithë ai varg i koncepteve të përjetojë gjendje çrregullimi të raporteve: me Allahun, me gjithësinë dhe me peygamberët. Allahu i Madhëruar do ta dërgojë Isain a.s. për t'i udhëzuar, siç thuhet: “Delen e humbur nga bijtë e Izraelit”, të vërtetojë shpalljen që e kanë para duarve. Isai a.s. do të merr përsipër procesin e ripërpunimit të shpalljes në fjalë, dëlirjes dhe kritikës si dhe dallimit të të saktës nga e pasakta, që në vend të kësaj të vendosen disa gjëra që për ata ishin të ndaluara (haram), por edhe t'i përgëzonte të gjithë njerëzit me ardhjen e të Dërguarit të fundit (Muhamedit s.a.v.s.).

I Dërguari Isa a.s. do të vjen që përsëri të unifikojë fjalën për Tevratin, t'i mësojë se si ta praktikojnë atë me sinqeritet dhe besnikëri, ta rivendos autoritetin e Tevratit, thirrjen, t'i përmbahen atij dhe porosive të tij, duke pohuar se njerëzit kishin nxitur keqkuptim të teksteve të tij, ishin përmbajtur kuptimit ekzakt të tij dhe kishin shpërfillur shpirtin e tij. Isai a.s. do të përpiqet të rikthejë mendjen dhe zemrën e tyre drejt kuptimit shpirtëror dhe tekstual të Tevratit.

Së këtejmi vërejmë që zotëri Isai a.s. do të konfirmojë autoritetin e Tevratit dhe moslejimin e abrogimit në të, ai

nuk do të lejojë të ndodhë asfarë ndryshimi ose korrigjimi në mësimet e tij. Isai a.s. do të përpiqet të prezantojë një botëkuptim (vizion) të ri në procesin e praktikumit të tij në mënyrë të shëndoshë e të saktë, do t'i mbyllë dyert për murgët dhe priftërinjtë hebrenj që mbështesnin udhëheqësin romak dhe që pranonin autoritetin e tij. Këta njëherit edhe mëtonin ta nënshtronin ligjin duke shtrembëruar tekstet e Tevratit dhe duke i interpretuar ato sipas dëshirës së udhëheqësit në fjalë. Isai a.s. do të punojë për hapjen e derës së të kuptuarit të vërtetë të teksteve të Tevratit, ndërkaq që hebrenjtë do të shkojnë tek udhëheqësi romak dhe do ta akuzojnë me akuza, ndër to: se ai mëton t'i nxisë njerëzit për padëgjueshmëri, i ndalon njerëzit të paguajnë haraç mbretit dhe se për vete thotë se është “Mesihu mbret”. Pontius Pilate – që nuk ishte i kënaqur dhe i bindur me akuzimin e Isait – gjeti një rrugëdalje për të duke bërë që gjykimin e tij ta merrte përsipër një gjykatës i respektuar, në vend se ky vetë ta gjykonte atë. Gjykatësi romak në një dialog që do ta zhvillojë me Isain, që nuk tregon për sferën e “sovrانيتit”, do t'i thotë: “A mendon se unë kam në dorë pushtetin dhe autoritetin për lirim tënd ose kryqëzimin tënd? Isai i përgjigjet: “Ti nuk ke asnjë pushtet kundrejt meje, nëse nuk të është dhënë prej lart.” Kjo shprehje e Isait llogaritet si konfirmim i parimit të Tevratit ose Dhiatës së vjetër, se sovrani i takon vetëm Allahut, se Ai ia jep kujt të dojë apo e vendos për mëkëmbës në të kë të dojë.

Që këtej themi se Isai a.s. erdhi vetëm për të vërtetuar Tevratin dhe mësimet e tij, duke mëtuar të përforcojë autoritetin e Tevratit dhe ligjin hyjnor kundrejt pushtetit romak dhe ligjeve që ata vetë i kishin vendosur dhe që nuk lejonin ligje të tjera të shfaqeshin. Isai a.s. do të mëtojë rikthimin e vlerësimit të bazave të ligjit hyjnor, parimeve dhe objektive të tij.



### 3. Sovrani hyjnor dhe shpallja e fundit:

Njeriu, të parën që e vëren te Shpallja e fundit është këndvështrimi i saj pozitiv për njeriun dhe vërtetimi i saj se ky njeri është bërë i aftë për ta bartur amanetin, përgjegjësinë dhe plotësimin e besëlidhjes mes Allahut të Madhëruar dhe Ademit, se njeriu do të jetë i aftë për ta rregulluar jetën dhe për ta realizuar hilafetin në Tokë. Allahu i Madhëruar thotë: *“O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë e t’i pastrojë! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”* (El-Bekare, 129)

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. mori mbi vete detyra të cilat nuk ishin më parë të përmendura, por që në asnjërën prej tyre nuk përmendet qartë sovraniteti ose gjykimi në kuptim të njohur më vonë. Në Kur’an vërejmë ajete të cilat nënkuptojnë konceptet që më vonë u përhapën për sovranin (hakimjah). Studiuesi i jetëshkrimit të Dërguarit s.a.v.s. vëren se ai ushtroi udhëheqësin, gjykimin, dhënien e fetvasë dhe mësimin, por që pikënisje e gjithë kësaj të ishte peygamberia, e jo autoriteti dhe pushteti.

Është e udhës të mendohet për një gjë që kishte ndodhur në kohën kur Dërguari s.a.v.s. çliroi Mekën. Ebu Sufjani, në mbrëmjen e para çlirimit të Mekës, i shoqëruar nga Ibn Abasi shkoi për ta takuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe ta deklaronte Islamin. Ai rrugës i kishte thënë Ibn Abasit: *“Mbretëria e djalit të vëllait tënd u shtri.”* Ibn Abasi ia kishte kthyer duke i thënë: *“Është peygamberi, o Ebu Sufjan (jo mbretëri).”* Ky dialog nënkupton atë se Ebu Sufjani sikur kishte ngatërruar çështje midis peygamberisë dhe mbretërisë, ndërkaq që Ibn Abasi e kishte të qartë këtë për vete, se është peygamberi, se peygamberia është ndryshe nga mbretëria dhe dallon nga pushteti.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e pohon këtë në të gjitha hadithet e tij, siç është thënia e tij: *“O Allah, më bën të jetoj*

meskin dhe të vdes meskin.” E gjithë kjo bën pjesë në sferën e përpjekjes së tij s.a.v.s. për ta mohuar pushtetin dhe autoritetin pushtetmbajtës. Ai s.a.v.s. pohonte konceptin e pejgamberisë në gjykim (vendosje), se është pejgamberia e ndërtuar dhe që funksionon mbi leximin e Kur’anit, që leximi i Kur’anit është rregullimi dhe edukimi i njerëzve dhe i sjelljeve të tyre. Ky është dallimi midis gjykimit pejgamberik dhe të tjerave. Ai s.a.v.s. në një hadith të tij thotë: *“Pejgamberia do të jetë në gjirin tuaj aq sa Allahu të dëshirojë të jetë, e pastaj Allahu i Lartmadhëruar do ta largojë kur të dëshirojë; pastaj do të jetë hilafeti (që do të funksionon) në udhën e profesisë, e do të jetë aq sa Allahu të dëshirojë të jetë, e pastaj do ta largojë kur të dëshirojë ta largojë; pastaj do të jetë mbretëri e katandisur, e do të jetë aq sa Allahu të dëshirojë të jetë, e pastaj do ta largojë kur të dëshirojë ta largojë mbretërinë fatkeqe (mizore); e pastaj do të jetë hilafeti mbi bazën e profesisë, e pastaj heshti.”*

Hadithi në fjalë na dhuron lexim ardhmërie dhe këndvështrim vëzhgues për gjërat që do të ndodhin dhe si u kuptua kjo çështje. I Dërguari s.a.v.s. bënte dallim midis hilafetit që funksionon mbi parimet e pejgamberisë dhe sovranitetit sundues (plotfuqishëm) mbizotërues të çfarëdo emri ose slogani.

Kur’ani do të jetë Libri i Allahut, i përshkruar me veti që nuk ishin te librat e mëhershëm, ai do të jetë i mbrojtur me garanci hyjnore që do të bëjnë të ngel i mbrojtur nëpër breza dhe, për të realizuar këtë qëllim, Kur’ani fisnik do të jetë Vërtetues i shpalljeve të mëhershme dhe Mbikëqyrës, kurse sheriatit i tij do të jetë sheriat i lehtësimit dhe mëshirës dhe i heqjes së barrëve të rënda dhe vështirësive si dhe shumë veçorive tjera që atë e bëjnë Gjykatës (hakim), mirëpo me lexim njerëzor (njerëzishëm); njeriu do të jetë ai lexues i përhershëm dhe kjo pa dyshim tregon rëndësinë e çështjes së leximit (studimit) dhe metodologjinë e unifikimit

të dy leximeve dhe lidhjes së tyre me këtë çështje. Sovraniteti hyjnor përfundoi te Bijtë e Izraelit, ndërsa në Shpalljen e fundit filloi me peygamberinë e ndritur mbi edukimin e lartë, pastërtinë shpirtërore dhe leximin e ajeteve, që kërkonin përmbushjen e kërkesave të jetës (zhvillimit të jetës dhe ndërtimit të saj) dhe dëshminë civilizuese. Pikënisja e gjithë kësaj do të jetë peygamberia dhe hilafeti, që pastaj sovrani t'i referohet Librit të Allahut.

Në sovranin e Kur'anit fisnik njeriu është përgjegjës për çdo gjë që e kërkojnë vlerat universale të përbashkëta midis njerëzve: vlera e drejtësisë, amanetit dhe udhëzimit. Janë këto kërkesa që Kur'anin e bëjnë të lexohet në mënyrë metodologjike, e ndërtuar mbi leximin e tij dhe leximin e gjithësisë me një metodë që unifikon dy leximet në një lexim të përbashkët dhe unik, të pandara njëra nga tjetra.

Këtë sovranitet e përforcojnë dimensionet e shumta, ndër to parimet e përgjithshme të sheriatit, gjithë-përfshirja e tij dhe pikënisja e tij nga teksti i Kur'anit të mbrojtur. Kur'ani është Libër i hapur dhe publik dhe njerëzimi do të mund ta lexojë dhe të lidhet me të kurdo qoftë. Sovrani i Kur'anit e çliron njerëzimin, ai njeriut i jep fuqinë e përtëritjes së dispozitave, të rregullimit të jetës në mënyrë të ndryshueshme (elastike dhe të përshtatshme) brenda këtyre vlerave kur'anore të afta për t'i përmbledhur të gjitha realitetet njerëzore çfarëdo të jenë. E drejtë e njeriut do të jetë që me leximin e tij njerëzor e të përtërirë të jetojë ndryshe në mjediset që ndryshojnë njëra nga tjetra dhe të jetojë ndryshe në kohë të ndryshme. Ai do të shërbehet me përvoja dhe eksperiencat e ndryshme që do ta ndihmojnë në çdo situatë që do të jetë dhe me metodologjinë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. për të kuptuarit Kur'anit fisnik dhe lidhshmërinë midis vlerave të tij dhe realitetit.

Sovrani i Kur'anit madhështor (hakimijah) e nxjerr njerëzimin nga të qenit e tij i mposhtur dhe i dënuar me sovran hyjnor, siç kuptohet në botëkuptimin izraelit që nënkupton shfaqjen e mrekullive të dhënies dhe panjohuritë e tij për njeriun, që ky t'i nënshtrohej plotësisht dhe në mënyrë absolute sovranit në fjalë, për gjërat që i kupton dhe që nuk i kupton, që janë të lehta ose të vështira për të. Sovrani i Kur'anit madhështorë bëri njeriun të jetë i udhëhequr me këtë Libër (të jetojë me të), i cili përgjegjësinë e praktikumit dhe realizimit e ngrit mbi të kuptuarit njerëzor dhe njohjes njerëzore.

Sovrani hyjnor – sipas botëkuptimit izraelit – njeriut i prezanton të vërteta që ai nuk mund t'i realizojë ashtu siç janë dhe me urdhër hyjnor detyrues: *“Ne ngritëm sipër tyre malin, që dukej si hije e ata besonin se do të binte mbi ta, dhe u thamë: “Mbajeni fort atë (tabelat e Tevratit) që ju dhamë dhe kujtoni çfarë përmban ajo...”* (El-A'raf, 171) – Ndërkohë që Sovrani i Kur'anit madhështorë është i ngritur mbi përpjekjen (ixhtihadin) njerëzore dhe leximin njerëzor që përgjegjësinë njerëzore e bënë të ndërtuar mbi atë që njeriu mund ta mësojë dhe kuptojë nga shenjat e Allahut dhe t'i kuptojë përmbajtjet e tyre. Me rëndësi është që me këtë të realizohet kthimi në këtë bazë dhe llogaritja e tij burim themelues, t'i përmbahemi atij dhe të mos dalim jashtë tij, qoftë me shtrembërim të tij apo lexim të tij, duke i shtrembëruar shprehjet me gjuhë dhe duke shpifur për fenë, atë ta lexojmë me lexim ardhmërie dhe korrekte, të mbështetur në gjuhë, të dhëna pejgamberike dhe njohje njerëzore. Ne nuk duhet të përshpejtojmë dënimin (me leximin e Kur'anit) dhe shpërblimin në dynja, sepse dynjaja është vend i vetëm i punës, nuk do të ketë më ngritje mali e as shndërrim në majmunë e derra..! Këtu shihet dallimi i madh midis she-

riatit të fundit dhe shariatit të Bijve të Izraelit, është dallim i madh midis dy vendeve, rendit islamik dhe atij izraelit.

#### 4. Sovrani në përshkrimin e tij koncept motivues (provokues)

Lëvizjet bashkëkohore islame paraqesin vazhdim të lëvizjeve të mëhershme. Këto lëvizje shfrytëzuan të gjitha fuqitë dhe potencialet që i kishin në vete, pothuajse trashëgiminë ideologjike dhe kulturore të Umetit të tërën e vunë në shërbim të mbrojtjes së Umetit dhe nxitjes së tij drejt përpjekjes dhe luftës. Umeti arriti të çlirohet nga kolonializmi dhe largimin e kolonizatorit, u vendosën qeveri të njohura si qeveri atdhetare, në shumë nga këto vende u realizua pavarësia, ndryshuan raportet midis këtyre vendeve dhe të tjerave. Mirëpo, grupet e aktivitetit islamik që llogariten vazhdimësi e lëvizjeve udhëheqëse dhe prijëse u befasuan kur panë se qëllimet dhe sloganet e përdorura në procesin e nxitjes së Umetit dhe riaktivizimin e tij si dhe përgatitjes së tij me fuqi të lartë për çlirim dështuan dhe nuk u realizuan ashtu siç kishin shpresuar të realizoheshin. Kjo bëri që ata të humbin shpresën dhe të rinisin luftën dhe përpjekjen e tyre në forma të ndryshme, për shkaqe dhe rrethana, disa historike që kanë të bëjnë me trashëgiminë e pushtetit dhe qeverisjes, e disa bashkëkohore që kanë të bëjnë me periudhën kolonialiste dhe mbizotërimin e koncepteve perëndimore për shtetin, pushtetin, qeverisjen dhe fuqinë. Kjo bëri që në mjediset e tilla të mbizotërojnë mendime të posaçme mbi konceptin e shtetit kombëtar dhe konceptin e pushtetit. Këto koncepte dhe këto mendje u formuan larg indikacioneve ideologjike të mendimit islam, të elementeve dhe karakteristikave të tij të vërteta.

Ishte e domosdoshme përpjekja që ndikimi i Umetit të rikthehet përsëri. Kjo do të bëjë që lëvizjet islame të mbështeten në thesarin ideologjik dhe kulturor të lëvizjeve të më-

hershme islame, e të cilën do ta vënin në shërbim të proceseve të ndryshme, disa prej tyre do të kenë për qëllim nxitjen dhe kthimin e funksionalitetit, e disa të tjera për qëllim do të kenë stimulimin dhe kthimin e reagimit (gjallërinë), ndërkaq që disa të tjera për qëllim do të kenë krijimin e fuqive efikase e të afta për shkaktim të ndryshimit përballë fuqive të mëdha. Sistemet alternative të tilla ishin të krijuara nga bijtë e vendeve muslimane, që flisnin gjuhën e tyre, banorë të këtyre vendeve, mirëpo ata i zëvendësuan të gjitha objektivat e tilla me objektiva të tjera moderne që kishin për qëllim besnikërinë me ata që brezat e mëhershëm i luftuan për t'u çliruar nga ata dhe pushtetit i tyre. Pasojat ekonomike, kulturore, ideologjike, institucionale dhe organizative do të jenë të mëdha. Në këto rrethana thirrësit do të përpiqen t'i përdorin të gjitha armët motivuese dhe ndërtesuese. Qeverisjet që do të vinin në skenë, edhe përkundër asaj se mbanin emra islamë, atë ishin sisteme injorante (*xhahilije*), uzurpuese të pushtetit që nuk e meritonin, e ai pushtet është pushteti Hyjnor. Grupet (xhematet) nuk arrinin të thonë se këto sisteme kanë uzurpuar pushtetin, pushtetin që këta ishin më merituar apo se këta e meritonin, prandaj ishte e domosdoshme të krijohet një vlerë e lartë apo diç e ngjashme që do të mund ta lëvizte masën në drejtim të kësaj vlere, atë ta lidhte me besimin në të, me nivelet njohëse dhe aftësie. Që këtë shtrimi i mendimeve të "el-xhahilije ve 'l-hakimijeh" (injanca dhe sovraniteti)<sup>10</sup> do të jenë metodat më të rëndësishme ku do të mbështeten për realizimin e kësaj çështje.

Gjendja e tillë do të krijohet në Pakistan, mjedisi ku do të shfaqen këto ide. Ai që do t'i shfaq këto ide do të jetë Mevdudi dhe të tjerët, ata që deshën të jetojnë në një shtet të parvarur islam. Por, kur pas shumë sakrificave shteti u krijua,

<sup>10</sup> Sovrani i takon vetëm Allahut dhe çdo sovran tjetër është injorant (përkthyesi).

panë se shpresat e tyre nuk u realizuan, shteti që ishte krijuar nuk ndryshonte nga shtetet e tjera. Udhëheqësit e aktivitetit islam ndiejnë një lloj mashtrimi, prandaj filluan të përsëriten aktivitetet luftarake, me qëllim të arritjes së krijimit të shtetit që e ëndërronin ta krijonin. Në hapësirën e përmirësimit të gjendjes ata do të shtrojnë konceptin e “el-xhahilije ve ‘l-hakimije el-ilahije” (injanca dhe sovraniteti hyjnor).

Sejid Kutubi do të jetë një shembull tjetër i mënyrës së bashkëveprimit me konceptin e “el-hakimije” dhe konceptet tjera lidhur me të. Ai do të jetë i njohur për përforsimin dhe mbështetjen e këtyre koncepteve. Koncepti “el-xhahilije” do të jetë atribut i atyre që nuk gjykojnë sipas asaj që Allahu e ka shpallur (Kur’anin) dhe për drejtim të tyre kanë marrë program tjetër. Autori i “Fi dhilal ‘il-Kur’an” (Sejid Kutubi) konceptin e “el-xhahilije” dhe “el-hakimije” do ta ekspozojë në shumë libra të tij, por nuk do të lëshohet në detaje të këtij koncepti, “el-hakimije”, e as që do të ballafaqohet në hollësi me këtë. Qëllimi i tij do të jetë i kufizuar vetëm në zgjimin e Umetit dhe krijimin e vetëdijes se objektivat e tij nuk u realizuan me qeverisjen e atdhetarëve, se edhe përkundër pavarësisë, ata vazhdonin të udhëhiqen me ligjet që kundërshtonin fenë dhe konceptin islam.

Përpjekjet e disa autorëve të disa lëvizjeve islame do të bëjnë që koncepti “el-hakimije” të shndërrohet në aleat të tevhidit, aq sa edhe të gjitha elementet e tevhidit dhe të akides (el-vela’ ve ‘l-bera’)<sup>11</sup> dhe të tjera do të lidhen me të. Që këtej, brenda shoqërive islame do të mbizotërojë një lloj keqkuptimi dhe çrregullimi (paqartësie vizionare), ndërkaq që rirënditja dhe përmirësimi i gjendjes do të jetë i domoshëm.

<sup>11</sup> Miqësimi dhe armiqësimi.

Do të dëshiroja t'i përmbledh këto gjëra nga të gjitha aspektet, që të bëhet e qartë se si ky koncept me këtë kuptim nuk përputhet me veçoritë e rëndësishme të shpalljes së fundit, në krye të së cilave është veçoria e tij mbarënjerëzore (universale). Kjo veçori do të bënte që kuptimi i tij të shndërrohet në "Sovran mbarënjerëzor (universal)". Ndërkaq, interpretimi i konceptit "Sovrani hyjnor" (el-hakimije el-ilahije) në kuptimin e "Sovranit ligjor", të cilin e trajtoi Esh-Shatibiu, është interpretim i pa kontestuar. Tema e "pushtetit", veçmas ai i "pushtetit fetar" (sultatun dinijetun), në kuptim të saktë të tij nuk ekziston në Islam, se ai i takon vetëm të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., se ai s.a.v.s. në jetën e tij ushtroi dy autoritete (pushtete): autoritetin fetar, duke marrë parasysh se është i Dërguar dhe autoritetin udhëheqës (gjykues) fetar, që banorët e Medines, muslimanë dhe jomuslimanë e zgjodhën dhe ishin të kënaqur me të. Do të doja që islamikët të mos e projektojnë konceptin e pushtetit (autoritetit) në kuptimin e tij bashkëkohor mbi veprimet e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., sepse ai s.a.v.s. ishte vetëm i Dërguar peygamber: "*Thuaj: "Unë jam vetëm një njeri si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zoti i Vetëm."* (El-Kehf, 110)

Pejgamberi s.a.v.s. kurrë nuk shfaqti se ka pushtet fetar ose botëror, ai as që bëri dallim midis dy çështjeve në fjalë. E si mundet pra që ky koncept bashkëkohor i pushtetit të projektohet ndërkaq që lexojmë jetën e të Dërguarit s.a.v.s. dhe veprimet e tij! Umeti islam është i pajtimit (ixhma') se pushteti i të Dërguarit s.a.v.s., që ishte pushtet fetar, nëse është e udhës të emërohet me këtë emër, ka përfunduar me vdekjen e tij dhe askush pas tij nuk e ka trashëguar, se ai s.a.v.s. është vula e pejgamberisë. Termi "pushtet" t'i vishet të Dërguarit dhe vulës së pejgamberisë në këtë formë do të ishte i kontestuar. Kujtoj se më së miri dhe më së afërmi do



të ishte të emërohej me “el-vilaje” (mbikëqyrje, tutori, përkujdesje). Kjo do të ishte më afër shpirtit të Islamit. Pas vdekjes së të Dërguarit s.a.v.s. çështja ra në duart e halifëve, kjo çështje do të jetë në cilësinë politike, i cilësuar me “Imam” (prijës), pushtetar, qeverisës, kryetar shteti ose qeveri civile. Edhe kjo përbënë një pikë për të cilën u shtuan studimet dhe thëniet e bashkëkohorëve, aty vërejmë projektim (ngatërrim) të koncepteve të kohës së të Dërguarit s.a.v.s. mbështetur në realitetin historik islam. S’ka dyshim se sfera e koncepteve moderne, analiza e tyre, studimi, zbrëthimi dhe përbërja e tyre shënojnë shumë pakujdesi (lehtësi), është vërejtje metodologjike, edhe pse Imam Karafi është i pari që hapi derën për te kjo. I Dërguari s.a.v.s. është peygamber e i dërguar, ai vepron brenda sferës së dërguashmërisë dhe peygamberisë (nebijj, resul), Allahu i Madhëruar thotë: *“Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre.”* (En-Nisa’, 64)

Nuk është vetëm bindja e cila e bën të Dërguarin s.a.v.s. udhëheqës (pushtetar) si çdo udhëheqës tjetër, se përndryshe Allahu do ta quante me këtë emër. Kur’ani i Madhërisëm përmend shumë të dërguar e peygamberë të mëherëshëm, të cilëve Allahu i Madhëruar u dha pushtet dhe peygamberi, e Allahu nuk harron! Sikur i Dërguari s.a.v.s. të ishte i emëruar me këtë emër, me siguri se Kur’ani do ta kishte përmendur këtë rol të tij që lidhet me leximin e aje-teve, edukimin dhe arsimimin dhe në Kur’an (El-En’am, 57) nuk do të përmendej se *“i tërë pushteti i takon vetëm Allahut”* (Ini’l-hukmu il-la-li’l-lah)! Allahu i Madhëruar thotë: *“A nuk i sheh ata që u është dhënë një pjesë e Librit?! Atyre u bëhet thirrje të vijnë te Libri i Allahut për t’i gjykuar...”*. (Alu Imran, 23)

Pasardhësit e të Dërguarit s.a.v.s. (hulefai rashidunët) ishin prijës që do të udhëheqin sipas mësimëve peygamberi-

ke, veprimet e tyre do të jenë brenda kësaj sfere, d.m.th. brenda sferës së hilafetit që vepron sipas planit pejgamberik (minhaxh 'un-nubuvve'), veçmas periudha e hilafetit të Ebu Bekrit dhe Omerit dhe gjashtë vitet e para të periudhës së hilafetit të Osmanit. Përpjekjet e Imam Aliut për kthim të çështjes në vendin e duhur e po ashtu edhe përpjekjet e Omer ibn Abdul-Azizit, të gjitha bëjnë pjesë në sferën e vendosjes së hilafetit mbi planin pejgamberik (në udhën e të Dërguarit s.a.v.s.). Udhën pejgamberike e përcaktoi Kur'ani i Madhëruar, ne nuk mund të ndërhyjmë e të korrigjojmë apo përmirësojmë, me qëllim të përpilimit të programeve tona politike. Përhapja e këtyre koncepteve dhe ngatërimi që ndodhi në to bëri që studiuesit të mos e lënë në harresë këtë çështje. I Dërguari i Allahut s.a.v.s, siç transmeton Muslimi dhe të tjerët hadithin, konsiderohet sqaruesi i plotë i kësaj çështjeje, kur Pejgamberi s.a.v.s., duke i folur disa udhëheqësve, thotë: "Kur t'i rrethoni banorët e kështjellave, e ata të dëshirojnë që ju t'u jepni garancinë e Allahut dhe garancinë e të Dërguarit, ju mos e bëni këtë, por jepni garancinë tuaj dhe garancinë e shokëve tuaj, se të prishet garancia e juaj dhe e shokëve tuaj është më lehtë tek Allahu, mos lejoni që ata t'i ulni para gjykimit të Allahut, por ulini para gjykimit (vendimit) tuaj, se ju nuk e dini a e qëlloni vendimin e Allahut a jo." Njëjtë vepruan edhe pasardhësit e tij, halifët e ndritur. Omer ibn Hatabi dhe Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) ishin që në shumë raste letrat e tyre i fillonin me fjalët: "Këtë e mendon udhëheqësi i besimtarëve Omer ibn Hattabi, apo kështu mendon halifi i të Dërguarit të Allahut Ebu Bekri, ose kështu e mësoi Allahu halifin e të Dërguarit të Allahut, apo kështu e mësoi Allahu udhëheqësin e besimtarëve Omer ibn Hattabin, por asnjëherë nuk kishte ndodhur që këta çështjen t'ia vishnin

Allahut të Madhëruar, nga frika e ngatërimit ose paqartësisë, që çështja e muslimanëve të mos ngatërrohet dhe ndërlikohet.

### 5. Boshti i Umetit përballë grupit dhe përballë pushtetit<sup>12</sup>

Përsiatja e Kur'anit fisnik na mundëson të vërejmë se ai u flet të gjithë besimtarëve. Urdhri kur'anor për urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja i detyron pothuajse të gjithë besimtarët, qoftë të nivelit të brendshëm: *“Besimtarët dhe besimtarët janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat.”* (Et-Tevbe, 71) – ose të jashtëm: *“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin, se ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”* (Alu Imran, 110)

Prej tyre, ai veçon një grup dhe thotë: *“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara. Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”* (Alu Imran 104)

Pra ky është grup nga grupi i Umetit, sepse fillon me thirrjen për besimtarët: *“O besimtarë!”* Allahu i Madhëruar nuk thotë një kategori ose sekt, por grup nga vetë Umeti, i pandarë nga ai dhe i miqësuar dhe i trupëzuar me njëri-tjetrin... Nuk ka vend për mandat epërsie apo grupim revokimi që e përforcon modeli i grupit të shpëtuar (firkatun naxhijeh). Modeli i grupit të shpëtuar krijoi paqartësi në vetëdijen kolektive të muslimanëve në kohë të mëhershme, ai bëri që muslimanët të trashëgojnë pikëpamje përçarëse për ndryshimin që ecte në anën e kundërt të modelit që e kishte shtruar Kur'ani fisnik, modelin e Umetit.

Koncepti i Kur'anit fisnik që grupi të jetë nga vetë Umeti nënkuptonte vërejtjen nga përçarja dhe mospajtimi, duke na bërë të mësojmë se grup nga Umeti nuk është vetëm

<sup>12</sup> Umeti përballë modelit të grupit dhe modelit të pushtetit.

pjesë e tij, por është brenda tij dhe e mishëruar në të. Kur'an-i nuk na mëson për dinamikat brenda sferave të përkatësisë grupore brenda Umetit, por na mëson për një dinamikë përmes Umetit. Çdo botëkuptim që rrënon vlerën e unitetit të Umetit në interes të konceptit sektar ose fraksionist, doemos të mësojë se nuk është i prirë për ndryshim apo përtëritje, sepse ai vazhdon të bëjë ndarje e përçarje, që në fund të nxit përçarje të fesë dhe copëtim të tij. Studimi i konceptit Umet në dimensionin e tij gjuhësor, reformist dhe konceptual na e bënë të qartë siç vijon:

Hemzeja dhe Mimi (shkronja të gjuhës arabe) janë një bazë nga e cila burojnë katër koncepte të përafërta njëra me tjetrën. Ato janë: baza, referenca, bashkësia dhe feja, të gjitha kanë kuptime që mbështeten në dy shtylla: bazën dhe bashkimin rreth kësaj baze.

Në Kur'an shprehja Umet në njëjës dhe e shquar është përmendur 60 herë (sipas usulijunëve) apo e pashquar (sipas gjuhëtarëve). Në të gjitha vendet shprehja Umet vjen në kuptim të bazës tek e cila çdo gjë kthehet dhe i referohet. Është baza ajo që mbledh përreth vetes çdo gjë. Koncepti Umet në Kur'an mbështetet në bazën dhe asaj që i bashkëngjitet. Allahu i Madhëruar thotë: *“Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre.”* (Ez-Zuhruf, 23) – d.m.th. ne i kemi gjetur të bashkuar në këtë fe ose rrugë. Koncepti Umet, qoftë në trajtën e shquar ose të pashquar, provon të qenit e tij koncept dinamik (gjallëri) që lëviz brenda sferës së tij në përputhje me bazën (bërthamën) që përreth vetes mbledh çdo gjë, që zgjerohet dhe ngushtohet sipas asaj që i bashkëngjitet, ai kurrë nuk ndalet, sa do të jetë numri i tyre, i madh e i vogël qoftë, dhe ka të bëjë me individin po edhe me gjithë njerëzit.

Kur'ani fisnik me këtë kuptim e cilësoi Ibrahimin a.s. se është Umet: *“Me të vërtetë, Ibrahim i ka qenë prijës shembullor*

*(Umet, me të gjitha virtytet e mira), i përlur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë nga idhujtarët.” (En-Nahl, 120)- dhe çdokush që erdhi pas tij e ndoqi atë, të gjithë të dërguarit ishin nga gjiri dhe familja e tij. Kur’ani fisnik na udhëzon ta ndjekim fenë e pastër të tij: “Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet singërisht Allahut, duke qenë bami-rës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?!” (En-Nisa’, 125)*

Në anën tjetër, Kur’ani fisnik na tregon se njerëzit ishin të një feje të vetme, të një orientimi i adhurimit të tyre të Krijuesit të tyre, të gjithë pra ishin robër të Allahut, Një e të Vetëm, dhe u përçanë: *“Të gjithë njerëzit kanë qenë të një feje të vetme, pastaj u përçanë.” (Junus, 19)*

Pastaj Allahu nisi të dërguar, përgëzues dhe paralajmë-rues, shpalli Librin me të cilin do të gjykonin mes tyre për gjërat për të cilat nuk pajtoheshin.

Allahu i Madhëruar gjithashtu na tregon se po të kishte dashur, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, d.m.th. pas përçarjes së tyre, por urtësia e Tij e lartë deshi që të na sprovojë dhe provojë për ato që na erdhën, të dërguarit, librat dhe shpjegimet: *“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre që i ka mëshiruar Zoti yt.” (Hud, 118-119)*

Bazuar në këtë, secili Umet (bashkësi) ka ligj dhe rrugë që e dallon nga popujt tjerë, Allahu i Madhëruar thotë: *“Ne të kemi zbritur ty (Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushësh të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë ligj dhe rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për pu-*

*në të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.” (El-Maide, 48)*

Umeti (bashkësia) pra është baza ose qëllimi, rreth tij bashkohen grupet e njerëzve dhe në përputhje me të ata i formojnë karakteristikat e tyre: *“Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju.” (El-En’am, 38)*

Umeti ndodh të jetë një brez ose breza që janë bashkuar rreth një baze ose qëllimi, varësisht nga koha kur jetuan. Kur’ani aludon në këtë duke përdorur edhe shprehjen e kohës, diçka që e shoqëron: *“Njërit nga ata dy që shpëtoi, iu kujtua pas një kohe e tha: “Unë do t’ju njoftoj për shpjegimin e kësaj, vetëm më dërgoni (te Jusufi).” (Jusuf, 45)*

Vëmendja jonë do të përqendrohet në atë se konceptin Umet Kur’ani e shtron përballë përçarjes dhe mospajtimit: *“Le të dalë prej jush një grup që të thërret për në mirësi, të urdhërojnë për vepra të mira e të ndalojnë prej veprave të shëmtuara. Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit. Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh.” (Alu Imran, 104-105)*

Çili është qëllimi (kuptimi) i përçarjes dhe grindjes?

Shprehja përçarje në Kur’anin fisnik është përmendur 70 herë, por që të gjitha provojnë kundërshtimin (dallimin), disa vijnë për të dëshmuar një pjesë të tërësisë, siç janë fjalët e Allahut të Madhëruar: *“Dhe Ne i shpallëm Musait: ‘Bjeri me shkopin tënd detit!’ Menjëherë deti u nda dhe çdo pjesë e tij u bë si mal i madh.” (Esh-Shuara’, 63)*

E disa vijnë për të bërë ndarje midis sendeve, e që çdonjëra prej tyre është e pavarur dhe prezent, që dëshmon të kundërtën e bashkimit: *“O djemtë e mi, mos hyni nga e njëjta portë, por nga porta të ndryshme.” (Jusuf, 67)*

E disa të tjera për të treguar ndarjen midis të vërtetës dhe të pavërtetës, midis atyre që mbështesin të vërtetën dhe

atyre që mbështesin të pavërtetën: “Musai tha: “O Zoti im! Unë nuk kam fuqi për askënd tjetër veç vetes dhe vëllait, prandaj na veço (na dallo) neve prej këtij populli të pabindur!” (El-Maide, 25)

Shprehja ndarje (firek) vjen edhe në kuptimin e dallimit midis të vërtetës dhe të pavërtetës: “I Lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.” (El-Furkan, 1)

Shprehja në fjalë vjen edhe me kuptim negativ, të atij të përçarjes në fe, Allahu i Madhëruar thotë: “Me të vërtetë, ti s’ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte.” (El-En’am, 159)

Zanafilla e përçarjes (grindjes) që sjell deri në mospajtim është përçarja e fesë dhe copëtimi i tij (ndarja në pjesëza), e që Kur’ani na paralajmëroi duke përshkruar ata që veprojnë kështu dhe Kur’anin e lexojnë pjesë-pjesë.

Umeti islam dallohet me atë se Libri i tij është i mbrojtur nga Allahu i Madhëruar, se baza tek e cila mbështeten të gjithë është plotësisht e mbrojtur dhe se ai është argumenti i Allahut për njerëzit deri në Ditën e Gjykimit. Që këtej themi se grupi është pjesë e Umetit që nuk arrin ta zbatojë fenë për dy shkaqe:

- e para që ka të bëjë me zanafillën e tij ideologjike e të përfaqësuar në këndvështrimin e pjesshëm të fesë, dhe

- e dyta se ai nuk arrin ta tejkalojë sferën e tij të ngushtë në dinamikë, gjithashtu që ai ec në anë të kundërt të bashkimit dhe unitetit. Zbatimi i fesë nuk arrihet me ndarje dhe grupime (përçarje dhe grindje).

Shprehja *taifeh* (grup) në Kur’anin fisnik vjen për të treguar për një grup të njerëzve që përbëjnë një pjesë të tërësisë, kështu Allahu i Madhëruar thotë: “Dhe një grup prej tyre tha: “O banorët e Jethribit, s’ka qëndrim këtu për ju, andaj

*kthehuni!" Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: "Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura!" Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin." (El-Ahزاب, 12-13)*

Shprehja "*taifeh*" nënkupton një grup që është pjesë e pandarë e bashkësisë (tërësisë), që sillet përreth bazës (boshtit) dhe gjithmonë me shikim drejt tij, ndërkaq që shprehja "*firkatun*" (grup gjithashtu) nënkupton grupin e ndarë nga bashkësia (pjesë e ndarë nga tërësia), ku secili nga ata paraqet qenie më vete dhe prani të pavarur. Orientimi i dinamikës së njëra tjetrës është e kundërt. *Taifah* paraqet një sferë të vogël të përkatësisë që lëvizë brenda një sfere më të madhe që e orienton kah boshti (epiqendra) i tij. Që këtej ai është i prirë dhe i aftë të jetë model për ndryshimin, i realizimit të fesë dhe urdhërimit për vepra të mira dhe ndalimit nga të shëmtuarat. Mirëpo, Kur'ani nuk i dha përparësi në këtë detyrë, përkundrazi, e llogariti të paaftë për këtë detyrë. Kur brenda Umetit të jenë më shumë *taifeh* (grupe) dhe mes tyre të shpërthejnë ngatërresat dhe përplasjet, atëherë në dukje del roli i Umetit si gjykatës që do të zgjidh grindjet dhe do të shuan përplasjen: "*Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata..*" (El-Huxhurat, 9)

Kur'ani këtu nuk i flet ndonjë pale të tretë, por u flet besimtarëve, d.m.th. Umetit, ai që e ka patjetër të pajtojë midis dy palëve që ndodhen në konflikt luftarak. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën pas pajtimit, atëherë lufta kundër sulmuesit bëhet në bazë të të qenit Umet, që lufta kundër sulmuesit të nënkuptojë ndalimin e sulmit e jo zgjerim të sferës së konfliktit, që më pas, nëse kthehet, të ndodh pajtimi midis tyre me drejtësi dhe paanësi, sepse ai nuk është palë, por pjesë e Umetit, që nuk meriton shpëputje apo izolim, por mbështetje dhe urtësi. Fjalët e Allahut të Madhëruar: "*Le të dalë prej jush një grup..*" – nënkupton përtëritjen e



funksionimit të Umetit çdoherë që dobësohet, ato nënkuptojnë qenien tërësore që gjithmonë ngritët pasi të shembet. Ne jemi të urdhëruar ta realizojmë Umetin, se ai është i prirë (aftë) dhe i autorizuar për realizim të fesë. Allahu i Madhëruar për realizim të fesë u flet të gjithë besimtarëve, d.m.th. Umetit: *“Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!”* Por. për idhujtarët është e rëndë ajo, në të cilën po i fton ti. Allahu zgjedh për këtë fe kë të dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me pendim.” (Esh-Shura, 13)

Umeti është i zoti i të vërtetës themelore të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, e jo pushtetari, e as shteti, as grupi apo pala! Kujtoj se diskursi i ndryshimit do të duhet të ndërtohet duke përfshirë Umetin, që në shkrimet e vjetra të sferës së politikës ligjore është fshehur nën emrin *veliju ‘l- emr* (mbikëqyrës i gjërave), që ishte në interes të konceptit dhe në interes të shtetit modern, ndërkaq që koncepti grupi i shpëtuar (*firkatun naxhijeh*) kundërshtoi (u tregua i vrazhdë, mbisundoi, tiranizoi) konceptin Umet.

## 7. Ringjallja e Umetit

Doemos që në fillim të bëjmë dallimin midis ringjalljes së Umetit dhe rindërtimit të tij. Është i Dërguari s.a.v.s. ai që e ndërtoi atë në cilësi të të qenit të tij i Dërguar dhe predikues nga Allahu, është pra moment i pakthyer dhe i papërsëritur. Ndërkaq që ringjallja nënkupton përtëritjen mbi baza të mëhershme të realizuara. Allahu i Madhëruar na sjell shembullin e përtëritjes së mesazhit të bijve të Izraelit, pasi me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë prej tyre u bënë të pabindur, u bënë të tillë që bartin librin e tyre sikur gomari që bartë libra, shtrembëruan fjalët e vërteta, i harruan mësimet e sakta që më parë i dinin dhe për të cilat morën kujtim, prandaj Allahu ua dërgoi Isain a.s., që t’i rikthente butësinë dhe përkushtimin

në zemrat e tyre, bindjen e shëndoshë dhe përkuljen para Allahut, që ditët të shkëlqenin përsëri, e kur e pyetën se mos vallë ka ardhur për ta ndryshuar ligjin, ai tha se kishte ardhur që bijve të Izraelit t'ua mësonte ligjin e vërtetë dhe fenë e pastër. Allahu i Madhëruar për këtë në Kur'an thotë: *"Dhe (kam ardhur te ju) për t'ju vërtetuar Teuratin, që është para meje dhe që t'ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë nga Zoti juaj..."* (Alu Imran, 50)

Isai a.s. ishte përgjegjës për përtëritjen e të kuptuarit të njerëzve për ligjin. Roli i Umetit musliman është si roli i Isait në përtëritjen e fesë dhe rrugës, përtëritjen e të kuptuarit të sheriatit dhe nxjerrjes së tij nga gjendja e mundimeve dhe vështirësive (se është mundim dhe vështirësi). Kjo do të realizohet vetëm me leximin e Librit të Allahut dhe të kuptuarit e tij brenda integritit (unitetit) të tij struktural. Vetëm kështu do të arrijmë t'i plotësojmë proceset e përtëritjes së përhershme dhe të vazhdueshme.

Ajo që ndodhi në periudhën e të Dërguarit s.a.v.s. nuk mund të kthehet. E kanë gabim ata që mendojnë se sikur ta rikthejnë leximin e Kur'anit siç ka zbritur dhe që veten e konsiderojnë se jetojnë brezin e sahabëve që e përjetuan shpalljen dhe për këtë zgjodhën më të mirën për ta përfaqësuar rolin e ngjashëm me atë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., se kjo do t'u mundësonte rikthimin e frytit të kohës së brezit që pranoi Shpalljen dhe atë do ta realizojnë në këtë kohë apo në çfarëdo kohe që vjen! Këta sikur nuk e kuptuan urtësinë e Allahut që Ai ndërpreu lidhjen mes Librit të Tij dhe kohës së shpalljes, kjo me qëllim që Kur'ani të mos lidhet me ndodhitë e atëhershme. I Dërguari i Allahut në vitin e fundit të jetës së tij u takua me Xhibrilin dhe së bashku bënë renditjen e tij me urdhër Hyjnor. Kur'ani sot është me 114 sure, i renditur në ajete dhe sure të gjata, të mesme e të

shkurtra, me urdhër Hyjnor. Njerëzimi sot do të duhet të bashkëveprojë me Kur'anin në bazë të tërësisë së tij, ai nuk ka nevojë për ta prezantuar apo përfaqësuar rikthimin e shpalljes së tij.

Nisur nga kjo, ringjallja e Umetit dhe i rindërtimit të tij kuptohet në dy dimensione:

- e para: Diskurs që përfshinë të gjithë ata që janë pjesë e Umetit të Kur'anit, e këta janë të gjithë ata që orientohen kah Kibla, popujt që i përgjigjen thirrjes islame, pa marrë parasysh mospajtimet e tyre, dhe

- e dyta: Diskursi drejtuar atyre që janë jashtë sferës së Umetit, është ky dimension i universal botëror i Islamit, që nënkupton bisedën me popullin e thirrjes të cilëve u bëhet thirrje për t'ju bashkangjitur popullit që iu përgjigjen thirrjes. Ndërtimi i këtij diskursi, i mbështetur në referencën islame, do të duhej të bashkëvepronte me këto dy dimensione pa mos e mbisunduar njëra tjetrën, edhe pse mes tyre mund të ketë kundërshti të dukshme.

### 8. A ndërtoi i Dërguari i Allahut shtet apo Umet?

Ka që mendojnë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ndërtoi shtet, që shpërfillin të vërtetën që s'ka dyshim, atë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ndërtoi Umet.

Botëkuptimi i lëvizjeve bashkëkohore islame për ndryshim ndërtohet mbi idenë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ndërtoi shtet islam, që për qëllim kishte zbatimin e fesë dhe përforcimin e shtyllave të thirrjes, d.m.th. se ishte urdhër Hyjnor e jo përgjigje ndaj kërkesave shoqërore politike, që nënkupton se Islami është fe dhe shtet. Prandaj shteti hyn në çështjet e bazave.

Allahu i Madhëruar thotë: *“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre.”* (El-Fet'h, 29)

Ajeti në fjalë na flet për ata që janë me të e që qartëson raportin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. me shokët e tij, as ndjekje absolute e as imitim pa të menduar. Islami gjithashtu na nxit të përsiatim në Kur'an dhe Sunet. Në fillim të sures El-Fet'h shtjellohet çështja e besimit, dallimi midis besimtarëve dhe hipokritëve, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk është si çdo udhëheqës që nuk lë hapësirë për analogji, ai është i Dërguar i Allahut, dhe kështu ai, me leje të Allahut duhet të respektohet; *"Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllim që njerëzit, me lejen e Allahut, t'i binden atyre."* (En-Nisa', 64)

Marrja e vendimit ose korniza e urdhrit nuk merr formën autoritare piramidale, por ka për qëllim kolektivin (bashkësinë) dhe jo vartësinë (nënshtrimin), se Allahu i bashkoi zemrat e tyre. Shumë lëvizje politike islame janë përpjekur që t'i shlyejnë (përputhin) dallimet midis udhëheqësve të tyre dhe të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. kur bëhet fjalë për domosdoshmërinë e bindjes ndaj tyre dhe pengimin e diskutimit dhe shqyrtimit para realizimit. Këta konsultimin reciprok (shura) e konsideruan veçori e jo domosdoshmëri, këta nuk lejuan dorëheqjen nga xhemati ose partia, e as analogjinë e xhematit ose partisë mbi parimet e fesë, duke konsideruar se një gjë e tillë do të ishte rebelim (dalje nga xhemati ose partia).

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. gjatë jetës së tij themeloi Umet që do ta bart mesazhin, kjo do të kërkojë dalje për ta mbrojtur atë, ballafaqim me imperatoritë, për t'i hapur dyert para thirrjes islame, prandaj ajeti në fillim shtron çështjen e zgjedhjes së luftës para dorëzimit, për t'i hequr pengesat materiale nga rruga e thirrjes në fjalë: *"Ju do të thirrreni për të luftuar kundër atyre ose të dorëzohen.."* (El-Fet'h, 16)

Dhe atëherë, në saje të provës së qartë, le të besojë kush dëshiron të besojë dhe le të mohojë kush dëshiron të mohojë

jë. Ballafaqimi me perandoritë e atëhershme bëri që ndërtimi i shtetit të jetë nevojë e natyrshme, që më pas të zhvillohet e të merr formën e perandorisë në saje të realitetit të atëhershëm, duke mos pasur tekst ose urdhër Hyjnor. Vetvetiu u krijua rrugë e largët midis thirrjes islame dhe shtetit, sepse zëri i shtetit tingëllon ndryshe nga zëri i thirrjes. Shteti është qenie fizike, ai ka kërkesa kundërthënëse materiale me ata që përbëjnë rrezik për shtetin dhe zhvillimin e tij.

Ndërtimi dhe realizimi i Umetit është bazë, ndërsa ndërtimi i shtetit është degë e tij, e jo e kundërta. Ndërtimi i shtetit që do të përshkruhej se është shtet islam, por që nuk shikon drejt Umetit, do të jetë shtet pengues i dinamikës së thirrjes islame dhe Umetit së bashku, sepse ai kurrë nuk do të jetë përveç se shtet i grupit ose palës ose xhematit, farefisit ose familjes, ku do të përforcohen konfliktet e interesit e të thellohen përplasjet. Shteti i hilafetit islam nuk mund të ndërtohet pa përtëritje të ndërtimit të Umetit, hilafeti nënkupton hilafetin e Umetit (mëkëmbësinë): *“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin.”* (Alu Imran, 110)

Hilafeti varet nga uniteti i Umetit e ajo nga uniteti i pushtetit. Kjo e fundit ndërton imperatori të shpërndara njëra me tjetrën, siç ishte më parë, por kurrë nuk ndërton hilafet. E si mund të arrihet kjo me diskutet teologjike grupe e sektare, të ngushta dhe që nuk përfshijnë shumëllojshmërinë dhe numrin e madh të Umetit?!!

Studiuesi i dëshmisë së konceptit të hilafetit në Kur'anin fisnik arrin të gjejë disa shfaqje të shumëllojshme të këtij koncepti; shprehja hilafet (me shkronjat H-L-F) në Kur'an është përmendur 125 herë. Ai plot 25 herë përmendet në cilësi të caktimit të mëkëmbësit nga ana e Allahut, ndërkaq që në trajta tjera përmendet në dhjetëra vende. Studimi i këtyre vendeve na mundëson që çështjen në fjalë ta kategorizojmë në tri nivele:

### 9. Njeriu emërohet mäkëmbës në Tokë

Allahu i Madhëruar thotë: *“Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë do të krijoj një mäkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë’, ata thanë: ‘A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë?’”* (El-Bekare, 30)

Këto ajete trajtojnë mäkëmbësinë e njeriut në Tokë dhe sqarojnë atë se Allahu te njeriu vendosi karakteristika që do ta bënin të aftë të merrte përsipër rolin e mäkëmbësit, e që asnjë krijesë tjetër nuk i kishte ato karakteristika. Mäkëmbësia ngërthen kuptimin e amanetit (aftësinë e bartjes së përgjegjësisë), siç lexojmë fjalët e Allahut të Madhëruar në rrëfimin për Musain: *“Më zëvendëso te populli im, mbaj rregull dhe mos ndiq rrugën e ngatërrestarëve.”* (El-A’raf, 142)

Bartja e amanetit kërkon autorizim (besim) të kompetencave të amanet-bartësit që ngushtohen dhe zgjerohen, prandaj engjëjt pyetën, e jo se pse Ademi u zgjodh për mäkëmbës. Ademin e bëri të aftë për këtë detyrë të lartë aftësia dhe miratimi që Allahu e vendosi në të, që të mund të bashkëveprojë dhe krijoj harmoni me gjërat që Allahu i krijoi në Tokë, ligje dhe sekrete. Allahu i Madhëruar atij do t’ia mësojë natyrën e këtij amaneti: *“Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje...”* (El-Bekare, 31) – Roli dhe kompetencat e tij do të varen dhe realizohen me këtë, sepse sjellja e njeriut në këtë amanet nuk është esenciale, por autorizim nga Krijuesi, dhe në saje të këtyre kompetencave që Allahu i caktoi për të, ai nuk do të mundet t’i tejkalojë ato.

### 10. Popujt emërohen zëvendës dhe ndërrimi i popujve

Allahu i Madhëruar thotë: *“...dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë. Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?!”* (En-Neml, 62) si

dhe ajetet në suret vijuese: el-A'raf 65-69, el-A'raf, 73-75, Hud, 75, Junus, 13, Junus, 71-73 dhe Nur, 55.

Të gjitha këto ajete trajtojnë mëkëmbësinë e popujve dhe njerëzve, që është një lloj i veçantë i mëkëmbësisë që buron nga baza e përgjithshme, që nënkupton mëkëmbësinë e disave nga mesi i krijesave tjera. Ky lloj i mëkëmbësisë nuk është privilegj (epërsi), por vetëm një rol i roleve që ndërrohen midis njerëzve. Kjo nuk vlen vetëm për besimtarët, por për çdo popull ose komb, të cilët i studiojnë dhe i zbatojnë shkaqet e fuqisë dhe fitores.

### 11. Mëkëmbësia individuale

Mëkëmbësia individuale mbështetet në shfrytëzimin (përdorimin) që reflekton (pasqyron) autorizimin Hyjnor në mbizotërimin e natyrës dhe qenieve. Allahu i Madhëruar thotë: *“O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj, gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut!”* (Sad, 26)

Mëkëmbësia këtu nuk është vetëm zbatim i pushtetit fetarë, që e kërkon ligji i Allahut dhe zgjedhja njerëzore, siç e kishte Daudi e pas tij Sulejmani a.s. Lloji i dytë i mëkëmbësisë individuale nënkupton shtrirjen e bazës së përgjithshme, kur njeriu bëhet përgjegjës i amanetit dhe sprovohet për atë që Allahu ia dha: *“...dhe shpenzoni nga ato që Ai ua ka lënë trashëgim (në dorë amanet).”* (El-Hadid, 7)

E as si atë që e bëri Musai me vëllain e tij që e la për zëvendës: *“Më zëvendëso te populli im, mbaj rregull dhe mos ndiq rrugën e ngatërrestarëve.”* (El-A'raf, 142)

Tërësia shpirtërore që krijon lidhje midis asaj që Allahu emëron për mëkëmbës disa nga krijesat e Tij dhe mëkëmbësia e njerëzve ndaj njëri-tjetrit është se kjo mëkëmbësi ngërthen kuptimin e amanetit (bartjes së përgjegjësisë), e jo vetëm trashëgimi, sepse trashëgimia është e kundërt me

mëkëmbësinë, kur ato i vishen Allahut: *“Vërtet, jemi Ne që e trashëgojmë Tokën dhe gjithçka gjendet në të dhe ata te Ne do të kthehen.”* (Merjem, 40)

Në suaza të këtij koncepti kur'anor të hilafetit, doemos që muslimanët të kuptojnë se ç'nënkupton hilafeti i tyre; çdo bisedë për hilafetin islamik në mungesë të paqes dhe harmonisë midis muslimanëve është vetëm se vetëmasht- rim. Suksesi i çfarëdo forme (formule) politike në procesin e rimëkëmbjes përmes hilafetit në nivel të Umetit do të varet nga realizimi i kësaj paqeje dhe harmonie midis muslima- nëve, e jo me përhapjen e tij në vende të ndryshme ose vazhdimësi në kohë.

Tendenca e qeverisjes (sundimit) që sot e gjejmë në dis- kursin e disa lëvizjeve islame – që të mos gabojmë në përg- gjithësim – nuk është e re, shumë shkrime të mëhershme politike fetare e kanë reduktuar Umetin në velij el-emr (mbikëqyrës, kujdestar), e tani në shtet, e që të dyja nuk nënkuptojnë Umetin. Kjo ndodhi me ndikim të modelit fis- nor të cilin e përfaqëson plaku i fisit, i pari i tij ose shtylla e tij, po edhe depërtimi i modelit të grupit të shpëtuar, i cili doemos ta impononte pikëpamjen e tij në cilësinë islame me metoda epërsie përmes velij el-emrit (kujdestarit) të autori- zuar për ruajtjen e besimit të njerëzve. Mungesa e Umetit nga diskursi dhe lidhshmëria e tij me fraksion (grup, sekt) do të sjell pezullimin dhe anulimin e tij, e që do të bëjë që fuqia materialiste të merr në dorë dominimin, ndërkaq që ndryshimi të ndodh përmes pushtetit me metoda epërsie është rruga më e efektshme. Shoqëria e paaftë për zgjidhjen e mospajttimeve thërret dhe kërkon despotizmin, pushteti fryhet e zmadhohet aq sa shoqëria i lejon. Kjo nuk nënkup- ton mohimin e rëndësisë së fuqisë materiale që luan rol të rëndësishëm në ndryshimin e realitetit, por doemos që fuqia e tillë të kufizohet në Umetin, e jo në grupin e shpëtu-



ar, se kështu do të përçahemi dhe do të vuajmë nga duart e njëri-tjetrit, që është një pasqyrë e dënimit: *“Thuaj: “Ai ka fuqi t’ju ndëshkojë prej së larti nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njëri-tjetrit. Shih si ua shpjegojmë shpalljet, që ata të mund të kuptojnë.”* (El-En’am, 65)

## 12. Logjika statike nuk është e aftë të ringjall dhe përtërijë Umetin

Logjika statike është ajo që tekstin kur’anor dhe tekstet e Sunetit i vendos brenda kornizave parësore të cilat i ndër-tuan brezi i parë. Logjika e tillë bënë që në këtë kornizë të bënë pjesë sfera njohëse, metodologjike, karakteristikat e periudhës së caktuar dhe ngjarjet e ndryshme historike. Por, logjika e tillë nuk pati sukses, e lëre më të jetë objekt studimi dhe analize.

Diskursi bashkëkohor islam nuk përpiket të merr përsipër studimin dhe analizën e këtyre kornizave, që do ta ndihmonin studimin e tyre nga brenda, për të kuptuar dhe vlerësuar ndryshimin e madh që mund t’i ndodh këtyre kornizave, e që pastaj të mundet të vlerësojë dhe caktojë vlerën dhe sasinë e ndikimit të brendshëm midis lokales dhe botërores, në kontekst të influencës që nuk njih ndërprerje ose ndalim.

